

An abstract painting of a woman's profile, rendered in a style reminiscent of Vincent van Gogh's 'Olympia'. The colors are vibrant and textured, with shades of pink, blue, orange, and brown. The woman's face is the central focus, with her hair and features defined by bold, expressive brushstrokes. The background is a mix of soft and dark tones, creating a sense of depth and movement.

Ramiz  
GJINI

posta  
që sjell  
era

tregime të  
zgjedhura



*Botimet “m&b”*

*Ramiz Gjini*  
POSTA QË SJELL ERA  
*Tregime të zgjedhura*

*Përzgjedhi tregimet: Bujar Karoshi*

**ISBN: 978-99956-04-52-3**

© *Të gjitha të drejtat janë të autorit*



**BOTIMET “M&B”**

*Adresa: Rr. “Zenel Baboçi”, Pallati “Ferar”, Tiranë*

*E-mail. mbbotime@gmail.com*

*Tel. + 355 4 22 33 283*

---

*Shtypur në shtypshkronjën “Mirgeeralb”. Tirazhi: 300 kopje, Tiranë, 2010*

## Mërzia e thellë e vetmitarit Luis Medina

Nëntëdhjetë vjeçari Luis Medina, banor i një apartamenti në katin e parë, telefoni e tha se i qe djegur lampa e dritës në guzhinë.

Qysh para gjashtë muajshë, kur fillova punë si mirëmbajtës i pallatit, e deri tani, që po shkruaj këto radhë, mund t'i kemë ndërruar llampat e apartamentit të tij më tepër se pesëdhjetë herë.

Sipas një llogarie të thjeshtë, që bëra me vehten, këtij vetmitari të plakur e të harruar nga bota, asnjë llampë elektrike nuk i ka rezistuar më shumë se një javë. Kurse kompania, "Sunlite", që i kishte prodhuar, shkruante mbi kartonin e ambllazhimit, se jepte garanci, që një llampë me kapacitet shtatëdhjetë e pesë voltë, rezistonte ndezur, tek e pakta, njëmijë orë.

Herën e fundit, - kjo ndodhi para katër ditësh, - ia kisha hequr një llampë të djegur në guzhinë, për ta zëvendësuar me të re. Më kujtohet mirë, që bloza e tymit, pati krijuar nga brenda asaj llampe të djegur, një figurë, mu si një krimb i madh trunngu të kalbur, me kokën sterrë të zezë. Athua se e kishte vizatuar një dorë e padukëshme dhe e stërvitur artisti. Pa i thënë asgjë plakut, e hodha në koshin e

plehërave, që ndodhej diku pranë derës. Pastaj, mora një llampë të re, që Luisi e kishte lënë për mua sipër tryezës dhe e vendosa në vend të asaj që hoqa. Atë ditë, ai tha se donte të dilte jashtë, por s'mundej, pasi i dhimbnin kockat. Për më tepër, qielli ishte vrenjtur dhe rrekej të binte shi.

Nganjëherë, kur jashtë dita që me diell dhe e ngrohtë, Luisi, dilte nga shtëpia, thjeshtë për endirë. Bënte ecajake të vogla, i ndihmuar nga kujdestarja e tij ngalakaqe, Laura.

Laura, i shërbente Luisit me orar të reduktuar dhe paguhej nga bashkia e qytetit të New York-ut. Një pjesë të mirë të ditës, si dhe gjithë natën, Luisi e kalonte i vetëm në shtëpi. Por, edhe gjatë kohës kur Laura gjendej bashkë me të, ai që i dënua të dëgjonte ankesat e saj. I qahej plakut për një farë Dimitri, që ajo e thërriste shkurt Dima, - një tip rusi allçak, që ia binte asaj shpirtin në majë të hundës.

- Mos u mërzit Laura, - e ngushëllonte Luisi, - Gëzohu, që tashmë, ti ke vërtet arsye për ta lënë Dimën e për të gjetur një tjetër . Dhe kjo, do të thoshte: “Jepi munxën Dimitrit dhe mos na çaj veshët me të”.

Ngalakaqes Laura, i vinin përshtat këto fjalët e tij, ndaj, menjëherë, niste t'ia hapte fletët lakrorit me një ngazëllim lirik: i tregonte për një djalosh me origjinë polake, i cili, nuk që si Dimitri, por, xhentil e i dashur. Na e kishte njohur një ditë gjatë udhëtimit me tren dhe patën shkëmbyer bashkë edhe numrat e telefonave. Madje, të nesërmen, kishin parë edhe një shfaqje teatri në Broadway, kishin darkuar në një hotel të klasit të parë e kushedi çfarë tjetër... Dokrra në diell, që plakut rrozgan, në njërin vesh i hynin, në tjetrin i dilnin.

Në fillim, e bëja pa përtesë ndërrimin e llampave në apartamentin e vetmitarit Luis Medina. Natyrisht, jo për bakshishin e vogël, që ai s'harronte të më fuste në dorë tekta lagohesha, por, e bëja pse më pëlqenin ato historitë që tregonte. Për çdo herë, me

kërkesën e tij, ulesha me mendimin për të qëndruar vetëm pesë minuta, por mbërthehesha aty për një kohë të gjatë. Ama, kur ai, nisi të më telefononte gjithnjë shpesh e më shpesh për të njëjtin problem, atëherë mendova, që ndoshta, diçka nuk qe siç duhej në rrjetin elektrik. Kështu, i bëra një kontroll të hollësishëm gjithë linjës, por nuk gjeta ndonjë gjë që duhej ndrequr. Ndonëse nuk e dija egzakt ku qëndronte problemi, thjeshtë për të bërë një provë, ia hoqa siguresat rrjetit të apartamentit të tij dhe i zëvendësova me të reja. Por, edhe pas kësaj pune, ndërsa ditët kalonin, vetmitari Luis Medina, vazhdonte të telefononte shpesh e më shpesh e të thoshte, se i qe djegur llampa. Një herë në guzhinë, një tjetër herë në korridor e kështu me radhë... Dhe unë, qeshë i obliguar të shkoja për t'ia ndërruar, e gjithashtu, për çdoherë, si me një rast, të rrija pak çaste për t'u llafosur me të. Mirëpo, kjo historia e llampave që digjeshin pa ndonjë shkak, dukej sikur nuk do të kishte fund. U rropata gjatë për të gjetur një zgjidhje, dhe, kur nuk munda, i telefonova një mikut tim, inxhinier elektrik, i cili, banon në New Jersey. Ai më këshilloi të provoja të vendosja në linjën kryesore të rrjetit, një si tip stabilizatori të vogël. Më shpjegoi, që ky mjet i thjeshtë, mbante nën kontroll impulset e fuqishme të rrymës, dhe njëkohësishtë, i filtronte ato.

Ia thashë këtë Luisit dhe ai e pranoi ofertën time. Kështu, e bleva atë mjet stabilizues dhe e instalova në linjën kryesore të rrjetit. Pastaj, i dhashë atij faturën dhe ai e pagoi bashkë me hakun tim të punës. Por, për çudinë time, edhe ky stabilizator i instaluar në rrjet, nuk dha ndonjë rezultat. Plaku Luis, vazhdonte të më telefononte, dhe mua, do të më duhej sërish të shkoja, të paktën, dy herë në javë për t'ia ndërruar llampat.

Një ditë, kur ai po më fliste me shumë mall e dashuri për gruan e tij, tashmë e vdekur, pata një ndjesi mistike: mos ndoshta kishim

të bënim me ndonjë nga ato rrengjet, që thuhet se të vdekurit u punojnë nganjëherë të gjallëve? A nuk vazhdonin të ndodhnin këto fenomene në disa shtëpi, që amerikanët i quajnë “most hunted”? Mos ndoshta, atë gruan e tij të vdekur, e pati marrë malli të luante me të gjallin e saj, Luis?

Dalngadalë, erdh’ e mu forcua një llurbë dyshimi, që shpirti i kësaj gruaje, i dërrmuar nga pritja e gjatë, e linte nganjëherë atë botë dhe vinte e hynte në apartamentin e ish burrit të saj të vetmuar. Pastaj, me një marifet, që vetëm të vdekurit e dinë, i digjte llampat si të deshte t’i thoshte: “Mjaft, Luis, me këtë dritë të shpifur e të gënjeshtërt, për të cilën, të duhet të paguash faturën çdo kryemuaj. Erdhi koha, të vish pranë meje ku do të ndriçohesh nga një dritë e dliërë dhe hyjnore, pa çelësa që prishen, llampa që digjen e fatura pagese”.

Ia thashë këtë Luisit si me humor dhe ai, qeshi e tha:

- Unë e di, që Nensin tim e ka marrë malli, ashtu siç më ka marrë edhe mua. Por, nuk besoj të kërkojë të më heqë, atë, që Zoti ka bërë ymër”.

Ndërsa vazhdoja t’ia ndërroja llambat e djegur, ma shkrepri të rrëmoja në njërin nga bibliotekat e Brooklyn-it ku gjeta një libër të shkruar nga një far dr. Raymond A. Moody, i ndihmuar nga Elisabeth Kubler-Ross. Ky libër titullohej “Life After Life” dhe rrekej të shpjegonte jetën pas vdekjes. Qe botuar e ribotuar, në s’gabo, një pesëdhjetë e tre herë, që do të thoshte, se kishte qenë i lexuar nga miliona njerëz.

E shfletova fletë pas flete këtë libër, duke e lexuar me kujdes, me shpresën se mos gjeja aty të fshehta mistike, raporte e fakte lidhjesh mes frymëve të vdekura dhe atyre të gjalla. Por, gjatë leximit, unë pashë, që shumica e eksperiencave të grumbulluara aty, qenë nga ish pacientë të sëmurë kristianë, që kishin provuar vdekje klinike.

Gjatë vdekjes klinike, shpirtërat e tyre, kishin braktisur trupat. Pastaj, patën ecur përmes një tuneli të gjatë e të errët. Ata tregonin, që në fund të këtij tuneli, fekste një dritë-ëngjell, nga e cila, buronte një zë që i pyeste, çfarë kishin bërë në jetë. Nga përgjigjja, që ata do jepnin, varej fakti, nëse do të hapej dera e parajsës apo ajo e ferrit. Mirëpo, në vend që të përgjigjeshin, ata qenë kthyer e ia kishin mbathur me të katra, sepse, medemek, qenë kujtuar për diçka që paskan harruar ta bënin. Atëherë, shpejt u binda, që ky libër, nuk kishte gjë tjetër, përveç disa informacioneve paralele, të ngjashme me shkrimet e shenjta, që të them të drejtën, Sania, e ndjera gjyshja ime, i ka pas ditur përmendësh.

Kur u dhashë brenda në apartamentin e tij për punë të asaj llampës së djegur, që vakt mbrëmje. E gjeta qyqevetëm në guzhinë, te ulur në karrige, me të dy parakrahët e vendosur mbi tryezë, i ndërkallur në mendime dhe me shpirtin e thekur nga vetmia. Më kishte lënë një kopje të çelësit, që sa herë t'i shkoja për t'i ndërruar lllampat, të mos e merrte mundimin për t'u ngritur e për të më hapur derën.

Guzhina, ndriçohej disi nga drita e zbehtë e korridorit. Me duartë që i dridheshin e memzi i bindeshin, ai përpiqej të sistemonte ngadalë disa fotografi të vjetra, të bëra para gjashtëdhjetë vjetësh. I nxirrte nga një album i grisur dhe i fuste në një tjetër album të ri. Ashtu siç që, i zhytur në mugëtirë, i harruar nga bota, i plakur e i dobësuar, Luisi dukej si të që ngritur nga varri për të bubërritur të shkuarën e tij të largët.

- Njeriu, në moshën time, - tha pas pak ai, - është i tepërt në këtë botë.

Pastaj, shtoi, se ishte i dëshpëruar, ngase i pati telefonuar të birit në Florida, por i që përgjigjur sekretaria telefonike dhe i kish thënë të linte mesazh.

E pyeta çfarë moshe kishte i biri.

- Sapo ka mbushur shtatëdhjetë vjeç, - tha ai me tonin e zërit të një prindi, që krenohet me djalin e tij, - Ka dalë në pension dhe tashmë, luan me nipërit e mbesat e vogla.

Ndërkohë, afrova një karrige, hypa në të dhe hoqa llampën e djegur. Por, u habita kur vura rë, që në dorë mbaja të njëjtën llampë, që unë, e kisha hequr njëherë katër ditë më parë. Thjeshtë për t'u siguruar,\* e vështrova sërish ngultas me vëmendje. Nuk kishte pikë dyshimi: ishte e njëjta llampë, me atë figurën si një krimb i madh trangu të kalbur, me kokën sterrë të zezë, formësuar nga bloza e tymit brenda qelqit.

Pa çelur gojë, me një lëvizje të matur të dorës, që të mos thyhej, e hodha atë llampë të djegur në koshin e plehërave, që ndodhej diku pranë derës. Pastaj, mora llampën e re, që ai e pati lënë sipër tryezës, ia vajisa pak fundin e filetuar dhe e vendosa në vend të asaj, që sapo hoqa. Pata kujdes, të mos e vidhosja fort, me dëshirën e mirë, që, kur vetmitarit të plakur Luis Medina t'ia ngulte sërish kthetrat mërzia e thellë, të kishte mundësi ta hiqte lehtë. Pastaj, në vend të saj, të vendoste atë tjetrën, të djegurën, siç pati bërë ngaherë, thjeshtë, që të kishte një shkak për t'më thirrur.

*NewYork, dimër, 2008*



## Koka e Gruas

Unë nuk e kisha pas ditur, që doktor Ernest Martini kishte një dashuri kaq të madhe për artin.

Kur hyra në shtëpinë e tij u befasova me ambientin e krijuar aty brenda, sepse pa zënë në gojë zbrazëtinë që krijohej nga mungesa e objekteve, - nuk kishte aty as bufe, as dhomë gjumi, madje as frigorifer - nuk pashë asgjë, që ka të bëjë me fushën e mjeksisë. Pashë vetëm piktura në akuarel, vizatime me laps, portrete skulpturash në allçi, gdhendje në mermer si dhe një mori rrangullinash të vogla interesante prej porcelani e bronzi, të shpërndara gjithandej nëpër shtëpi.

E para gjë që më vajti në mend, ishte, që ky mjek fare pak i njohur, me një dashuri të madhe për artin, - që ç'është e vërteta i kish prishur fort punë në lidhje me profesionin e mjekut, - duhej të kishte një rreth të madh shoqëror artistësh të të gjithë llojeve të artit, sepse nuk mund të kuptohej ndryshe fakti, që shumica prej punimeve, që ai mbante të vendosura me kujdes gjithandej nëpër ambientet e shtëpisë së tij, qenë fort të veçanta, dhe për më tepër, nuk gjendeshin në treg. Por nuk qe ashtu, sepse më pas do të merrja

vesh, që Ernest Martini, ishte një vetmitarë, që e kish pas braktisur shoqërinë, që para pesëmbëdhjetë vjetësh, kur qe larguar nga bangat e shkollës e qe martuar me Agnesa Pogonin, një vajzë fshati, nga ato që u vjen bukuria vetëm ditën e nusërimit dhe nuk u mban më shumë se një muaji mjalti.

Sapo i rashë ziles, ndjeva nga brenda një zhurmim të lehtë hapash, dhe kur u hap dera, u shfaq para meje një grua e zakonshme, për të mos thënë e shëmtuar, që më ftoi të hyja brenda me një gjysëmbuzëqeshje të shtirur, ndërsa bëri me dorë një gjest pa kulturë, duke më kujtuar, që para se të shkelja mbi një tapet ngjyrë bezhë dalëboje, do më duhej të hiqja këpucët.

Ernest Martini më priti i ulur në një kanape të vjetër, ndërsa në dorë mbante një libër të një shkrimtari të madh rus të shekullit të tetëmbëdhjetë, që unë, të them të drejtën, pa qenë nevoja të fryhem, e kisha kaluar nëpër duar gjatë moshës së adoleshencës.

- Ku humbe, miku im i mirë?! - tha ai. Dhe, pa luajtur aspak nga vendi, - këtë unë e mora si shenjë afiniteti, - zgjati dorën drejt meje si të deshte të merrte mbi tavolinë një faturë të vonuar elektrik.

Pastaj bëri me dorë, që të ulesha përballë tij, dhe, pasi u rehatova disi, - aq sa ç' mund të rehatoheshe në një kanape si ajo, - që të dy, ndjemë si u bëmë qesharakë, sepse na iku goja, nuk mundëm të çelnim bisedë me nga një fjalë të zgjedhur, nga ato, që në shumicën e rasteve, si për dreq, kur i thua, ndodh të dalin budallallëqe me brirë.

Atëherë, të dy, në të njëjtën kohë i thamë njëri-tjetrit "Sa mirë, që u takuam", dhe sërish, që të dy, ia dhamë gazit për këtë përplasje mendimi, që i dha të kuptonte gruas së tij, Agnesa Pogonit, (kishte mbajtur mbiemrin e saj të vajzërisë), se miqësinë tonë, nuk e mbante gjallë vetëm koha e lume e viteve të shkollës, por edhe budallallëku ynë i përbashkët.

Si hymë në bisedë nuk patëm të ndalur: u pyetëm për shëndetin,

punët tona të përditëshme, të ftohtin e atij dimri, që nuk mbahej mend ndonjëherë; ai foli për hallet e tij, që s'kishin të sosur, unë, për punën e biznesit tim të mbarë, pastaj të dy për jetën në përgjithësi, që nuk qe më ajo e viteve të shkollës, të cilat, i kujtuam pastaj me shumë mall.

Gruaja e tij Agnesa, para se të sillte atë kafënë e shpifur, që e kish pas bërë të shurdhër si lëng gështenjash, më qerasi me disa ëmbëlsira petashuqe, që ajo tha se i kish pjekur vetë, dhe që unë, pasi i hëngram me shumë zoritje sepse nuk më pëlqyen fare, ia ktheva se qenë fort të mira. Dhe nuk bëra hiç mirë që ia futa kot, sepse ajo, si për belat, vajti andej nga kuzhina e solli edhe disa të tjera.

Pas kafes, Ernest Martini u ngrit e më tha ta ndiqja pas drejt studjos së tij të madhe, ku kalonte kohën e lirë duke u ushtruar në artin e skulpturës.

I pashë me vëmendje punimet e tij prej argjili e mermeri, dhe, kur sytë më vajtën në disa fletë albumi të ngjitura nëpër mure, kuptova që shumica prej tyre qenë imitime të skulptorve të njohur, kryesisht amerikanë. Mbi tryezën e madhe, qëndronte një imitim i keq i papërfunduar, i cili quhej “Shqiponja dhe gjarpëri” kopjuar nga William Skillin Shop; pastaj mbi syprinën e një komoje mezi njoha “Krishti i kryqëzuar” nga Jose Rafael Aragon dhe si bëra një rrotullim, diku pranë derës, sytë më zunë “Penelopa” e Franklin Simmons dhe, krahas saj edhe “Skllavja greke”, e cila, nëse nuk gaboj, i përkiste më duket njëfar skulptori të quajtur Hiram Powers.

Ambjenti qe i pisët, si në të gjitha studjot e atyre skulptorëve të patalentuar, ku përpjekjet e dështuara, përftojnë gjithandë veç imitime bajate, pllanga balte e shtresë pluhuri mbi dysheme. Me këtë mendim do të kisha dalë nga studjo e tij, për të mos u kthyer sërish kurrë më aty, sikur Ernest Martini të mos kish hapur derën e një musandre dhe të mos kish nxjerrë prej aty një kokë gruaje, e

punuar në mermer, që më la pa mend!

Në herë të parë, më shkrepiti mendimi, që miku im i vjetër, nuk qe veç një amator i artit të skulpturës, por qe edhe një koleksionist i thekur, të cilit, ndoshta fati i pati shtënë në dorë një vepër kaq të rrallë. Por kisha gabuar, sepse kur Ernesti çeli gojë, do të më habiste pa masë fakti, që ajo kokë gruaje, qe punuar pikërisht prej tij para pesëmbëdhjetë vjetësh, pa patur parasysh asnjë model të huaj. Qe një kryevepër e rrallë, e veçantë, që nuk ngjante me asnjë tjetër. Madje edhe sot, ende nuk arrij të kuptoj se si ka ndodhur, që një amator arti si Ernest Martini, madje, - kërkoj ndjesë, që detyrohem ta them hapur, - me një mungesë të theksuar talenti, të mund të realizonte një punim të tillë.

Megjithatë, i lëshova pe mendimit, që ndodh nganjëherë më të rrallë, kur njeriun e pushton për pak kohë një ndjenjë sublime, ndonjë frymëzim i madh, që e ngre atë gjer lart në fron të perëndive. Ndryshe nuk ka si kuptohet, - po e them edhe një herë, - që një mjek i shkolluar, që e ka pas dashur shumë profesionin e tij, që nuk ka rënë kurrë në dashuri me ndonjë bukuroshe, dhe për arsye ende të panjohura, është shtrënguar të marrë për grua një vajzë firifiu fshati si kjo, që mban në dorë një pjatë me ëmbëlsira petashuqe e vjen vërdallë nëpër shtëpi si një shitamendëse, të mund të krijojë një vepër kaq të bukur.

E mora në duar atë kokë gruaje prej mermeri të bardhë dhe ia ngula vështrimin si i babëzitur, i bindur se qe një arritje e rrallë, dhe, sa më gjatë e vështroja, aq më shumë bindesha për këtë.

Pata një dëshirë përvëluese, që mu zgjua me ta parë; një dëshirë, që ta kisha për vete atë kokë gruaje, por, para se t'i bëja një propozim të tillë, duhej të sigurohesha nëse Ernest Martini, bashkë me gruan e tij, që vazhdonte të sillej nëpër shtëpi si një patë hutaqe, - ndërsa hante me duar në pjatë ëmbëlsira petashuqe nga ato, për të cilat,

thoshte gjithë krekosje se i kishte gatuar vetë, - ta dinin vërtet vlerën e kësaj kryevepre. Sido që u befasova, m'u desh ta përmbaja veten: u hoqa kinse po e vështroja si të qe një kokë gruaje e zakonshme, madje më e zakonshme se koka me flokët e pakrehur të gruas së tij, Agnesa Pogonit, që jo vetëm s'të ngjallte dëshirë ta shikoje, por, - sërish jam i detyruar ta them drejt dhe hapur, - të fuste krupën kur e shikoje me atë trup të dobët si skelet, me rrobat, që i rrinin si të varura në një gozhdë të ngulur në mur.

I qofsha falë Ernest Martinit, sepse të ishte për mua, për njëmijë vjet nuk do të isha martuar me të.

Si ta kishte rrokur mendimin tim, Agnesa Pogoni e hodhi fjalën rreth gruas time, të cilën, ajo se kish parë e takuar kurrëndonjëherë. Duke u përtypur me gojë, pa i ngritur sytë asnjëherë nga pjata me ëmbëlsira petashuqe, ajo pyeti gjatë e gjatë për të, nëse kish kryer ndonjë shkollë dhe nëse punonte në ndonjë punë për të qenë.

Me mendjen gjithnjë të përqëndruar mbi atë kokë të bukur gruaje të punuar në mermer, i thashë shpejt e shpejt se gruaja ime quhej Malvina, se pati mbaruar universitetin si ekonomiste dhe se punonte në kryeministri. Pastaj, keni parë ju? Pa pikë takti, gruaja e botës deshi të dinte sa vjeç ishte Malvina ime?! Dhe unë, i inatosur, që më doli në shteg në këtë far feje, i thashë jo pa mburrje, se në fakt, qe njëzetetë vjeçe, por, në të pamë, rreshtohej me ato lloj grashë, që duken shumë më të reja nga ç'janë në të vërtetë.

Pikërisht atë çast, ra një gong tri herë, gruaja e mikut tim u kujtua për byrekun, që afërmendsh tashmë duhej të qe pjekur, futi shpejt ëmbëlsirën e fundit petashuqe në gojë, dhe u nis të fikte sobën.

- Të pëlqen? - pyeti Ernesti, ndërsa bëri me kokë nga koka e gruas, që mbaja në duar.

- Po, - thash unë me një puqje të mekur buzësh.

- As vetë nuk arrij ta kuptoj si pati dalë kaq e bukur, - tha ai. Dhe si të kish kuptuar, që ndodhesha në prag të një kërkese të pakëndëshme, u ngut e shtoi:

- Jam i bindur, që nuk mund ta ribëj kurrë më.

- Jo, - kundërshtova unë, - Ju mund ta ribëni sërish, derisa e keni bërë njëherë.

Dhe duke e parë drejt në sy e pyeta:

- A jemi miq ne të dy, Ernest?

- Përse ma bën këtë pyetje pavend, - tha ai paksa i prekur, - Jemi dhe do të mbetemi dy miq të mirë.

- Atëherë, ma fal mua këtë kokë gruaje.

Ernest Martini u zu ngushtë. Rrotulloi sytë si të deshte të gjente fjalën më mohuese, bëri një gjest, si për të treguar, që sapo e kisha shkelur në kallo e tha:

- Kërko diçka tjetër, të lutem... Këtë s'ta jap dot, më beso.

- Përse? - ia bëra unë, dhe, pas kësaj pyetje, u ndjeva njeriu më leshko në botë.

- Kam arsye të forta sentimentale, për të cilat, nuk e gjej me vend të shprehem.

- Edhe mund të paguaj diçka, nëse nuk... Le që nuk ke pse fyhesh. Ne jemi shokë të vjetër, apo jo? Mua më ka ecur biznesi këto kohët e fundit dhe ti ke nevojë për ca para. Kjo është e gjitha. Po të afroj dy milionë lekë për këtë punim në mermer të bardhë, - përfundova unë me sytë gjithnjë nga dera e kuzhinës, gjithë frikë se mos vinte e shoqja e tij shëmtraraq.

Por ai, si ta kish kuptuar shqetësimin tim, i bëri zë së shoqes, që të vinte pranë nesh, dhe mua, sërish m'u pështiros kur e pashë atë grua të vinte duke tërhequr zvarrë ato shapkat e grisura, e duke përtypur mbi pjatën e rimbushur ëmbëlsira të tjera petashuqe. Ia

pashë supet e ngushta si të një fëmije, sytë gjysëm të perënduar me një pamje të mjegullt, gjoksin e vdjerrur dhe shpinën paksa të kërrusur, që i jepte atë pamjen e një pate të plakur e të hutuar. Dhe sërish pyeta veten se si kish qenë e mundur, që Ernest Martini, gjithë ai farë djali me shkollë të lartë, e kish dashur këtë grua e qe martuar me të. “Budallai, - thashë me vete kushedi për të satën herë, - Vërtet, që është një budalla i shkundur ky Ernest Martini, - sepse unë, as sytë nuk do të kisha denjuar t’ia hidhja e jo më të martohesha me të.

Agnesa Pogoni erdhi aty me një buzëqeshje disi të fshehtë në buzë. Dukej se e kishte dëgjuar bisedën tonë, sepse u drejtua nga i shoqi e tha:

- Jepja, Ernest, mos e zgjat. S’ke ç’i bën. I ka rënë qejfi në të.

- Ti e di, Agnesa... Se si më vjen... E pata gdhendur në një kohë tjetër, që tashmë ka marrë arratinë, nuk kthehet kurrë...

- Mos u merakos shumë shpirt... Të blejmë diçka për të qenë me ato para dhe të mbushim shtëpinë.

Ernest Martini u kthye nga unë. Deshi të thoshte, që ajo kokë gruaje e punuar në mermer të bardhë, këtej e tutje do të ishte imja, por pashë t’i ikte goja nga një dhimbje e thellë, e fshehtë, që e bëri pastaj, të kthente shikimin e syve të përlotur në anën tjetër.

I plotësova aty për aty një çek prej dy milionësh, e futa me kujdes atë kokë të rrallë gruaje në një thes dhe pa ia varur gruas së tij, që më ftonte të rrija edhe ca për të ngrënë byrekun e sapodalë nga furra, i përshëndeta e dola. Por në çast u kujtova, u ktheva në beft dhe sa për ta ditur, e pyeta Ernest Martinin për diçiturën, e kujt qe kjo kokë gruaje e punuar në mermer të bardhë.

- Është ime shoqe, Agnesa, para pesëmbëdhjetë vjetësh, - tha ai.

*New York, verë, 2002*





## Belaja e së shtunës

Kur shoku Xhabir, erdhi sërish në Biboll si kandidat për deputet e nisi të mbante ato fjalimet në popull, ca e pritën mirë, por ca të tjerë, thartuan turinjte e thanë: “Prapë na u qep si rrodhe ky kopil-kopili?! “

Ishte prag zgjedhesh të reja dhe ç’prej katër ditësh, kisha një dhimbje në ije, që ç’t’iu them! U gardhnova brenda dhe as që do të kisha dalë nga shtëpia sikur të mos ia kish behur tek unë kryetari Brahim Çadërbashi. Erdhi bashkë me të birin e Lal Pogës. U përshëndetëm e u pyetëm, pastaj kryetari Brahim, ndërsa më zgjati qesen e duhanit, tha:

- Ti, o baca Maliq, e di që nesër fillon fushata elektorale?

- E di, - thashë unë, ndonëse si ta dija si të mos e dija, për mua njëlloj qe.

Mbajti frymën një cop herë e si një babaxhan shtoi:

- Ne, o baca Maliq, kemi menduar të të vëmë në krye të një pune fort me rëndësi.

- Për hajër na daltë, - thashë unë, - Urdhëroni e flisni zotnia juaj!

Po vrisja kaploqen për të gjetur ku donte të dilte.

- Do të drejtosh sektorin e pompimit gjatë fushatës, - tha ai. Dhe u krekos një copë herë si t'i kish rënë nishanit. Pastaj shpjegoi se dëshironin të drejtoja një grup të rinjsh të paisur me pompa nga ato që përdoren për të fryrë gomat!

Të them të drejtën, u zura ngushtë. Cigaren e thura për të thurur, por ngase më dridheshin duart e në mendje shestoja tjetër gjë, e bëra për hagaret të zotit: të shtrembër e të përdredhur mu si ajo gjethja e mollës ku fshihet natën cingatori.

Nuk mora vesh asgjë nga ato që tha ai, ndaj pa të keq pyeta:

- Nuk më thoni, zotnia juaj, çdo të bëjmë me ato pompa?

- Do të fryni shokun Xhabir, - tha seriozisht zavalli dhe më nguli sytë e zgurdulluar nga pija.

Siç e thashë, unë jam plak i moshuar tashmë. Shumë gjëra në jetë më kalojnë pa i vënë re, e sidomos, nuk marr vesh hiç nga teknologjia e re e mjeteve të propogandës. Ngela si hutaq dhe nuk e kuptoja se si e pse kërkonin ta frynin shokun Xhabir, (zoti e ruajtë!). Por kjo punë u qartësua kur ndërhyri i biri i Lal Pogës e mi shpjegoi qartë të gjitha.

Mua më pëlqen ai djalë. Si mësues që është, hedh dritë në fjalët që thotë, u jep një lloj qartësie, ka durim të madh dhe t'i fut në kokë gjërat ngadalë e shtruar. Vetëm atëherë e kuptova se si qëndronte puna. Fjala që, se ata të Partisë së Qendrës së Majtë, na paskeshin ujdisur tek një mjeshtër një Xhabir prej llastiku. Kishin menduar, medemek, ta vendosnin kandidatin e tyre diku pranë kryqëzimit ku ndahet rruga, që çan mespërmes Luginës së dragojve për të mbërritur pastaj, në qytezën e largët të Dodonës. T'ia lidhnin këmbët për disa ganxhave të ngulura në tokë dhe ta frynin me pompë, që të ngrihej drejt në këmbë, dhe, duke mbajtur një fletë votimi në dorën e majtë, me të djathtën të bënte me gisht drejt perëndimit të largët, medemek, për t'i treguar miletit tonë

udhën nga duhet të shkojë!

Edhe sot e asaj dite, më vjen për t'u çuditur me ato shejtanët e Partisë së Qendrës së Majtë se si u pati vajtur mendja për një marifet të tillë!

Kryetari Ibrahim, se nga nxorri një tufë me pesëmijëshe, mi rrsi në dorë e tha:

- Këto i ke për xhepin e vogël. Kur të ketë sosur kjo punë, o tatëlosh, do të marrësh pjesën e xhepit të madh.

Nuk bëra dot as gëk, as mëk, sepse ju e dini se si ta lidh gojën ajo e mallkuar para. Ama, teksa ndaheshim, u zura ngushtë. Duke pranuar shpërblim pa nisur ende puna, po u bija pak më qafë atyre të Partisë së Qendrës së Majtë. Zoti më faltë, jarabi!

Kërceva e thashë:

- Po sikur ta fryjmë njëherë shokun Xhabir, pastaj mendojmë për pagesën?

- Këto punë i di unë, or baca im, - ma pat zavalli. Dhe më rrahu shpatiullat, athua se unë isha një djalosh në pik të moshës, kurse ai, - plak në vendin tim.

Të shtunën në mëngjes, nisi fushata elektorale, me artopolantë shëtitës, parulla, tamtame daullesh e grupe militantësh, që bënë propogandë. U bë një llazurë e madhe që hajt morë, athua se luanin qentë e kallajxhiut.

I biri i Lal Pogës, na çoi me kamjon drejt e në vendin e caktuar, ku ndahet rruga që të shpie në Dodonë. Morëm me vete Ernest Misurin si edhe dy pompa (njëra do të qe rezervë) bashkë me atë Xhabirin prej llastiku. E kishin palosur në katërsh, të shkretin. Lëvizte si pelte sa herë djemtë e shkelnin me këmbë. Këto të rinjtë e sotëm janë bërë më shejtanë se ato të Partisë së Qendrës së Majtë: e tërhoqën zhakthi dhe e plandosën mu në mes të sheshit!

- Ngadalë more djema, - u thashë, - kapeni si njerëz e mos e

zhakamysni kësisoj!

Më dëgjuan do të thoni ju? As që deshën t'ia dinin çfarë thashë unë! E tërhoqën osh harbutçe, në fillim nëpër pluhur, pastaj i ranë mespërmes një pellgu me ujë, e shkërryen në baltë, dhe, tek e mbramja, kur e shpalosën që ta shikonte pak kohë dielli, (i vinte një erë e keqe), gjetën aty brenda, - me nder jush, - një mi të ngordhur!

Qysh asaj kohe mu fiksua keq një ndijim torturues: sa herë shikoj ndonjë xhabir, më përzihet, më duket se bie erë mi i ngordhur. Madje kjo më ndodh me gjithë deputetët e parlamentit tonë. Zoti më faltë për këtë, sepse, me ç'më kanë thënë, janë nga burrat më të mirë, më të zgjedhurit: natë e ditë, veç për kombin mendojnë! Por ne vegjëlja, nuk i meritojmë ata, sak ma nuk i meritojmë, sepse po t'i meritonim...

Djemtë e flakën miun në një kanal e nisën të hidhnin romuze. Qeshnin, kukuriseshin dhe talleshin, kopilat. E unë që jamë plak, e nuk kam moshë për t'u hazdisur e hakarizur asisoj, u fola apet me të keq, e i këshillova ta merrnin punën seriozisht, pasi në fund të fundit, pa marrë parasysh të mirat, që do t'i sillte Bibollit zgjedhja deputet e shokut Xhabir, ata për atë punë do të paguheshin.

- Durim, o baca Maliq, ti veç mos na u mërzit - tha i biri i Lal Pogës, - sepse po ia futëm pipin tek vrima këtij qafiri, e fryjmë për dy minuta.

Hajde t'i marrësh vesh këta të rinjtë e sotëm! Edhe kandidat për deputet edhe qafir, nuk kisha parë e dëgjuar ndonjëherë!

Ernest Misuri kërceu e tha:

- Kështu si është katandisur ky, nuk ka adap që ia gjen vrimën.

E kishte fjalën, për ventilin.

Kërko e kërko, dhe kur ia gjetën ventilin, u shkrinë gazit. Ai mjeshtri anonim, paskësh qenë më shejtan se ato të Partisë së

Qendrës së Majtë: ia kish pas ujdísur ventilin mu në prapanicë.

Dhe filluan sërish djemtë të qisnin bishta, hidh e prit romuze, qesh e ngjesh; kurse mua më merrnin me të mirë, përpiqeshin të më largonin kacabujt, ndërsa i kthenin palët shokut Xhabir. E unë atëbotë, nisa të kuptoja se më kish gjetur belaja.

- T'ia ngulim kunjat, - tha Ernest Misuri dhe vajti të merrte ganxhat.

I ngulën ganxhat në tokë rreth e rreth me një tokmak dhe e lidhën me konop për këmbësh shokun Xhabir. E bënë këtë punë me shpërfillje e tallje, që fali o zot! E mua, ato çaste, nuk di pse mu shtua ajo dhimbja në ije. Athua se po lidhnin për këmbësh një hajvan të plakur samari, një kalë bajmak, një gërdallë të zgjebosur, e jo shëmbëllesën e një kandidati për deputet. Pastaj, gjithnjë duke qeshur, morën njërën nga pompat, i filetuan tubin në prapanicë dhe nisën ta frynin shpejt e shpejt duke u ndërruar, njëherë njëri, pastaj tjetri.

Teksa shikojta syprinën e asaj sendegjaje të madhe llastiku të ngrihej ngadalë e të merrte formën e një qenie me dy këmbë, thash me vete: “Bre, bre...Fryma është jetë, është akumulim, forcë e sukses, sidomos në politikë”. Nën pushtetin e frymës, dalëngadalë, nisën të merrnin trajtë të gjitha pjesët e trupit. Minutë pas minuti, ajo masë llastiku, që më parë ndodhej fare pranë hiçit, teksa formësohej, rrekej t’i shëmbëllente të gjallit Xhabir, kandidatit tonë të nderuar. (Zoti e ruajtë)

Duke i dhënë varda pompës papushim një kohë bajagi të gjatë, shoku Xhabir mundi të ngrihej ndenjtur, por ende nuk kish brenda aq ajër të ngjeshur sa duhej për t’u ngritur në këmbë.

Për një çast, pashë që djemtë po djersinin dhe më erdhi keq për ta. U thashë të bënin një pushim të shkurtër dhe ata e lan

pompimin; ndërsa vetë, bëra ca hapa prapa për ta këqyrur në distancë atë shëmbëllesë: nuk ngjante hiç me shokun Xhabir. Kish marrë formën e përçudshme të një picërraku të madh të ngritur në bisht, të një picërraku që ka ngrirë i squllët në një pozicion të çuditshëm. Këmbët i kishte të vëngërta e të çapëluara, memzi e mbante me ta drejtëpeshimin. Hunda i rrinte e varur, me majën e kthyer si sqep hutini. Dora e djathtë, nuk qe tendosur në masën e duhur për të bërë me gisht andej nga perëndimi, (ku thonë se është parajsë për së gjalli), por tregonte andej nga stallat e Nesimit, ku ndodhej një grumbull i madh plehu me një taborr mizash që zhuzhisnin përsipër. "Zoti e shpëtoftë miletin tonë nga ky keqkuptim, për aq kohë sa nuk e kemi fryrë tamam shokun Xhabir", thashë me vete, sepse rruga e Dodonës qe gufosur nga trafiku, dhe njerëzia, padyshim, i kish ngulur sytë gapërr mbi ne. Me ato luhatjet e lehta që i jepte zefiri, me gishtin drejtuar nga grumbulli i plehut, shoku Xhabir, kishte diçka të ngucakeqëshme në vete; athua se e kish zënë krruti. Dukej si një i sëmurë psikik, që përpiqet të largojë nga vetja një ndjenjë neverie.

I biri i Lal Pogës hoqi këmishën, u shtri mbi bar në shpinë, dhe, ndërsa rreshkej në diell, përtypte një fije bari me dhëmbë e hidhte ndonjë fjalë kuturu rreth politikës. Pastaj bëri shumë pyetje ngase deshi të dinte, se si kanë qenë bërë zgjedhjet në motet e shkuara; e sidomos, ai deshi të dinte, nëse fryheshin kandidatët edhe atëherë kështu si sot.

Mua nuk po më shqitej ajo dhimbja në ije, ndaj i nxirrja përgjigjet si me grep. I thashë, që aso kohe, kandidatët për deputet, me sa mbaj mend unë, o bir, qenë burra zahmani, të merrnin gjak në vetull. Po të përpiqeshe t'u jepje ndonjë pompë për t'i fryrë, s'e kishe mirë me ta. Dalngadalë, ai nisi t'i rrallonte pyetjet, dhe tek e mbramja kuptova, që e kish kapluar gjumi ngase nisi të gërhiste. Kur

hodha sytë andej nga shoku Xhabir, për çudinë time, m'u duk më i vogël. Për aq muhabet sa bëra unë me të birin e Lal Pogës, shoku Xhabir qe trusur kërbunjas, i ishte thyer qafa, koka i qe rrëzuar si një kungullac e i pati hapur një golle në kraharor; kurse krahët i vareshin, (ndjezot!), si lavjerrës të fishkur gjer në tokë. Memzi qëndronte në këmbë, qyqari.

Më gjeti, si i thonë, belaja e së shtunës!

E zgjova shpejt të birin e Lal Pogës, thirra dhe Ernestin dhe u thashë t'i jepnin pompës, sepse ora po çastiste afër dhjetës, kurse ne, ende nuk e kishim ngritur në këmbë si duhej belaziun. Në fakt, desha të sigurohesha, nëse shoku Xhabir rridhte me të vërtetë. Kurse ata të dy, na paskeshin qenë dembelë të mëdhenj, e unë nuk i paskam njohur për të tillë! Filluan t'i vinin rrotull me lëvizje të plogështa, silleshin qerthull dhe asnjëri, as tjetri, nuk e merrte mundimin ta rrokte pompën i pari.

Andej nga e vona, i biri i Lal Pogës kërceu e tha:

- Mos e diskuto: ky karabush rrjedh diku o baca Maliq. Nuk ka mundësi. . . .

Dhe nisën të kontrollonin shokun Xhabir për t'i gjetur ndonjë vrimë.

U ktheva shpinën i zemruar e gjithë rrebe në kokë. Ç'të bëja me ta?!

Por ja që Ernest Misuri, ma zbrazi inatin:

- Kot zemrohesh me ne, o baca Maliq, sepse ky kandidati ynë rrjedh. Hajde të shikosh, ia gjetëm vrimën allçakut.

U afrova e pashë që djemtë kishin të drejtë: shoku Xhabir rridhte e cërcërriste mu në tepe të kresë. Pastaj i biri i Lal Pogës i gjeti edhe një vrimë tjetër të vogël në parmë të qafës, i futi në vrimë një fije bari për të mos e humbur, ndërsa nisi të kërkonte andej nga fundi i kurrizit për vrima të tjera.

Saora, nisa në Biboll Ernest Misurin të bënte me dije kryetarin Brahim Çadërbashi.

Kur u kthye, ma bëri qejfin: kish sjellë një kompresor ajri me benzinë si dhe nja dy-tre pulla të holla, të gatshme, që ngjisnin kollaj, mjafton t' u hiqje një cipë të hollë plastmasi. Por nuk kishte pasur aq mend sa të merrte edhe një valvë shkarkimi për t'ia montuar shokut Xhabir. Dhe kur nuk ka mend djali, s'ka ç' i bën as dhaskali. E pullosën Xhabirin prej llastiku, ia mbyllën vrimat mirë, dhe kur ia futën tubin në prapanicë, ndezën kompresorin.

Atëherë, vetëm ta shikonit se me ç' madhështi u ngrit në këmbë shoku Xhabir. Bre, breee... Më vrafshin shtatë teqe në ju gënjej. Kurrë nuk do ta harroj atë pamje, atë monument njeriu gjigant. Ngjante me nje kreshnik mali nga ato të moteve, që tashmë janë harruar. Ajo sajësë llastiku, që më parë të ngjallte neveri me kotësinë e saj, ku edhe minjtë ngordhnin po të hynin aty, nisi të madhohet. Me t' u fryrë, mori në sytë tanë një pamje krejt madhështore! Kishe qejf ta shikoje: dhjetë metra i lartë, me dorën e djathtë të shtrirë nga perëndimi, ballin lart e vështrimin drejt horizontesh të reja...

Kaq shumë u ngazëlleva dhe kaq shumë mu dhimbs humbja e atij ngazëllimi, sa kur u dëgjua krisma, u përdata e gati vdiqa nga tronditja e thellë.

Ajo shëmbëllesë e gënjeshtërt, plasi e u shfry sa çel e mbyll sytë. Nga gjithë ajo madhështi, ngelën në tokë vetëm disa lepra të vogla llastiku, gjithçka tjetër u zhbi e u zhba. Por, besoni bacën Maliq: e keqja për mua ende s'ka mbaruar. Sepse, qysh atëherë, jam bërë si i thonë, njeri me hije. Shoku Xhabir i fitoi zgjedhjet dhe vajti deputet në kuvend. Dhe për këtë kam edhe unë meritën time, apo jo? Pastaj u bë edhe ministër dhe kjo nuk është pak. Të gjithë ne, që u rropatiëm të fitonte, natyrisht që u gëzuam.

Tani e shikoj gati përnatë në televizor, sepse nuk para vjen më



këtej nga Bibolli.

Për çdo herë, që e shikoj, më duket më i shëndoshë, më i fryrë e më i rrumbullakosur. Kurse unë, dita ditës cokatem, tretem e hollohem nga një llurbë dyshimi: kam frikë se herëdokurë, - larg qoftë, - mund të plasë edhe e vërteta ashtu si shëmbëllesa e saj e rreme.

*New York, pranverë, 2003*

## Gruaja e huaj

Nuk ka erë më të rëndë se era që përhap madërgona. Saherë i shkul nga kopështi im, përpiqem më kot ta heq krejt nga duart ngjyrën e asaj llubate të verdhë e helmatisëse. Ajo do të mbetet, derisa ta zhbijë vetë koha.

Kur ra zilja e telefonit, fshiva nxitimthi duart me një peshqir dhe vajta e ngrita receptorin. Ç'prej matanë, dëgjova të fliste një zë gruaje.

- Jam Belina, - tha ajo, - Belina Kelti.

Ndjeva të më zgjohej në lukth një dhimbje e vjetër, një dhimbje që e kam patur para njëzetë vjetësh, e që e kisha pandehur të fshirë e të harruar. Sepse vërtet kishte njëzetë vjet që nuk e kisha parë Belina Keltin, që kur ajo mbaroi studimet e shkollës së lartë dhe iku në një qytet provincial, ku u martua me një mësues shkollë fshati, e nisi të vinte në zbatim ato synimet e saj pasionante për t'u marrë me koleksionimin dhe studimin e bimëve mjeksore.

Qemë dashur bashkë me një dashuri të rrëmbyer, por fatshkurtër. Dashuria jonë pati qenë mu si ajo stuhia e pranverës, që vjen kalimthi me shtrëngatë, e ikën duke lënë pas petale të rrëzuara përtokë nën një qiell të kthjellët si loti...

- S'besoj të më keshë harruar, - tha ajo pas stepjes sime.

- Aspak, Belina! - nxitova e thashë unë. - Vetëm se jam pak i tronditur... Pas gjithë kësaj kohe që ka kaluar...!

- E di, - tha ajo, - por le të takohemi njëherë si dikur... Të kujtohet? Asokohe ti ishe një djalosh i apasionuar pas poezisë, kish filluar të të pëlqente era e flokëve të mi dhe këpusje budallallëqe, që mua më pëlqenin...

E lamë të takoheshim në orën katër pasdite tek Stacioni i Autobuzëve të Veriut. Aty ndodhej edhe një park plot lule, brenda të cilit, binte në sy një shatrivan i vjetër. Prej kohësh, ky shatrivan, qe kthyer në një hurdhë uji. Verës, për çdo ditë, llapashiteshin aty fëmijët e vegjël.

Unë nuk e di çfarë ndjejnë të tjerët në çastet e një takimi pas njëzetë vjetësh me një ish të dashur, porse mua, - të them të drejtën, - m'u bë si të më kishin shtyrë me pahir për të vënë një dorë madërgona mbi varrin e gruas së xhaxhait tim, e cila, ka vdekur para shumë vitesh. Ndoshta e pata atë ndjesi për shkak të ngjyrës së asaj llubate të verdhë e helmatisëse madërgonash që nuk munda ta shqisja dot nga duart e mia, si dhe për shkak të kujtimeve, që, ndërsa përpiquesha t'i zhvarrosja vagëllimthi nga kujtesa, dëgjoja ngicngacet e krimbit përthellë ndërgjegjes time, i cili, brente pareshtur për të dalë nga pezhishka bashkë me një tymtë faj të pashlyeshëm: përse nuk i kisha shkruar asnjëherë Belinës? Përse nuk i kisha telefonuar? Përse nuk kisha pyetur kurrëndonjëherë për të, për fatin dhe jetën e saj, të paktën sa për ta ditur? Si i kishte ajo tashmë flokët, ecjen, vështrimin, buzëqeshjen...?

Mora autobuzin e orës tre pa njëzetë dhe u gjenda në vendin e takimit andej nga ora katër pa dhjetë. Doja që të isha unë ai që do të prisja, natyrisht, për t'i dhënë një lloj vlerësimi Belinës si dhe rëndësi takimit tonë pas një kohe vërtet shumë të gjatë.

Si kalova rrugën kryesore, hyra në park dhe hodha sytë andej nga stolat e gurtë të vendosur nën hijen e shelgjeve lotues, por nuk e pashë asgjëkundi Belina Keltin. Pashë vetëm një grua të rënë nga vahti, që rrinte dhe heshtonte në vetmi në cepin e një stoli. Vështronte me indiferencë fëmijët e vegjël si llapashiteshin në ujin e shatrivanit, ndërsa brohorisnin e bënëin poterë me zërat e tyre gazmorë.

Kjo grua, kish një fytyrë të hequr e të lodhur. Dukej se qe një nga ato gratë e vetmuara, të cilat, për shkak të ndonjë sëmundje të rëndë, pensionohen nga shteti. I kam parë shpesh të dalin ndonjë orë parqeve sa për të vrarë vetminë dhe mërzinë e thellë.

Belina nuk kish ardhur ende, dhe mua, më kaploi një ndjesi si të mos kisha qenë unë ai që kisha folur me të gjatë asaj telefonate të papritur. Athua se isha ngritur nga shtrati krejt në jermi, dhe ia kisha behur aty për të takuar një grua, që e kisha parë në ëndërr.

Fëmijët vazhdonin ato llapashitjet e tyre brenda shatrivanit. I hidhnin njëri-tjetrit grushte me ujë syve, loznin dhe qeshnin.

Njëri qe flokverdhë me sy të kaltër, energjik, gjithnjë i qeshur dhe më pëlqeu ngase ngjante me Indritin, nipin tim gjashtëvjeçarë; kurse dy të tjerët dukej se qenë binjakë: imcakë, kokëqethur e me sy të zinj si kokërra kulumbrie të pjekur. Që të dy kishin veshur mbathje të shkurtëra në ngjyrë të kaltër dhe mbanin në kokë nga një strehëz kapeleje të lidhur me llastik prapa kokës.

Unë i dhashë një përshëndetje të lehtë me kokë gruas së huaj, zura vend në cepin tjetër të stolit dhe u ngula me vështrimin gjithnjë andej nga rruga, ku luzma e njerëzve shkonte e vinte.

Prisja nga çasti në çast të shfaqej Belina Kelti, me atë ecjen e saj karakteristike, që edhe pas njëzetë vjetësh ndarje, nuk më qe shqitur nga kujtesa: një ecje aristokrateje, prej konteshe, me kokën paksa të ngritur e vështrimin të hedhur larg. Përpiqesha të

imagjinoja çastet e para të atij takimi me të, që ende s'kish ndodhur, dhe qeshë i sigurtë, që do të dukeshia para saj mu si një humbamento i budallepsur. Kurse Belina, me atë natyrën e saj të qetë, sapo të më shikonte, do të nënqeshte me një lloj përmbajtje fisnike për të më dhënë të kuptoj se kështu na qenka jeta, ku koha, që ikën e s'kthehet kurrë më, i marrka nëpër këmbë vitet, ngjarjet, dashuritë e bashkë me ta edhe njerëzit.

Dy binjakët deshën ta rrëzonin në ujë flokëverdhin me sy të kaltër, por ai u rrëshqiti nga duart si ngjalë dhe ata u rrëzuan vetë me një pllaquritje zhurmëmadhe. Stërkalat mbërritën gjer tek ne, dhe gruaja e ulur në cepin tjetër të stolit lëshoi një si klithje të lehtë gazmore. Pastaj qeshi, u kthye nga unë e me një zë që i rezonoi thellë në kraharor tha:

- Janë kaq të mirë...!

- Po, - thashë unë.

Akrepat e orës, tashmë e kishin kapërcyer katrën kurse Belina Kelti ende s'po vinte. U ngrita në këmbë dhe nisa të bëja ecejake përballë shatriranit, gjithnjë me vështrimin andej nga prisja të shfaqej Belina.

Nuk vonoi shumë dhe unë pashë të kalonte rrugën atje tej e të vinte drejt nesh një grua me flokët e gjatë të hedhur supeve. Por ecja nuk qe e Belinës. Të kish ndryshuar pas kaq vitesh ecja e saj? Të ishte, vallë, kjo grua Belina Kelti?

Duke u afruar çdo çast e më tepër, unë munda të dalloja miset e fytyrës së saj: bardhavele, vetulla të vizuara me kalem si dhe një manushaqe e thelle në vallet e syve të saj lavrashë e të shqetësuar. Mbante një palë vathë si kalavesha rrushi me xixime zjarri. Bluza e saj e hollë në ngjyrë rozë, i rrinte ngushtë dhe qe lagur nga qumështi, që i kish rrjedhur pak nga thimthat e gjijve.

Me të mbërritur aty, ajo më hodhi kalimthi një vështrim

indiferent, pastaj ndaloi buzë shatrvanit e gjithë përkëdheli i tha flokëverdhit:

- Mjaft loze “Luqe-puqe.” Vishu tani. Është koha të shkojmë tek çerdhja, të marrim motërzën e vogël.

Ktheu shpinën dhe mori të ecte andej nga erdhi.

Vogëlushi u bind, doli nga uji, rrëmbeu sandalet bashkë me bluzën dhe e ndoqi të ëmën nga pas turravrap.

Edhe dy binjakët sykolumbri e lanë lojën, qëndruan një copë herë të mbërthyer në vend me vështrimin andej nga po largohej shoku i tyre.

Kushedi për të satën herë pashë orën, e cila, më duket se qe andej rreth pesës.

Belina nuk erdhi, dhe unë, qeshë i sigurtë se nuk ia vlente kurrësesi të prisja më. U ktheva për një çast dhe hodha sytë andej nga stoli ku isha ulur pak më parë: pashë, që stoli qe i shkretë...

Gruaja e huaj nuk ndodhej aty.

Atëherë ma zunë sytë atje përmatanë, se si po largohej me një ecje karakteristike prej konteshe, me kokën paksa të ngritur e vështrimin të hedhur larg; se si u zhduk pastaj mes një dyndalle njerëzish që shkonin e vinin secili në hesap të vet.

*New York, verë, 2004*

## “Qeveritarët”

Për çdo herë, që atdheu ndodhet në rrezik, ai thërret t’i dalin zot bijtë e tij. Por, ata janë kaq shumë në numër sa duhet të shtyhen me njëri-tjetrin kush e kush t’i dalë zot më parë; e nganjëherë edhe të rrihen si Kel Fisti me Zul Kukelin.

Pikërisht në çastet kur Kel Fisti po lidhej me telefon me sekretarinë e një kongresmeni amerikan për të diskutuar mbi fatet e Shqipërisë, Zul Kukeli, ky burrë kaba nga trupi e i nxehtë nga koka, me flokët e gjatë e të palarë prej zabërhani, hyri rrëmbimthi në zyrë, e kapi për kollareje dhe duke e shtrënguar fort, i derdhi në fytyrë një hukamë kutërbuese pijaneci e i tha:

- E di ç’ të punoj unë more injorant i dreqit?!

Kel Fisti qe i shkurtër e i dobët, i krehur me kujdes, i rruar e i parfumuar. Gjatë dy javëve të katastrofës që pësoi atdheu, për t’u dukur patriot, qe veshur me një kostum të zi e kish lidhur qafës një kollare të kuqe. Sido që i jepte rëndësi vetes duke marrë pozat e një politikani të ri, energjik e me plot alternativa në kokë, ai kish ngelur prej katër vjetësh në një zyrë të vogël të katit të parë, ku çdo ditë, e torturonte zhurma e hapave të shefave demokratë lart mbi dyshemenë e katit të dytë.

Duke qenë se dy partitë kryesore kishin humbur disi besimin në popull, Kel Fisti, që donte për dashnore tre gjimnaziste njëherësh, nuk kish si të mos donte atdheun e tij, ndaj pati vendosur t'i dilte zot.

Brenda katër vjetësh kish ngritur pesë shoqata, por ngase nuk kishte siguruar dot fonde, i kishte shembur ato. Ama kish mbetur pa u shembur zyra e vogël, ku ai kishte kopjuar e ndryshuar një dyzinë me staturë, programe punësh të rëndësishme, projekte zhvillimi, dhe tani së fundi, listën e një qeverie të re në hije, ku për bela të vet, e kish shkruar ish shokun e tij të fëmijërisë, të prapin Zul Kukeli, ministër bujqësie! Kurse për veten e tij, kish mbajtur postin e kryeministrit!

Kulmi!

- Lëshomë...! - çirrej me një zë të pridhun Mikeli me sytë gapërr nga telefoni që kish mbetur i hapur, - Lëshomë pra, Zul...! Të merremi vesh si njerëzit...

Zul Kukeli as që kishte ndërmend ta lëshonte për t'u marrë vesh me të si njerëzit. Duke e shtrënguar gjithnjë e më fort, ai e ngriti njëherë hopa si të qe një gjel dekorativ, i dha një shkelm karriges, dhe, duke e tërhequr me pahir, e nxorri mu në mes të zyrës.

- Ku ma ke listën e ministrave?! - pyeste e kërcënonte njëherësh duke bërëtitur Zuli, - Nxirre shpejt ta shikoj sepse të vara në telin e llampës elektrike!

Kel Fisti u zverdh e u bë si lulja e kungullit. Qimet e kresë iu ngritën përpjetë. Dukej mu si një iriq i frikësuar ferrash. Përpiqej t'i mbushte mendjen tjetrit se telefoni kish mbetur i hapur dhe gjithë shamatën e tyre po e dëgjonte Amerika!

Po tjetri, që i pati mbirë zemërimi nga palca e eshtrave, nuk donte t'ia dinte pse dëgjonte Amerika. Madje le të dëgjonte Amerika bashkë me Azinë dhe Afrikën po të donin; ai donte t'ia griste listën me emrat e qeveritarëve të rinj. Sepse ia kish punuar me të pabesë:



e kish shkruar në listë si ministër bujqësie!

Dhe të mendosh se këtë poshtërsi, ia bënte atij, ish shokut të vjetër, Zul Kukelit, i cili, kish marrë pjesë në shtatë greva urie. Ia bënte Zulit, që kish qenë gjithashtu në ballë të turmës gjatë protestave; Zulit, që kish luftuar si Hekuli kundër këtij sistemi të poshtër. Dhe tani që shteti u shemb e vendi u shkatërrua, ky burrec verdash, ta bënte ministër bujqësie, vetëm e vetëm për faktin, pse na paskësh studjuar për agronomi! Kurse për vete, na kish mbajtur postin e kryeministrit!

A nuk qe kjo një hata e padëgjuar ndonjëherë?!

Betërii Zul, fort i nxehur, ia hodhi pëllëmbën e dorës së djathtë pas qafës dhe e përkuli me forcë tjetrin si të deshte ta paloste për ta futur në ndonjë valixhe; ia rراسi kokën mes shalëve dhe derdhi mbi shpinën e tij një breshër grushtash.

“Kryeministri” e pa veten ngushtë me hallatet e tjetrit në parmë të qafës. Nuk kishte mënyrë tjetër shpëtimi, vetëmse të mblidhte të gjitha forcat, ta ngrinte hopa “ministrin e bujqësisë” dhe ta plaste në dysheme. Pastaj të ikte turravrap, të dilte jashtë, ku tjetri nuk mund ta rrihte në sy të kalimtarëve që venin e vinin.

Për ta bërë një gjë të tillë, “kryeministri” u stërmundua shumë. Jo vetëm që s’ia doli dot mbanë, por, - të na falë lexuesi, - i shpëtoi edhe një si pordhë e madhe. Kjo e fundit e bëri të zgërlaqej i turpëruar para kundërshtarit të tij zabërhan e të egër. Një tytësi në shpirt ia ligështoi gjallnimin. Sërish u kujtua për telefonin që kish mbetur i hapur dhe ra në një gjendje ligështimi edhe më të thellë. Po sikur, larg qoftë, ta kishte dëgjuar Amerika edhe atë pordhën që ai nuk deshë ta lëshonte, por që i shpëtoi nga halli e stërmundimi për të larguar Zulin e madh?!

Ndodhë nganjëherë, që edhe njerëzve, u nevojitet shumë ajo vetia e disa insekteve, të cilat, kur ndodhen në rrezik, për të larguar

armikun e tyre mizor, lëshojnë një lloj lëngu me kutërbim skandaloz.

Me të nuhatur që ajri u prish, betërri Zul, e la të shtrirë mbi dysHEME “kryeministrin” pordhac, zuri hundën me dy gishta dhe vajti të hapte kanatet e dritares.

Pordhaci shfrytëzoi rastin dhe u ngrit t’ia mbathte turravrap, por me të hapur derën, u përplas me Rita Bernardin, një gazetare e kronikës së zezë, që e pinte cigaren si një zonjë plakë.

Rita Bernardi, kish dashur të ngjiste shkallët e katit të dytë për të zgjidhur mosmarrëveshjen e fundit me dashnorin e saj Rubin Lazaratin, i cili, qe shef i një zyre integrimi të shoqërisë civile në jetën politike. Ajo kish dëgjuar zhurmën e pazakontë brenda zyrës së Kelit dhe kish vrapsuar me shpresën se mos peshkonte ndonjë lajm për gazetën.

- Ouu...! Më fal...! - ia bëri ajo dhe buzëqeshi. - Më erdhi si punë shamate... Sikur po rriheshin nja shtatë vetë...!

Ndërsa rregulloi kollaren dhe po përpiquej të fuste kindat e këmishës në pantallona, Kel Fisti, nuk i shpëtoi asaj gjendje pasigurie dhe hutimi që i mbërthen njerëzit në raste të tilla.

- Si thatë...?! Rriheshim...?! - foli ai duke u përpjekur të mblidhte veten.

- Askush nuk po rrihej këtu, - kërceu e tha Zuli, - Vetëmse po bënim një debat sporti rreth ndeshjes së fundit të kombëtares sonë me...

- Kombëtaren greke...- plotësoi Keli.

Rita Bernardi e kuptoi që ata të dy gënjenin, por nuk kishte pse ta zgjaste më tej. Rregulloi njëherë çantën mbi supin e saj të brishtë e tha:

- Më falni, por mua kështu m’u duk...!

Kjo dredhë në unison e kundërshtarëve para rrezikut të daljes së ndonjë lajmi për ta në gazetë e zbuti atmosferën.

“Kryeministri” u kthye pranë tavolinës së tij të punës, mori receptorin që kish mbetur varur në tel, e vendosi mbi aparat, - mjaft kish dëgjuar Amerika, djalli e marrtë, nuk kish ç’ të dëgjonte më tepër, - ngriti karrigen bashkë me disa shkresa për të vendosur pak rregull në zyrë, e pa e vështruar tjetrin, duke u dridhur nga frika pyeti:

- A do të merremi vesh si njerëzit, Zul...?

- Po, - tha shpejt Zuli i madh, - Do merremi vesh se s’bën, por nuk dua të më flasësh nga pozitat e kryeministrit. Dua të më flasësh si shoku-shokut, pasi ti e di, jemi rritur bashkë e kemi vrarë breshka me gurë në zabelin me dushk të Aqif Dermekut. Të kujtohet?

Në vend të buzëqeshjes, Kelit, i doli vetëm një përveshje e shpëlarë buzësh.

Gjithë frikë e hutim, ai mori nga një sirtar një dosje në ngjyrë blu të lidhur me fjongo të kuqe, e zgjidhi fjongon me duart që i dridheshin, hapi dosjen dhe nxori prej saj një fletë ku qenë shtypur me kujdes emrat e pjesëmarrësve në kabinetin e ri qeveritar.

- Duhet të kesh parasysh një gjë, ti Zuli, - e përkëdheli disi ai, pa asnjë lloj shkartisje nga pozitat e “kryeministrit”, - Emërimet në qeverinë e re, që unë kam ngritur për ta pasur gati pas zgjedhjeve, e kam bërë, jo duke u nisur nga dëshirat meskine të gjithësecilit, por e kam bërë duke u nisur nga interesat e larta të atdheut.

- Dakort, - tha tjetri, - Por mos më bëj mua ministër bujqësie pa më pyetur, ej...!

- Por ti ke studjuar për agronomi...! - arsyetoi gjithë frikë Keli si të deshte të zgjidhte fillin e ngatërruar.

Betëri Zul kërceu e tha:

- E pastaj...?! Xhemal Pallavozi a nuk qe me profesion veteriner dhe e bënë ministër drejtësie?! Po Renata Pogoni, ajo shtriga, mësuesja e matematikës, a nuk u bë ministre e kulturës?! Nuk është

ndonjë hata e madhe!

Kel Fisti, mori frymë thellë.

Duke ecur vijës së një rrethi, bëri një rrotullim si ai çakalli kur kërkon vend për t'u ulur, pastaj u kthye në beft, ngriti kokën, e si të deshte t'i vinte kapak kësaj pune, pyeti:

- A je i kënaqur, o Zul, po të të jap postin e ministrit të rendit publik? Ia kisha dhënë Gjelosh Murdarit, por meqë ke mbetur qejfprishur, po ia heq atij dhe po ta jap ty.

- I kënaqur jam..., - tha tjetri. Dhe, me shikimin gjithnjë të rrëzuar përdhë, u gëlltiti si qeni kur i tregojnë një llokmë të majme e shtoi: - Por, këtë ta kisha bërë më parë, të mos vinte puna si erdhi...

- E si ta dija unë më parë?! Unë sot u binda, që ti Zul, je i prerë për një post të tillë! - tha Keli.

Pikërisht kur po bënte korrigjimin në listë, u hap dera dhe ia behu aty llaveshi Gjelosh Murdari!

Dukej ashiqare, që e kish dëgjuar pas derës bisedën e tyre sepse i kish varur turinjtë pesë pëllëmbë.

Kish veshur një pallto të gjatë, të vjetër, të zbërdhlyët nga koha, të pahitur me zbokth te supet, së cilës, i qe bjerrur ngyra dhe i patën rënë kopsat. Kish mbetur vetëm një kopsë tek jaka pa u humbur. Lidhësja e këpucës së djathtë i qe zgjidhur, i qe bërë tërë baltë pasi e kish shkelur gjatë ecjes. Dukej si një rojtar shalqinësh të mbjellë në një fushë të hapur ku të grin era.

Gjelosh Murdari përshëndeti thatë duke u përpjekur të frenonte një ngucakeqje nën vete, athua se i kish kapur duke vjedhur në kopështin e tij. Duke rrotulluar ato sytë e tij të akullemtë si këlysh zardafi, me një shtiratë të bërë kinse pyeti:

- Ç'kemi ndonjë të re?

Kel Fistit iu tha pështyma në grykë.

- Hiç, - mezi pëshpëriti ai me gjysëm zëri.

- E di ç'ke ti zoti “kryeministër”...? - nisi të fliste Gjelosh Murdari duke mos e bërë dot zap zemërimin, - Pa ma fshij emrin tim nga ajo listë! Të ishte për ministër bujqësie, kisha qëndruar nga ana e partisë agrare unë!

U fut në bisedë Zuli i madh.

Zuli u përpoq të shpjegonte, se gabimi që bërë padashje qysh në fillim, kur që hartuar lista, dhe se “kryeministri”, e kish parë të arsyeshme ta ndreqte atë duke mos u ndikuar nga asnjë lloj shtyese a makinacioni veprues në kurriz të tij, por vetëmse kështu e donte interesi i lartë i atdheut.

Por Gjelosh Murdari, që patii përgjuar si brac prapa derës, nuk kish si bindej.

Plasi një debat, jo kush je ti e jo kush jam unë, në fillim me zë të vogël, pastaj duke i ngritur zërat çdoherë e më fort, derisa u ndezën gjakrat e u tendosën nervat; pastaj i qëndruan njëri-tjetrit kacagjelas kic më kic, dhe tek e mbramja, Zulit të madh, i kërceu delli një gisht në ballë: e kapi Gjelosh Murdarin për jakës së palltos, e duke e parë kokërr ndërsy me një vështrim gërgasës, i gatshëm në startin e një gjuajtje me kokë turinjve, i tha:

- E di ç'të punoj unë more injorant i dreqit?

“Kryeministri” Kel Fisti, u fut në mes e briti fort:

- Mosni bre, o burrat e dheut! Mosni, sepse po më detyroni të jap dorëheqjen e ta prish krejt qeverinë!

Gjelosh Murdari doli nga zyra përçudshëm, i heshtur e i zymtë, duke zier nën vete nga inati e zemrimi, por, u kthye sërish përmes derës që e pati lënë hapur.

Zuli i madh mori pozicion luftimi. E gjuajti me grusht dhe do ia kish thyer hundën, sikur Gjelosh Murdari të mos që përkulur për të marrë mbi dysheme kopsën e fundit, që i pati rënë nga jaka e palltos.

Ramiz Gjini

*Tiranë, vjeshtë, 1997*

## Atdheu prej bore

Kur bie borë, të rinjtë nuk bëjnë si pleqtë, që mbështillen gjer mbi veshë e struken rreth zjarrit në vëtër. Atyre u vlon gjaku në deje, duan të argëtohen, të vrapojnë, të gjuajnë me topa bore, të lozin e qeshin...

- Të rrëshqasim me slita tatpjetë rrugës që të shpie tek sheshi.

- Të ndërtojmë një shtëpi prej bore.

- Të zëmë pusi pas një qosheje, të gjuajmë kalimtarët...

- Të sajojme një burrë me sy prej thëngjilli e hundë karote, një burrë që ta tallim të gjithë...

Martin zeshkani, si më i rritur nga të tjerët, i ndërpret e thotë:

- Përse nuk bëjmë një atdhe të tërë, një atdhe prej bore? Të dalim në fush të hapur dhe të ndërtojmë nga e para gjithshka na duhet.

- Edhe dyqane? - pyet Frida flokgjata.

- Po, edhe dyqane, edhe rrugë me tunele. Të ngrejmë ura, poshtë të cilave, të rrjedhin lumenj; të ndërtojmë pallate të mëdha, të bëjmë edhe njerëz, jo të këqinj si Baci i Noke, por njerëz të mirë, që e duan atdheun.

- Po sikur, pastaj, të na e marrin atdheun ata të Mëhallës së

Poshtme?

- Po sikur të na bombardojnë me topa, të na i vrasin njerëzit e atdheut tonë, të na rrëzojnë pallatet dhe urat?

- Po sikur të na vijnë të rriturit e të na thonë: ikni prej këtej sepse ky atdhe nuk është prej vërteti?

- Po sikur të tallen me ne kur të largohemi, të na thonë që kemi braktisur atdheun?

- Nuk do ta braktisim - thotë i vendosur Martin zeshkani, - madje do ta ruajmë atë gjithë natën, gjer në mëngjes. Do ta qarkojmë rreth e rreth me një mur të madh bore, një mur me bedena ku të bëjmë roje në të gjitha anët.

Pesë fëmijët e vegjël marrin vrapin larg katundit, për atje, në fushë të hapur, ku ka plot dëborë e ku u ka shkrepur të ndërtojnë një atdhe, një atdhe krejt të tyrin, të bukur, të madh e të gjerë sa të ha syri; një atdhe që ta kenë lakmi jo vetëm ata të Mëhallës së poshtëme, por gjithë zona përreth.

E filluan me një shtëpi të vogël, një shtëpi të përbashkët, që do të shërbente si pik-nisje për të kryer të gjitha ndërtimet e tjera.

Të nesërmen, u mblodhën sërish ku ia nisën punës e hapën dymbëdhjetë rrugë, që pasi i binin qark e qark atdheut, takoheshin mu në mes me njëra-tjetrën.

Ditën tjetër, rreth këtij kryqëzimi ndërtuan kryeqytetin. I madh e i bukur sa s' bëhet; me gradaçela të larta, pallate, shkolla, ura me harqe, kënde të mrekullueshme lojrash, kopshte e spitale.

Kur filluan të ndërtonin murin rrethues të atdheut të tyre, një burrë nga Mëhalla e Poshtme, që kaloi aty pari, u tha të shpërndaheshin nëpër shtëpi, sepse bënte ftohtë. Por ata nuk e dëgjuan. E panë me dyshim, madje dërguan Evis syukaltrin që ta ndiqte pas gjersa të zhdukej prapa kodrës, nga ku niste Zona e dushqeve.



Kur Evis sykaltri u kthye, tha se Burri i Mëhallës tjetër kishte shkuar në punë të tij dhe se nuk i kërcënonte asnjë rrezik.

Atëherë, të kënaqur, ia nisën sërish punës me një vrull të ri derisa e futën atdheun në rrethim të plotë.

Kur gjithshka pati përfunduar, qielli nisi të hidhte sërish borë, një borë e imët, që përplasej në fytyrat e tyre të njoma, u lagte hundët e skuqura të bëra si spec dhe i detyronte të picërronin sytë kur shikonin njëri-tjetrin.

Patën frikë se mos ndoshta flokët e borës rriteshin, dhe atëherë, atdheu i tyre do të mbulohej i tëri me një vello të bardhë, të përmortshme. Por nuk zgjati shumë dhe ata u qetësuan, sepse qielli nuk po hidhte më borë.

Atje larg në perendim, mbi malet e zhveshura, u shfaq një diell indiferent, që hodhi rreze të ftohta mbi atdhe. I gjithë atdheu i tyre i bardhë, nisi të rrezatonte me një shkëlqim të kristaltë. Atëherë i kaploi një ndjesi e çuditshme, që i bëri ta ndjenin veten zotër të vegjël të një atdheu të bukur, ku nuk mungonte asgjë; ku gjithshka e kishin të tyren, sepse e kishin ndërtuar vetë me mundë e djesë.

Gjithë ditën ecën nëpër rrugët që kishin hapur vetë. Bënë vizita në shkolla. Hynë në klasat ku mësues të sajuar me shkopinjtë të vegjël thane qëndronin në këmbë, me një pamje pedante para nxënësve, që dëgjonin me vëmendje nga frika e ndëshkimit; vizituan të sëmurë të sajuar prej koçanësh të vegjël misri, që i kishin vendosur mbi shtretër të butë e të rehatshëm, folën me mjekët, të cilët, nuk kish qenë nevoja t'i vishnin me bluza të bardha. Pyetën dhe morën përgjigje imagjinare. U shkrinë së qeshuri, me rojen e portës, që në vend të kapeles i patën vendosur në kokë një gjysëm lëvozhge arre, ndërsa në dorë shtrëngonte një puro prej gjethesh dushku. Kontrolluan pallatet dhe gradaçelat se mos kishin lëvizur nga pika e mbështetjes; dhe rrugëve, tek-tuk, vendosën shitës ambulante,

veshur me të bardha, që u shisnin akullore e lloj-lloj ëmbëlsirash femijëve të vegjël; madje porositën edhe për veten e tyre dhe bënë sikur i hëngrën me kënaqësi. Takuan edhe një buburrec të zi, gjysëm të ngordhur, që kish dalë në rrugë gjatë punimeve; e kapën me kujdes dhe e vendosën në një pikë mjaft strategjike, në veri të atdheut, që kur të lindëte nevoja, ta përdornin si tank kundër invazionit të Mëhallës së Poshtme. Vizituan miniera dhe kantjere të mëdha ndërtimi ku takuan e biseduan me inxhinjerë të zotë, të cilët, punonin natë e ditë për ta bërë atdheun më të bukur. Teksa ecnin drejt qendrës së kryeqytetit, i bënë vërejtje Dardan qukësit, sepse nga pakujdesia, për pak sa nuk shembi një qiellgërvishtës.

I thanë të tregohej më i kujdesshëm kur shkelte rrugëve të atdheut, sepse një gjë e prishur, nuk mund të ndërtohej sërish ashtu siç kish qenë më parë.

E donin me gjith shpirt atdheun e tyre.

Pak para se të perëndonte dielli, Evis sykaltri propozoi të ndanin detyrat, pa bërë fjalë e pa u zënë me njëri tjetrin.

Me marrveshje të plotë, ata i thanë Martin zeshkanit, që si më i rritur që ishte, e kishin zgjedhur të parë. Pastaj iu lutën atij t'i emronte në postet përkatëse.

Nuk ishin shumë të qartë rreth sistemit të qeverisjes. Dy qenë për monarkinë, tre të tjerët, për republikën.

Dardan qukësi, duke ju marrë goja, tha me zoritje, se me gjithë respektin dhe konsideratën e lartë që kishte ai për Martin zeshkanin, i duhej të deklaronte, që një monark, kishte shumë të drejta, dhe, mbase ndonjë ditë, mund t'i shkrepse në kokë, ose t'ua shiste atdheun atyre të Mëhallës së poshtme, ose ta shkatërronte fare duke e gjuajtur me shkelma.

Kështu, ranë ndakort për republikë.

Zgjedhën edhe ministrat ku më trimit, Denisit të vogël, i lanë

të drejtonte Ministrinë e Mbrojtjes.

Kur postet qenë ndarë, Denisi i vogël, vendosi ushtarë prej bore mbi të gjitha bedenat e murit të madh rrethues. Ndau detyrat për gjithsecilin, u tha t'i bënin sytë katër, sepse andej nga Mëhalla e poshtme kishin filluar të dëgjoheshin zëra ushtarësh armiq, të cilët, patën marrë vesh për atdheun e tyre dhe egzistonte mundësia, që të vinin ta shkatrronin gjatë natës.

Gjithnjë kishin qenë në armiqësi me ata: shaheshin me fjalë të ndyra, gjuheshin me topa bore, ua prishnin lodrat e lojrat, talleshin e përqesheshin si mosmazot. Por tani që kishin ndërtuar një lodër kaq të bukur, një atdhe të kristaltë prej bore ku nuk mungonte asgjë dhe të gjithë ishin të lumtur, duhej t'i bënin sytë katër. Ta mbronin atë me çdo kusht, që edhe të nesërmen të krenoheshin e t'i gëzoheshin veprës së tyre.

Të rrinin në rojë, të paktën deri sa të fillonte të errësohej, pastaj le të shpërndaheshin nëpër shtëpitë e tyre për t'u mbledhur sërish të nesërmen.

Dhe u betuan.

Lidhën duart me besabesë siç bënin dikurë të parët. Sepse, siç thamë, atje matanë, qenë në dijeni për atdheun e tyre; dikush, ndoshta ai burri që kaloi aty pari, kishte spiunuar. Në Mëhallën e Poshtme qe dhënë berihaja. Tashmë janë alarmuar të gjithë vërsnikët, kanë dalë nga shtëpitë, janë mbledhur e kanë ngritur ushtri. Thurin plane për të mësy drejt atdheut të tyre të bukur. Kjo duket qartë sepse dëgjohej zëra, britma e ulërime, sharje e mallkime, që dalin nga gojët e këqia.

Sa gjë e poshtër kur mendon se e gjitha kjo, ndodh vetëm pse këta, me mëndjet dhe mundin e tyre ndërtuan një atdhe kaq të bukur.

Dalngadalë dielli humbi. Bashkë me të perendoj edhe ajo bukuri e kristaltë, që pati shpërthyer në mijëra rrezatime anë e mbanë atdheut të tyre.

Nga veriu ia mbërriti një erë e ftohtë, që filloi t'ï ngrinte gradaçelat, shkollat, spitalet, pallatet, urat e gjithshka patën ndërtuar. Kur nisi të binte errësira, godinat u bënë më të forta, më të qëndrueshme. Tashmë mund të mbështeteshe fare mirë pas një pallati, pa frikë se mund të rrëzohej, të hidhje vështrimin matanë atdheut, ku çirreshin nga zilia e urrejtja ata të Mëhallës së poshtëme, vetëm e vetëm pse s'kishin një atdhe si të tyrin.

Kur nata, e ftohtë dhe e frikshme pati zbritur krejt mbi tokë, të gjithë u futën nëpër ngrehinat e tyre prej bore për t'ï ngrohur pakëz; sepse edhe ata, ushtritë armike të Mëhallës së poshtëme, nuk mund të vinin kaq në bef, pa u dëgjuar, të paktën, një shkrap-e-shkrup mbi borën e ngrirë. Sigurisht që do t'ï ndjenin, dhe atëherë, do të jepnin kushtrimin e luftës, do të dilnin të gjithë për të luftuar në mbrojtje të atdheut. Do ta mbronin atë nga shkatërrimi i atyre barbarëve, që jo vetëm nuk donin të ndërtonin vetë asgjë, por, të pushtuar nga një urrejtje e verbër, donin të prishnin e shkatërronin edhe gjithshka ndërtonin me mund e djersë të tjerët.

Evis sykaltri ndjeu t'ï vinte gjumë sepse qe lodhur, por mendja i punonte për bukuri. Nuk ishte gjë e vogël të ndërtoje një atdhe në një kohë kaq të shkurtër dhe sërish të ndjeheshe i fortë, i gatshëm për t'ï futur në betejë, në mbrojtje të tij. Iu kujtua ajo ura me harqe, që ndërtuan tek rruga e dymbëdhjetë. Doli pak si shtrembër dhe jo aq e lartë sa duhej, ndaj nesër, do të paraqiste një kërkesë para Fridës flokëgjatë si Ministre e Ndërtimit, që ta prishnin dhe ta ndërtonin edhe njëherë tjetër, më të lartë, më të gjerë e më të bukur.

Si në ëndërr iu bë se dëgjoj zërin e nënës, frymëmarrjen dhe

atë fëshfërimën e lehtë të fustanit të saj. E pa teksa po ecte nëpër shtëpi disi e shqetësuar, si të deshte të kërkonte një gjë të humbur. Pastaj ndaloi para tij, dhe, ndërsa e vështronte plot dhembshuri, i tha se e donte fort. Së fundi iu bë sikur përkundej në krahët e saj, ndërsa nisi t'i këndonte një këngë nga ato që i pati kënduar kur ishte më i vogël.

Në mes të dhomës, soba e mbushur plot me dru, bubullinte me një flakë të kuqëluar, që hidhej të dilte përmes derës së saj të vogël dhe i vishte muret e lyster me gëlqere me brerore dridhëuese drite. Babai e mori Evisin në krahë, e ngriti hopa që ai të prekte tavanin, për t'i treguar edhe një herë se sa do të rritej. I kish blerë atij edhe një makinë me kurdisje... U kujtua se kjo, ende nuk kishte ndodhur në të vërtetë; ai vetëm i kishte premtuar, dhe, sigurisht, do ta mbante premtimin. Do të shkonte në qytet dhe kur të kthehej, do të hapte çantën mu aty, para tij, do të nxirrte makinën me kurdisje dhe... Çfarë gëzimi!

Evis sykaltri do t'i hidhej në krahë të atit, do ta përqafonte e puthte fort...

Tashmë qenë ngrohur. Nuk ndjenin më të ftohtë si më parë, ndaj të gjithë u ngritën e dolën jashtë ku për çudi, ata panë se kishte zbardhur një ditë e re, e mrekullueshme! Bora kishte shkrirë gjithandej rreth atdheut të tyre, por atdheu kishte mbetur aty me të gjitha; me gradaçelat, pallatet, shkollat, spitalet, urat e rrugët... Të gjitha prej bore të ngrirë.

Kishte ardhur pranvera me të ngrohtin e saj. Kishin çelur lule në kopështet e lulishtet, që patën ndërtuar vetë. Bari që harlisur, pemët qenë mbushur me gjethe të gjelbërta dhe zogjtë këndonin nëpër degë. Shermashekët vareshin mureve të ndërtesave prej bore të kristaltë dhe gonxhet e trëndafilëve ua bënë me sy pesë

Ramiz Gjini

shpirtërave të vegjël, që ngriheshin drejt qiellit.

*New York, 2003*

## Një djallushkë e bekuar prej Zotit

Ndodhi të hënën që shkoi: mu desh t'i drejtohesha një farmacie për të blerë aty një pomadë A+D+E, pasi gruas time i pati dalë një puçërr në majë të hundës. Por s'qe e thënë ta blija, pasi para meje u shfaq Keti Sedefi. Më ndaloi në mes të udhës e duke buzëqeshur djallëzisht tha:

- Do të të fus të gjallë në dhë, Kamil.

Për një çast e humba, por shpejt e mblodha veten e ia ktheva:

- Një gjë e tillë s'më pëlqen, dhe për më tepër, mendoj se më ngatërro me tjetërkënd.

- I ke rënë pikës, - tha ajo, - vërtet që ma ka shkrepur të të ngatërroj.

Dhe nisi të levizte gishtërinjtë si një xhonglere, të vërviste në ta një kordele, t'i jepte formën e një tulipani, ndërsa ndjeva si më shpoj mu në zemër ai vështrimi i syve të saj të kaftë.

Atëherë, duke i dhënë zërit një ton disi kërcënues, i thashë se isha burrë i martuar, se shquhesha për marrdhënje korrekte me gruan time, dhe se po më pengonte të kryeja një porosi të saj.

- Kjo nuk do të thotë gjë, - ma ktheu ajo. Dhe shtoi: - Më prit

sonte natën, Kamil.

Dhe iku duke tundur vithet mu si një mushkë motake.

As që më kishte vajtur në mend, se mund të më tralliste e bija e një lulishtari, i cili, për çdo ditë që ka dhënë Zoti, me një palë gërshtë të hatashme në duar, priste e hidhte përtokë frytet e punës së tij.

Pati mbërritur në qytezën tonë para dy muajsh dhe bashkë me të atin bahçevan, që vendosur në shtëpinë e vjetër të Kel Fistit, i cili, vajti të banonte, më duket, në Amerikë.

Taborri i grave namuzlie zbuloi, se kjo ardhacake, që e meritokesh dhe se meritokesh ta quaje bukuroshe, na qenka fort e dhënë pas insekteve. Paskesh futur në shtëpi edhe një koleksion të tillë mikrogjallesash, të cilat, lëshonin një zukamë që mund të ta kapte veshi vetëm po që se ndaloje pranë shtëpisë së saj, sidomos në orët e vona të natës, kur fashitej krejtësisht zhurma e rrugës.

Javën e parë të mbërritjes nuk doli fare nga shtëpia. Ndërsa në ditët që pasuan, gjindja e panë të shëtiste e vetmuar herë pas here në një rruginë gjysëm të shkretë.

Kaq mund të thuhej për Keti Sedefin, sepse gjysma tjetër e portretit të saj vazhdon të mbetet në errësirë.

Në shtëpi, gruaja më priti gjithë hundë e buzë:

- Sërish paske harruar ta blesh atë dreq pomade A+D+E?!

Dhe i vari turinj të gjer nën mjekër.

Si thashë as po, as jo. Ndërsa ajo, si ngaherë, nisi të ankohej për punët e shtëpisë që s'mbaruakan kurrë, të përcillte me rropamë sendet që zinte me dorë, si dhe të mërmëriste fjalë, që s'ia mbante t'i thoshte me zë të lartë.

E gjeta të udhës të futesha në dhomën tjetër, të shtrihesha për shtatë palë qejfe në një divan, të shfletoja një libër me histori ciganësh, që më pati mbetur përgjysmë, dhe ndërkohë, të prisja



patatet që piqeshin në furrë.

Nuk kisha shfletuar as katër fletë nga libri, kur që nga porta kryesore, më erdhi në vesh një trokitje e lehtë. Pandeja se më kishin bërë veshët, por nuk qe ashtu, sepse trokitja e parë u pasua nga një e dytë dhe menjëherë pas saj, një pëshpërimë:

- Hape, Kamil... Jam Ketj.

Një të kërcyer, mbërrita tym pranë portës, dhe pa e hapur atë, iu gërmusha nga brenda:

- Mallkuar qofsh Ketj Sedefi! Nëse nuk do të largohesh menjëherë, dije se do të të padis tek gruaja.

Dëgjova të qeshte me kukurisje, si një fëmijë që s'do t'ia dijë për rrengjet që u punon të tjerëve, ndërsa thoshte:

- Jo mirë kështu, Kamil... Jo mirë kështu...! Po më detyron të të hedh një lak dhe të ta shtrëngoq sa herë të sillesh keq. - Dhe si pushoi një çast shtoi: - U pa puna... Po shkoj të gjej lakun.

Pastaj munda të kap vetëm atë zhurmimin e lehtë të hapave të saj, teksa largohej nëpër kopësht.

Kur u sigurova se qe larguar, çela portën dhe dola jashtë në oborr.

Ishte një nga netët e nxehta të gushtit që pasonin ditët e djegagurit. Qielli me yjet dukej mu si një mangall i stërmadh plot me prush i kthyer përmbys. Pata ndjesinë, që sipër këtij mangalli, kishte hypur Ketj Sedefi dhe sapo të më shikonte, do ta tundëte për të derdhur mbi mua gjithë atë prush qiellor, ndaj hyra nxitimthi në shtëpi.

Gruaja nisi përsëri të më gërricte nervat me atë avazin e pomadës A+D+E, që unë kisha harruar të blija.

- E katërta herë që harron, - shfryu sërishmi ajo. Dhe duke më hedhur një vështrim prej kunadheje shtoi nëpër dhëmbë diçka si "je qorrollepsur" a "je budallepsur".

- Mjaft tani, - guxova e i thashë, - Një puçërr e vogël të ka dalë, s'u bë hataja.

Por ajo u dëshpërua pikërisht si të kishte ndodhur hataja! U ngrit, vajti në dhomën e fjetjes, u rras në krevat, ndërsa mërmëriste nëpër dhëmbë fjalë nga ato që s'ia mbante t'i thoshte me zë të lartë. Më pas duhej ta kishte marrë gjumi, sepse zëri i saj humbi.

Andej nga e vona, pasi mbusha barkun me patate të pjekura, piva një shurup thane dhe ndoqa gjerë në fund një ndeshje futbollit, që të them të drejtën, më zhgënjeu. Pastaj vajta në dhomën e fjetjes, i pushtuar nga një parandjenjë e ligë, ndoshta pse diku nga jashtë më vinte në vesh kënga e përvajshme e një kukuvajke. Në çastet kur po zhvishesha, mu bë se ndjeva një zhurmim të lehtë, një si rrekje prej hajduti për të çelur parvazin e dritares, dhe tek e mbramja, mendja më shkoi te Keti Sedefi. A nuk ishte ajo që tha se po shkonte të gjente një lak për t'u kthyer sërishmi? Duhej vlerësuar çështja e duheshin marrë masat e sigurisë. Puna e parë që bëra, kontrollova dritaret dhe pashë se qenë të mbyllura. Atëherë ula grilat, pastaj vajta e rrotullova për herë të dytë çelësin e portës kryesore, si dhe i rrasa dy shulet, poshtë dhe lart. Por sërish nuk e gjeta dot atë qetësinë e duhur, pasi një djallushkë si Keti Sedefi, mund të kruspullojej, të bëhej, ndoshta sa një brumbull dhe të rrëshqiste pa ndonjë vështirësi midis hapsirës milimetrike që ndan fundin e derës me dyshemenë. Mund të ndodhte të shndërrohej edhe në një bukurezë, nga ata që shfaqen kopshtijeve netëve verore, të ndizte kandilin e saj fosforeshent dhe në dritën e këtij kandili, të gjente një vrimë a shteg për t'ia mbërritur tek unë; ndaj vendosa t'i mbyllja të gjitha vrimat dhe plasat, që t'i prisja rrugët e të evitoja çdo mundësi që do ta sillte tek unë; për t'u ndjerë më në fund krejt i sigurtë, për të bërë një gjumë të qetë në shtëpinë time, në krevatin tim dhe me gruan time të ligjeshme. Ndeza të gjitha dritat brenda shtëpisë, dola

sërishmi jashtë dhe që nga errësira, zbulova vendet ku ndodheshin vrimat e vogla si dhe plasat nga ku buronin skurrile të holla drite; sepse këto skurrile drite, mund t’i shërbenin djallushkës Keti Sedefi si udhëza të sigurta për t’ia behur tek unë orë e paorë, kur të donte e si të donte, pavarësisht dëshirës sime.

Pasi kisha përcaktuar ku ndodheshin këto vende, hyra në shtëpi, mora tul të ngrohtë buke, e përpunova me gishta, e bëra baltavec dhe bllokova me të vrimën e çelësit si dhe të gjitha vrimat që kisha zbuluar. Plasat e holla të derës dhe dritareve i lyeva me një llak të trashë, gjysëm të skaduar. Më vajti mendja: një djallushkë si Keti Sedefi, mund të shndërrohej edhe në një larvë bretkose, pastaj të futej në shtëpi përmes tubacioneve të ujit, ndaj vajta në guzhinë e banjo dhe shtrëngova mirë rubinetat. Hapësirën milimetrike midis fundit të derës dhe dyshemesë e mbylla me një leckë të lagur me vajguri, pasi kisha lexuar diku, që vajguri na qenkësh një tmerr i vërtetë për insektet. Dhe, kur të gjitha këto bubërritje kishin përfunduar, i thashë vetes burrë me një barrë mend dhe shtova: “Tani më marrsh të keqen, o Keti Sedefi!” Dhe hop, një t’u ngritur, vajta e hyra në shtrat.

Isha në shtëpinë time, në krevatin tim dhe me gruan time të ligjëshme.

Do të më kishte kapluar gjumi, sikur të mos kisha ndjerë në vesh firomën e lehtë e të ngrohtë të një pëshpërimë:

- Më bëj vend Kamil... Dhe mos u ndje...

Domosdo, që e merrni me mend se ishte ajo, djallushka Keti Sedefi.

Qe përkulur mbi mua, ndërsa në qafë më kish hedhur lakun e një konopi mëndafshi, nga ato që këpucarët i nxjerrin prej rrypave të trasmesionit dhe pastaj u mburren me ta klientëve kur u qepin këpucët. Ç’të bëja?

- Futu në shtrat, - i thashë si një viran, - Veç me kujdes, aman,

se mos na zgjohet gruaja.

Ndërkohë lëviza ngadalë që t'i bëja vend nga ana tjetër.

Keti Sedefi më shtrëngoi njëherë lakun si për të më treguar se duhej t'i bindesha e tha:

- Ka vetëm një vend për mua, Kamil. Dhe ky vend është mes teje dhe gruas tënde.

Dhe si të ishte ajo, që nuk duhej ta zgjaste, hyri në shtrat, i ktheu kurrizin gruas, u struk puqpërpuq meje dhe nisi të më numëronte rrahjet e zemrës.

- Më duhet t'i numëroj, sepse këtej e tutje do të jenë për mua, - tha. Dhe shtoi se për çdo rrahje zemre, do të më jepte si shpërblim plot dhurata të çmueshme.

E vështroja i përhumbar, gjithë frikë e mosbesim...

- Nuk beson? - pyeti një çast Keti Sedefi, - Vërtet nuk beson? - vijoi sërishmi ajo. Dhe lehtë - lehtë, pa m'i shqitur asnjë sekondë sytë-bakër, ç'kopsiti kopsat e fustanit të saj ngjyrë rozë dhe atëherë pashë se si kërcyen e zbardhëllyen në gjysëmerrësirë dy gjinj të plotë e të rrumbullt si ftonj të pjekur Elbasani.

- Oh, Keti Sedefi, - rënkova, - Ti je një djallushkë e bekuar prej Zotit... - Dhe iu luta, tek e pakta, të më hiqte lakun.

- Shshsht..., - ia bëri qortueshëm ajo. Dhe shtoi: - Laku shkon bashkë me thesarin.

- Të paktën më thuaj nga hyre? - mezi pëshpërita, sepse pështyma më qe tharë në grykë.

- Gjithnjë ka një hyrje të fshehtë, që veç ne femrat e dimë, - tha ajo.

Dhe nisi të lazdrohej, të kotovalej, të shpështillej si një gjarpërushë brevë, të qeshte si një koketë, të më kobiste, të kërlleshej, të më mbërthente si gjeraqinë, të merrte e të jepte ç'të deshte si e marrë, të më hurbte çikë e nga një çikë, të më

tralliste, çapaliste, lektiste e telikoste si mozamazot, derisa nisëm të cërhatnim si urët e një zjarri.

Por ja që ime shoqe lëvizi përgjumësh, dhe, kur unë i hodha sytë, mu duk e çmeritur, ndërsa lëshoi një si mekërimë që të këpuste shpirtin.

Më teptisi gjaku në kokë. Thash me vete, të dalë ku të dalë! Dhe me mendjen top, që ta nxirrja jashtë zhakthi, e mbërtheva Keti Sedefin për supesh, dhe, padyshim që do ta kisha bërë një gjë të tillë sikur atë çast të mos qe zgjuar gruaja:

- Lëshoje, Kamil! Ç'bën kështu? Nuk shikon që e bërë lëmsh çarçafin dhe po na shkep dyshekun?!

Ndërkohë isha ngritur ndenjur. Me vështrimin e përhumbur gjithnjë në kërkim të Keti Sedefit, mundohesha t'i shpjegoja gruas një farë ëndërre plot llahtar, ku dy ciganë kurrizdalë, përpiqeshin të më hidhnin në kraterin e një vullkani, nga i cili, herë pas here, shpërthente një llavë e nxehtë pomade A+D+E.

*Tiranë, vjeshtë, 1997*

## Turmë

I pari i tha të dytit:

- Shteti ra, tani do të pllakosë zia e bukës. Të mblidhemi, të sulmojmë magazinën e rezervave të grurit.

I dyti vrapoi për në shtëpi të merrte thasët dhe një kafshë ngarkese. Rrugës ai takoi një të tretë. I tha:

- Magazina e grurit po sulmohet. Të vrapojmë si të gjithë të tjerët...

I treti ishte nisur për në qytet, por ktheu rrugë. U nis drejt të katërtit, e gjeti dhe i tha:

- Është shembur shteti, do të vdesim nga uria. Shpejt merr thasët, të nxitojmë drejt rezervave të grurit.

I katërti e la punën që po bënte, fluturoi drejt të pestit...

Dhe ja, pothuaj në një orë, qindra njerëz, janë grumbulluar e qëndrojnë përpara derës së magazinës. Një mori e tërë gomerësh, mushkash, kuajsh me samarë e të mbrehur në karroca të ndryshme, lidhur e zgjidhur, presin prapa turmës të zotët e tyre. Mbi shpinat e kafshëve, në ajrin e rënduar nga vapa, një taborr mizash imcake plehu, fluturojnë, ngrihen e ulen, vijnë rrotull e rrotull. Veçse njerëzit duken

disi të zhgënjyer, pasi të gjitha sa u thanë, nuk dolën të vërteta.

Dera e magazinës është e mbyllur. Pranë saj, me pushkën hedhur në sup qëndron roje Mul Dermeku, - guri i fundit i ngrehinës shtetërore. Quhet Mul Dermeku por të gjithë e thërrasin Mul Shurdhani ngase nuk dëgjon nga veshët. Vetëm të bërtiturat me zë të lartë, fishkëllimat, boritë e automobilëve dhe të pallurat e gomerëve i dëgjon disi. Veç kësaj, natyra e ka bërë edhe thuthuq. Ai shikon se pranë magazinës, që shteti ia ka lënë ta ruajë, janë grumbulluar shumë njerëz, por nuk kupton çfarë duan të bëjnë. Në shenjë paralajmëruese dhe për efekt psikologjik, roja shurdhan, ecën gati me hap rreshtor prej gjysëm ushtaraku duke përshkuar segmentin nga njëri cep i magazinës në cepin tjetër. Kur e kur ngre supet dhe zgjat përpara atë qafën e tij hollake, si të dojë të nuhasë mirë rrezikun që i kanoset. Një jetë të tërë e ka kaluar roje, si një qen i urtë e i bindur. Shurdhëria i ka forcuar intuitën për të kuptuar e kujtuar në kohën e duhur atë pikë të rregullores së shërbimit, që duhet zbatuar në momente rreziku. Ndërsa Mul Shurdhani vazhdon ecejaket duke përplasur ato këpucët e tij të vjetra ushtarake, një zë i fuqishëm gjëmoi:

- Mbathja në shtëpi, o Mul, se shtet nuk ka më. Nuk ke ç'bën i vetëm me një pushkë pa fishekë.

Mul Shurdhani nuk e rroku kuptimin e këtyre fjalëve, por, mënyra se si i erdhi toni i zërit, e bëri të ndërmendëte pikën një të rregullores, të cilën, ai e kish mësuar përmendësh prej kohësh. Ndaj, pa e prishur aspak terezinë, duke ndaluar për një çast, tha:

- Kam pethë fëmijë për të uthqyer. Thteti më ka vënë këtu dhe unë e përfaqëtojq atë, - Dhe nisi përsëri të ecte kryelartë, me atë hapin e tij gjysmëushtarak.

Nga krahu i djathtë i turmës, një xhambaz kuajsh, ia pati me sa i hante zëri:

- Po ne nuk kemi fëmijë për të ushqyer? Nuk është e hijshme të qëllosh mbi bashkëkombasit e tu.

Dhe një tjetër nga e majta:

- Ik ore mbushu me gjithë atë pushkë! Përfaqësokë shtetin ti, mi i rrjepur!

Përfaqësuesi i fundit i shtetit as që donte t'ia dinte për ato që këputeshin në adresë të tij. Përsëriste me vete nenet e rregullores, ndërsa në duar shtrëngonte armën. Më pas ndaloi, dhe, disi i nxehur, me një gjest që do t'i shkrinte gazit njerëzit, nxori nga një vezme e vjetër katër fishekë dhe duke i treguar nga turma tha:

- Puthkën e kam me fithekë, ta dini ...

Si reshtën të qeshurat, doli nga mesi i turmës një çalaman këpucëgrisur, që nuk dihej pse njerëzit e thërrisnin “Filozof”.

“Filozofi” nisi një ligjëratë të gjatë, për t'i mësuar shurdhanit ato që kishin ngjarë. Në përfundim ai tha:

- Pra, siç e thashë, as qeveri as shtet nuk ka më. Vetëm ti Mul ke mbetur... Jo se je njeri i keq, por nuk ke dëgjuar çfarë ka ndodhur... Je shurdhan.

Prapa turmës hingëlliu një pelë alle. Pastaj pela u hodh përpjetë e gjuajti me shkëlma një gomar ngordhalaq, që zgjaste turirin e nuhaste prapanicën e saj. I zoti i pelës urdhëroi të lidhej gomari që përpiquej të prekte në nder pelën e tij. Kur plasën të qeshurat, “Filozofi” u revoltua keq. Duke ulur tonin e zërit, tha se nuk ishte koha për shaka dhe se duhej bërë ç'ishte e mundur, që të bindej Mul Shurdhani, ndryshe nuk mbetej tjetër veçse të suleshin me yrysh të gjithë njëherësh për të shqyer portën e hyrjes. Xhambazit të kuajve i erdhi për shtat kjo e fundit. Imitoi një britmë luftarake indianësh. Pastaj duke numëruar gjer në tre, sokëlliu sa i hante gurmazi:

- O burra, përpara...!

Baticë.



Tre krisma të thata njëra pas tjetrës rrahën qiellin. Turma u ndal si ta kishin gozhduar në vend. Pushka që drejtuar në drejtim të saj. Zbaticë.

Dyll në fytyrë, e duke shtrënguar fort armën me duart që i dridheshin, Mul Shurdhani tha:

- Pika një e rregulloreth, veprimi i parë - paralajmërueth, tre plumba në ajër.

Pllakosi një heshtje mortore. Pastaj zëra nga turma:

- E paska me gjithë mend...!

- Thashë unë, ai vret edhe bashkëkombasit e vet.

- Rregullorja nuk thotë të gjuash në turmë.

Atëherë “Filozofi”, hypi me vështirësi mbi një grumbull gurësh, u kthye nga turma, ngriti duart lart, e bëri atë të heshtë e tha:

- Shokë të dashur! Dëgjoni dhe merrni vesh: Mul Shurdhani ka të drejtë. Kështu si jemi ne, jemi turmë... Dhe turmë do të thotë... Të organizohemi që ta marrim me rregull grurin.

Dhe si pushoi një çast, u mbush me frymë, u kollit, nxorri shaminë, fshiu hundët e vijoi:

- Pra, siç e thashë, të bëjmë një listë. Listën ta përpilojë vetë Mul Shurdhani duke vënë së pari emrin e vet në krye. Më pas, sipas radhës, të marrim grurë. Kush mendon si unë le të thotë...

U dëgjua e pallura e zgjatur e një gomari. E qeshura kolektive gjëmoi si përplasja e dallgës në një breg shkëmbor. Pastaj zëra nga turma:

- Mul Shurdhani nuk di të shkruajë...

- Mos e merrni me të keq...

- E ç’hyn këtu organizimi...

- Të sulemi me yrish, të gjithë njëherësh...

- Kujdes! Ai do të zbatojë pikën dy të rregullores...

Por turmës iu zgjua demoni i furisë. Vrapimi i befasisëm, një

vrapim krejt i çmendur, britmat e ulërimat, thirrjet e të qeshurat bënë që pika dy e rregullores të ikte nga kujtesa e Mul Shurdhanit. Porta, që pak më parë dukej sikur nuk do të hapej kurrë, u shkallmua sa çel e mbyll sytë. Shurdhani, që thoshte se nuk do ta dorëzonte shtetin, humbi në vorbullën e madhe të njerëzve si të qe një lëmizhde e hedhur në lumë. Hyrja e magazinës, nisi ta përthithte turmën me një pangopësi prej lubie dhe në gjysmë minuti kohë, kishte mbetur jashtë vetëm një pakicë e vogël prej pesëdhjetë vetësh. Edhe ata jepnin e merrnin duke shtyrë njëri-tjetrin. Por magazina nuk nxinte më as edhe një këmbë njeriu. Qindra këmbë ngjitur lëviznin me vështirësi duke u zhytur në grurë. Secili shtynte shokun ngjitur tij. Të dobëtit rënkonin e ankoheshin, të fortët bërtisnin e kërcënonin. Në fare pak kohë, mjegulla e dendur e pluhurit, u ngjit me shtëllunga drejt tavanit. Era e djersës shponte hundët. Pluhuri të merrte frymën. Kollitje, britma, ulërima, qurravitje, rënkime dhe shtyerje, - kot. Sepse njerëzit shtyhen porse muret nuk lëvizin. Ata janë aty, të palëvizshëm, të rëndë e të ftohtë. Secili do që të përkulet, të mbushë thesin, por shoku ngjitmas e pengon. Dhe atëherë: o burra të shtymë! Po ku... Përsëri gojë e sthurura vjellin të shara pa adresë; përsëri britma, mallkime e rënkime përplasen mureve. Turma hepohet, luhatet e shtrëngohet mes avullit të djersës, mes pluhurit, që çdo çast e më tepër, vjen e bëhet i dendur e i rëndë. Gruri është aty, tek këmbët e tyre, e shkelin dhe nuk mund ta marrin sepse nuk përkulen dot. Është diçka mjaft e thjeshtë; mjafton, që shoku ngjitmas të bëjë tutje vetëm një pëllëmbë... Por ja që ai nuk lëviz. Nuk ka se si... Pas tij është tjetri..., tjetri..., tjetri... Të gjithë për një qëllim, një dëshirë, një nevojë... Kalon një minutë..., dy..., dhjetë..., tridhjetë... Dhe koha rrëshqet përmes mundimit të kotë. Zërat, në fillim të fuqishëm, tani kanë filluar të çirren, të dobësohen, të meken. Të dobëtit janë rrëzuar, përpiqen të ngrihen, por turma

i shkel. Përsëri rënkime, britma dhimbjesh, përpëlitje... Së fundi fuqitë shterin, dëshira zbehet e venitet, shterin hovet, por zërat e mekur vazhdojnë të dëgjohen:

- Prit...! Kush je ti, Maliqi?
- Jo s'jam Maliqi. Jam e shoqja e Haqifit...
- Të lutem, më thuaj nga bie dera?
- Nga gopi i sat ëme... Ç'tu desh që hyre?
- Lëre mos e nga si vajti kjo punë!
- O burra, shtyni, të dalim...
- Të dalim, të dalim...
- Ah, oh, uh, ëh...

Tashmë të lodhur për vdekje, mezi shtyhen drejt daljes. Turma hepohet si një bollë gjigante e plagosur. Masa jashtë vjen e rritet. Krejt të dërrmuar, të hallakatur nga leshërat, nga rrobat të grisur, të larë në djersë, të skuqur e të zverdhur, të gjithë, pra që të gjithë dalin jashtë.

E shoqja e Haqifit ka humbur këpucën e këmbës së djathtë.

Maliqit i është këputur rrypi i pantallonave, dhe, teksa i mban ato me njëren dorë, me tjetrën shfryn hundët.

Një i quajtur Zenel, shitës kokoshkash pranë shkollës tetëvjeçare, është pshurrur në brekë.

Xhambazit të kuajve i paska rënë të fikët dhe po e nxjerrin kalaviçash.

Mul shurdhani ka humbur vetëdijen: nuk kupton as ku është, as çfarë ka ndodhur. Pushka nuk dihet ku i ka përfunduar.

Dhe, kur të gjithë janë hallakatur për t'u çelur syshë e për t'u mbushur me frymë, kur askush nuk mendon më për grurin e mbetur atje brenda pa iu cënuar asnjë kokërr, "filozofi" kërcen e thotë:

- A nuk thashë unë, që jemi turmë?

Ramiz Gjini

*Kastriot, vjeshtë, 1997*

## Posta që sjell era

Më vjen shumë inatë që Laura, e ka harruar sërish çelësin brenda, dhe mua, me të dëgjuar tringëllimën e ziles, më duhet të ngrihem mundimshëm për t'i hapur derën.

Nëntëdhjetë e katër vjet nuk janë pak, për një njeri si unë, që kam shërbyer nën armë dyzetë vjet rresht me një devotshmëri, që sa herë e kujtoj, më ngjall respekt e admirim për veten, edhe pse bota më ka harruar prej kohësh; madje shumica prej tyre më pandehin të vdekur.

Im bir, Antoni, ka dalë në pension qysh para pesë vjetësh dhe jeton në Florida. Sot mbush shtatëdhjetë vjeç. I shtyn ditët në një azil nën mbikqyrjen e vazhdueshme të një mjeku të shquar indjan pasi vuan nga një sëmundje e pashërueshme. Sikur unë ta kisha lënë këtë botë në moshën që ka sot im bir, do të kish qenë mirë për të dy, pasi unë, s'do të kisha mbërritur ta shikoja të plakur, kurse ai, në pikë të burrërisë, do të shpëtonte njëherë e mirë nga ato shqetësimet dhe përkujdesjet e mia prej babushi.

Kur Laura erdhi për herë të parë në shtëpinë time, ia shkrepri të bënte disa ndryshime në vendosjen e objekteve. Ngase ende nuk

kishim vendosur për pagesën, ajo deshi të demonstronte para meje aftësitë e saj si kujdestare me përvojë, nga ata që i marrin frenat në dorë me një vetësiguri të admirueshme që ditën e parë të punës.

Divanin ku unë rri të shumtën e kohës, e shtyu dhe e vendosi pranë dritares. Si kreu këtë punë, zuri vend me shpinën e kthyer nga dritarja, bëri me gisht nga portreti i tim biri e tha:

“Unë mendoj, që fotografinë e babait tuaj ta varim në një nga muret e korridorit, kurse në vend të saj të vendosim atë lulen kacavjerrëse pasi do ta rrahë më shumë drita”.

E rراسi mjekrën e saj të vogël mes gishtit të madh dhe atij tregues e si për t’i vënë kapak kësaj pune pyeti:

“Mirë Luis?”

Kur unë i thashë që portreti që i tim biri dhe jo i babait, Laurën e zuri ngërçi, nuk deshte ta besonte. Bëri një gjest shtrembërimi në fytyrë për të më dhënë të kuptoja se gjithsesi, pavarësisht pse unë i jepja mundësinë të ushqej me bukë, nuk që mirë të prishej rregulli që mëma natyrë ka vendosur mes brezave. Por unë, ndonëse nuk kam ndonjë motiv vërtet për të qenë, më duhet ta mbaj ndezur flakën e shpirtit për ta ndriçuar edhe këtë copë të mbetur rruge deri sa të gjej e të hap atë derën e fundit, pas së cilës, pret paqja e amëshuar.

Nuk do ta harroj kurrë eprorin tim, Sër Henry Livingston, i cili vdiq qysh para tridhjetë vjetësh. Zëri i tij i rreptë e gjithë potencë prej ushtaraku të vërtetë, më kumbon ende në vesh si qëmoti: “Luis Medina, paraqitu! Luis Medina, marrsh përpara! Luis Medina, djathtas kthehu!” Asnjëherë nuk e pata dëgjuar të jepte ato urdhëra, për të cilat, me të drejtë, ai mendonte se duheshin hequr nga rregullorja ushtarake. Kurrë nuk e pata dëgjuar të urdhëronte, ta zëmë, “Luis Medina, prapa-kthehu” ose “Luis Medina, në vend numro!” Ndaj dhe më duhet të eci ende, të kapi shekullin; sepse unë mendoj, që Zoti i të gjithëve s’ma ka falur jetën si dhuratë, por

ma ka dhënë si detyrë, që s’duhet braktisur, por duhet përmbushur gjer në fund.

Nganjëherë, më ndodh t’i dorëzohem për pak kohë pafuqisë time. Shtrihem në kolltuk e zhytem në kujtimet e së shkuarës, derisa Laura të më ndërmendë me ato shqetësimet, që ia lagin faqet e bardha me lot. Edhe tani e shikoj se si nuk gjen qetësi. Përpiqet të maturojë shtëpinë, por punët i nis përsëprapthi. Dhe duket e përhumur si në tym. I thashë të më sillte xhaketën sepse doja ta hidhja krahëve, kurse ajo, vajti e më solli varësen e drunjte, ma la në dorë e pyeti:

“Si e do çain Luis, me kamomil, apo me lule blini?”

“Si të duash Laura, - i thashë. - Veçse, të lutem, bëj kujdes kur kalon rrugën. Asnjëherë mos u fut me dritë të kuqe”.

Ajo më vështroi gjithë habi, pastaj u kujtua e tha:

“Më fal, Luis. Unë jam një copë budallaçkë”. Por unë e di që Laura nuk është e tillë. Ndoshta, e keqja është, sepse gjatë jetës së saj, duhet të ketë marrë shumë nga ato urdhërat “prapa kthehu!” dhe “në vend numëro”!

Pasi sjell xhaketën, ajo nis e pergatit çain. Para se të afrohet për ta vendosur mbi tryezë, Laura rrotullon paksa sytë nga e majta dhe fiksohet të kujtojë kohën e tashme! Mendja i ka fluturuar nuk dihet se ku dhe në fytyrë i ka ngrirë një shprehje e çuditshme. Duket sikur thotë: A jam vërtet unë, bjondja Laura Makajevna nga Ukraina, apo jam Dolores Mersy nga Afrika e Jugut? Jam e bardhë ashtu si më parë, apo e zezë? Ku ndodhem në të vërtetë tani dhe me çfarë po merrem konkretisht?

Jo vetëm për ta përmendur, por edhe pse ajo ka futur në filxhan dy lugë sheqer, i them:

“Laura, çajin e doja vetëm me një lugë sheqer...”

“Mirë”, - thotë qetësisht ajo. Dhe pasi ka harruar ç’ka bërë më

parë, hedh aty edhe një lugë të tretë, vjen e ma vendos përpara gjithë delikatesë e si gjithmonë pyet:

“Ne rregull Luis?”

“Në rregull”, - dorëzohem përfundimisht unë.

Kushedi për të satën herë Laura shikon orën e saj të dorës me një padurim për t’i qarë hallin. Memzi pret të fluturojë nga shtëpia për të më lënë në vetminë time të plotë, që nganjëherë më duket sikur i ngjan harresës. Pastaj vagëllimthi e shikoj të përvidhet në dhomën tjetër, të flasë me dikë në telefon, në fillim ngadalë, pastaj në nota më të larta; të përsërisë e nervozuar kushedi për të satën herë të njëjtat fjalë derisa tjetri, - që vetëm ajo mund ta dijë ku ndodhet, - ta lëndojë me kokëtrashësinë e tij gjer në atë shkallë sa të shkrehet në vaj.

“Kam investuar shumë, kupton”? - i çirret Laura tjetrit në telefon, ndërsa tund gishtin qortues mu si ta kishte përballë, - “Nuk e meritoj të trajtohem si një lypsare. Jam grua dhe dua të më japësh gjithshka më përket si e tillë”!

Por tjetri atje larg, duket se nuk ha arsye.

“Kurrë më nuk do të jemë ajo që dëshiron ti” - shkithet për të fundmen herë Laura. - “Kurrë, dëgjon!”

Përplas receptorin mbi tryezë dhe nis të dridhet si gjethja në thëllim. Maja e mjekrës i është zverdhur si t’ia ketë shtypur e t’i ketë lënë aty një dangë gishti i madh i një dore mashkulli avdall. Sillet gjithë makth nëpër dhomë duke bërë lëvizje të pamotivuara, pastaj shembet mbi të vetmin kolltuk, që gjendet në dhomën time të gjumit. Mbulon fytyrën me duar ngase i vjen turp nga vetja e vet dhe qëndron kështu e fshehur për disa minuta. Atëherë më duhet ta ngushëlloj me të vetmen mënyrë, që ajo dëshiron në raste të tilla: ta lejoj të shkojë më herët se zakonisht.

“Shko, Laura, - i them. - Shihemi nesër në mëngjes. Mund t’i



bëj gati vetë ilaçet”

Laura kujtohet, heq duart nga fytyra, kafshon njëherë buzën e poshtme me dhëmbë dhe e ngul vështrimin në një pikë.

Duket sikur fjalët e mia si kanë bërë fare përshtypje. Athua se Laura, mund ta kurdiska vetë kohën e saj, madje ajo mund të vendoska edhe lidhje e ngjarje të ngjashme me rastësitë!

E vështroj i qetë teksa rregullon me të djathtën cullufen e flokëve të rrëzuar mbi syrin e përlotur. Ngre paksa njërën vetull dhe rri ashtu një cop herë të mirë duke sajuar, medemek, një qëndrim ëndërrimtareje të thellë! Për fatin e saj të keq, gjithshka ajo bën për t’u dukur para meje një grua në gjendje normale, është një përpjekje e dështuar, një lojë e keqe. Pas fjalëve të mija, ajo përpiket të bëjë zap një dëshirë që e nguc për të brofur menjëherë në këmbë e për t’ia dhënë vrapthit rrëmbimthi nga kjo shtëpi, ku siç qe shprehur vetë para ca kohësh, “fantazmat e vërsnikëve të mij, që vdiqën këtu e tridhjetë vite të shkuara, brohorasin natë e ditë ngadhënjimin tim mbi vdekjen.”

Tashmë që gjallnimi më ka lënë dhe drita e jetës ka ngelur si ajo xixa që sapo ka filluar t’i dalë fjolla e hollë e tymit, kam nisur t’i mas gjërat me një logjikë universale. Ngase vdekja nuk më erdhi në kohën e duhur, ia kam kthyer shpinën me zemrim e shpërfillje të plotë. Me aq frymë sa më ka mbetur, kam nisur çapitjen rrugës nga kam ardhur duke shkelur nëpër kohë gjurmëve që kam lënë. Dëshiroj të mbërrij edhe njëherë, si i thonë “ në lule të moshës” e ndoshta, do të qe mirë të vdisja aty. Sepse sa herë i kujtoj ato djelmosha që u vranë në zjarrin e luftës, më vjen turp nga vetja të vdes në këtë gjendje fizike ku jam katandisur. Ndaj dhe e kam kthyer kohën mbrapsht, natyrisht, pa i cënuar as një qime historisë time, dhe tani po kuptoj se rrjedha e jetës, e paska destinin tatëpjetë.

E shikoj Laurën të ngrihet ngadalë e si me përtesë; i avitet raftit të

ilaçeve, hap kutitë njëren pas tjetrës, i vendos kokrrat mbi një pecetë të bardhë, që sapo e ka shtrirë mbi tavolinë; pastaj ndez kondicionerin, rrotullon sytë si të dojë të sigurohet se gjithshka është në rregull, dhe, si pastron njëherë fytyrën nga ndryshku i makthit të saj, thotë një “thank you Luis” dhe krisën e ikën.

Atëherë unë, që i kam ndjekur mirë të gjitha lëvizjet e saj, bindem që Laura i ka bërë gati ilaçet e mia duke demonstruar të njëjtën indiferencë përtace, me të cilën një lypës mund të ushqente një qen të huaj.

Me t’u zhdukur Laura, dhoma nis e ngushtohet. Sendet marrin ngjyrën e dheut të lagur. Duken sikur përgojnë frymëmarrjen time. Zhurma e lehtë e kondicionerit më kujton zhaurimën e lumejve që rrjedhin luginave të mbushura dys me mjegull, frushullimën e lehtë të erës së natës dhe përplasjen e pikëlave të imta e të ftohta të shiut në tumbat me fier të thatë kodrinave. Luleshpatoret e vendosura në vazo tek qoshja e djathtë pranë dritares, nuk janë tjetër, veçse një shkurnajë që luhetet për të mos ngrirë nga acari kallkan i një nate dimërore. Dhe ndjej ftohtësi në trup e shpirt. Një ligështim therës më vërshon në vena, dhe, tek e fundit, më bëhet sikur qeni Cerber po më lëpin kockat, të cilat, ka vite që më duket se cingërijnë mu si ato gurët e djegur gëlqerorë kur i zhysin në ujë. Atëherë vihem në kërkim të hapësirës, të asaj hapësire plot ajër e dritë, që Laura më bën ta harroj me rrekjet e saj prej kujdestarje të shpifur; sepse çdo ditë e më tepër, duket ashiqare, që i është mërzhitur keq kjo punë, dhe ajo, kurrë nuk ka për ta kuptuar atë nevojën time për pak qiell të hapur, për pak zabullimë jete, për atë bulurimën e heshtur të gjallnimit rreth meje e brenda meje.

Afrohem me mundim gjer tek dritarja, që shikon nga ana e kopështit. Hedh sytë në qoshën e djathtë dhe shikoj mes lëmizhdeve disa copëra të vogla gazetash. Lëvizin lehtë duke përfutur kështu

zhurmimin, që lënë në eter krahët e një fluturë të lodhur nga vjeshta e vonë. Është posta që nganjëherë më sjell falas era. Një postë e vonuar, pasi rruga për të mbërritur gjer tek unë është e gjatë dhe me shumë peripeci. Dikurë janë shitur cepeve të rrugëve; të reja e të palosura, të mbushura dys me lajme të freskëta, histori të çuditshme, rreklama e foto bukuroshesh. Duar njerëzore i zhubravitën, i grisën për nevoja të ndryshme, i lanë bordureve, stolave në parqe, i flakën në rrugë... Pastaj ia behu era. Shtjella e saj i ngriti në qiell, i përplasi mureve të lartë, i rراسi qosheve, skutave të braktisura, i zbriti shkallëve që të shpien bodrumeve, pranë dyerve të ngallmuara që nuk hapen kurë. Shpesh i kërkoj Laurës të më tregojë, pasi dua të di, çfarë ndodh në botën prej së cilës rrethohemi, për t'u ndjerë edhe unë pjestar i kësaj shoqërie, për të parë e kuptuar në ç'shkallë është rritur zhvillimi i vendit, ose deri ku ka arritur konflikti me disa nga vendjet e Lindjes së Mesme. Por Laura, që s'ha pykë fare nga këto punë, sido që ta nisë rrëfimin e saj, ngado që ta kapë fillin e mendimit, do të sillet nga do të sillet duke u përplasur me një barrë inkonsekuencash, e së fundi, do të dalë se s'bën atje ku ajo dëshiron të dalë: tek pulat që ka pas rritur në fshatin e saj në Ukrainë, tek të ftohti, që bën atje, si dhe tek zdërhalljet e burrave të dehur nga votka lokaleve të natës. Pastaj, si të rehatohet mirë në limanin e kënaqësisë së saj, kushedi për të satën herë, ajo do të nisë të më rrëfejë për një far Dimitri, të birin e një vozaxhiu, një djalosh qimekuq ky, që na paska lënë mendjen pas bishtalecave të saj të gjatë, e që na i paska shkruar, madje, edhe një poezi me gjak në vend të bojës. Dërdëllitjet e Laurës më bëjnë të kotem në kolltuk, pasi më duken përralla vajzurinash dhe asnjëherë nuk kam mbërritur t'ua dëgjoj fundin, pasi më zë gjumi.

Zgjas dorën dhe marr njërën prej letrave që ka sjellë posta e erës. Nuk ka titull dhe shkronjat gati i ka fshirë koha. Ngre syzet

me gishtin tregues dhe lexoj: “Saladin occupied Sen Zhan d’Akrit and Jeruzalem, after he wanted to...” Një histori e vjetër kjo e Saladinit, them me veten time. Dhe më habit fakti se si nuk qenka harruar! Ndoshta gazetari e ka zgjedhur si referim. Thonë që historia përsëritet, por unë mendoj se kurrë nuk mund të përsëritet Saladini apo Luis Medina. Më poshtë rreshtat janë të palexueshëm, i ka fshirë koha. E kthej nga ana tjetër dhe sytë më shikojnë vagullt një krah të fuqishëm boksieri. Është shkëputur nga fotoja e gjymtuar e Muhamet Aliut, ndoshta e ndonjë tjetri.

Dikurë në rininë time, e kam dashur vërtet boksen. Madje ca kohë fillova të stervitem derisa hyra në një klub si kandidat në provë. Por ndodhi që dy herë dola nga ringu si humbës. Herën e parë, kundërshtari im, një ish gomist nga New York-u, më nxorri nufullën nga vendi; kurse herën e dytë, në një ndeshje të rangut të ulët, një djalosh nga Teksasi, më hapi një vragë të thellë në vetullën e syrit të djathtë.

Aso kohe im atë ndodhej në Mongoli për një marrveshje në tregëtinë e djathit. Kur ai u kthye në shtëpi, më gjeti me fasho në fytyrë. Me të marrë vesh si qëndronte puna, ai tha:

“Dëgjo, biri im: boksi është një sport për kafshët e samarit. Kurrë mos i hyr nëse nuk ke ngrënë kokës ndonjë shkelm të fortë kali e të keshë mbijetuar”.

Kështu, e lashë dhe kurrë nuk u mora më me atë lloj sporti.

Pasi shpalos ngadalë një shuk të vogël gazete dhe hedh në tokë një buburrec të vogël, që ka hyrë aty në kërkim të ushqimit, lexoj: “...kurrë më nuk do të kthehet roli udhëheqës i partisë në Çeki, Poloni Hungari...” Pyes veten: të jetë kjo e vërtetë?! Ndoshta po, pasi buburrecat rendin fort në kërkim të së vërtetës. Përpiqem të kruaj me thoin e gishtit të madh një bllanë balte të tharë, por nuk ia dal dot për të nxjerrë në dritë vijimsinë e saj. Më

poshtë kanë shkruar: “katastrofa bërthamore e Çernobilit, e cila, mund të krahasohet me...Tashmë, që kemi një vaksinë kundër polieomolitit...Kompakt Disku Filips...” Çifutët protestojnë ndaj shpikjes së pilulës kundër mbarsmërisë. Ata mendojnë që G. G. Pincus, nuk duhej të...”

Ndonëse është një mishmash që s’merret vesh, një sekuencë e katrahurës së pakuptimtë, që bën vetvetiu shtjella e erës, ka aty një përslesh ç’njerëzorë, ku copat e së shkuarës, ngjajnë me të vjellat e një gruaje, që ka mbetur me barrë pasi forca demonjake e një dashurie përvëluese, e ka plasur në shtratin e kënaqësisë seksuale. Dhe më bie ndërmend kujdestarja ime Laura, e cila, tani duhet të ketë marrë autobuzin për të shkuar drejt të dashurit të saj kokëtrashë me mendimin “kurrë më”. Por unë jam i bindur që ajo do të kthehet sërish tek unë të nesërmen me kokën plot me urdhëra “në vend numëro” dhe “prapa kthehu”, e pasi të bëjë ç’ti thotë rradakja e saj, do të më buzëqeshë e si gjithmonë do pyesë: “Okey, Luis”?

Ndërsa bëj të ngrihem duke u mbajtur me vështirësi anës murit, sytë më shohin një tjetër fletushkë të postës që sjell era. Për të fundmen herë, ulem sërish ngadalë, sepse gjunjët më dridhen e memzi më mbajnë. E kap me dorë atë fletushkë të zverdhur, dhe pasi rregulloj edhe njëherë syzet që më kanë rrëshqitur mbi hundë, kuptoj se tashmë na qenka një faturë e vonuar telefoni! Në krye lexoj: Luis Medina, 7314, Ap. 1F. Brooklyn, New York 11204. Në anën e djathtë, siper tek cepi, në një kuadrat të vogël, gjendet shifra e 84 dollarëve të papaguara. Dhe mban datën 6 Tetor, ditën që Laura ishte e gëzuar pasi i dashuri i saj kokëtrashë, i kish blerë një byzylik të bukur argjendi.

*New York, vjeshte, 2004*



## Macja e zezë

Qe pasdarke, vonë. Jashtë binte shtruar një shi i imët dhe i trishtë nëntori.

Tre burra, qenë ulur në tavolinën e vendosur pranë derës së hapur të lokalit. Flisnin anglisht, por nga theksi, kuptoje se qenë italianë me origjinë.

Më i madhi prej tyre, ishte bullafiq, me barkun e kërcyer si një fuçi. I mbante pantallonat me tiranda dhe tymoste puro. Bënte biznes, dhe si një babaxhan i pasur që ishte, i pëlqente të luante bosin hokatar edhe në mardhëniet me shokët.

I dyti, kishte pothuaj një moshë me të parin, por vinte i dobët. Qe i heshtur, preferonte më tepër të dëgjonte kur flisnin të tjerët se sa të fliste vetë.

Që të dy, trashaluaqi dhe i dobëti, dëgjonin rrëfimin e një djaloshi që thirrej Batista.

Pati qenë në luftën e Irakut ky Batista. Kishte kryer detyrën e ushtarit zbulues në një batalion të ushtrisë amerikane dhe i pëlqente të tregonte. Pas lufte, kishte përfunduar në spital, sepse gjatë një përpjekje në Falluzha, një copëz e vogël predhe i kishte thyer kockën

e ballit. Tani, plaga në ball ishte mbyllur, por i kishte mbetur vraga, një si vijë e lakuar me bishtin poshtë mu si një pikpyetje e madhe.

- Të kisha thënë të mos shkoje në luftë, - i tha bullafiqi duke u gajatur së qeshuri, - E shikon çtë bëri lufta? Të la një pikpyetje mu në ballë. - Dhe, ndërsa tregonte me gisht ballin e Batistës, shtoi: - Me gjithë atë alamet pikpyetje që ke, ec e merre vesh tani, je, apo nuk je sërish Batista.

Në një tryezë tjetër, jo shumë larg tyre, qëndronte i ulur në karrige një burrë zeshkan, me mustaqe, aty rreth të dyzetave. Qe piktor me origjinë nga iraku, dhe, ndonëse mysliman, ishte punësuar si mjeshtër restaurues kishash në një kompani të madhe amerikane. Piktori pinte kafe në heshtje, vështronte nga dera e hapur shiun që binte shtruar në rrugën pa asnjë lëvizje dhe tymoste cigare i zhytur në mendime.

Kur në lokal u dha gruaja e panjohur me trupin e mbështjellë vetëm me një robdishan, italianët e ndërprejnë për një çast bisedën dhe nisën ta vështronin.

Në këtë lokal të dorës së tretë, ku pihej alkool dhe duhan, dhe për më tepër, në këtë orë të vonë të natës, nuk qe e zakonshme të hynin gra.

Kjo grua, ishte ruse, një ruse me lëkurën e bardhë, që tregonte një moshë aty tek të tridhjetë e pesë vjetët. Kishte një trup të rregullt, të brishtë dhe një gjoks të kërcyer. Flokët e verdha, i pati të lagura. Sytë, - të kaltër e të trishtë, me qerpikët e gjatë, që i jepnin një shprehje disi ëndërruese; kurse në fytyrë, binin në sy ca bulëza të vogëla uji si pikëla vese. Sapo kishte bërë banjë dhe kundërmonete erë pjeshkë, ndoshta nga shampoja që kishte përdorur.

Në herë të parë, kur u gjend brenda lokalit, u duk sikur e pushtoi një ndjesi, që ia stepi hapin. Athua se e kishte kapur veten gafil në një vend, që nuk duhej të hynte. Qëndroi një cop herë pranë



banakut duke bredhur shikimin gjithandej në kërkim të banakjeres, të cilën, mbase e njihje; dhe, kur nuk ia zunë sytë, - ato çaste, ajo pati zbritur poshtë në bodrum, ku të tjerë italianë luanin kumar, - u kthye nga burrat e ulur në tryezë.

- Më falni... - nisi të thoshte ajo shumë e shqetësuar, - Ndoshta duket qesharake, por, në apartamentin tim, ka hyrë një mace e zezë.

Tre burrat panë njëri-tjetrin.

- Ju thatë, që në apartamentin tuaj ka hyrë një mace? - deshi të sigurohej bullafiqi, ndërsa shkundi puron e ndezur në tavell.

- Po, - tha gruaja me vështrimin e çakërruar nga apartamenti i saj. - Duhet të ketë hyrë nga dritarja e pasme kur unë po lahesha, sepse pashë që dritarja kishte qenë e hapur.

- Kape për bishti e flake jashtë, - tha Batista. - Një mace është.

- Se bëj dot se, - tha ajo. - Është futur poshtë krevatit, në dhomën e gjumit. Kur njëherë u përkula ta trembja, mu hodh me thonj e gati më nxorri sytë.

- Nuk keni njeri tjetër në shtëpi? - pyeti bullafiqi.

- Burrin më është vrarë në luftën e Irakut, - tha ajo. - Kurse fëmijë, nuk kam. - Dhe, si të kishte kuptuar që e teproi me shpjegimin, shtoi: - Ndoshta mund të më ndihmojë ndonjëri nga ju, që ta nxjerr jashtë atë krijesë të mallkuar.

- Ku banoni? - pyeti bullafiqi.

- Ja, aty, në katin e parë të atij pallatit në anën tjetër të rrugës, - tha ajo duke bërë me dorë.

- Ngrihu Batista, - i tha çakërrqejf bullafiqi më të riut. - Ti je marrë me zbulimin dhe di si t'i kapësh edhe minjtë edhe macet.

Ish ushtari, u ngrit disi përtueshëm e buzagaz. Deshi të merrte xhaketën e vendosur në mbështetësen e karriges, por ndërroi mendje, futi dorën në xhep dhe mori vetëm celularin. Pastaj, ashtu siç qe, në këmbë, rrëkëlleu edhe një gllënjë konjak dhe u nis të

dilte. Tek porta, në dalje, tjetri e paralajmëroi me zë të lartë:

- Kujdes Batista! Kur të kthehesh, nuk duam të keshë të vizatuar në trup të tjera pikpyetje.

Si dolën jashtë, ata qëndruan për pak kohë në shi buzë rrugës sa të kalonin dy makina njëra pas tjetrës. Pastaj, kapërcyen shpejt rrugën dhe u futën brenda pallatit përballë.

Atëherë, bullafiqi, mërmëriti nëpër dhëmbë diçka rreth frikës së grave, që iu druakan edhe maceve, sepse fill pas tij, tjetri shtoi:

- Nuk ka faj: të zezat, janë ters i madh, ta dish.

Dhe iu kthyen sërish bisedës aty ku e kishin lënë: tek lufta në Irak.

Piktori, pati hapur një dosje dhe kish nisur të vizatonte në një fletë të bardhë konturet e një maceje të zezë. Nganjëherë, ai e ndërpriste atë punë. Përmes derës së hapur, vështronte nga pallati matanë rrugës ku qe futur ajo gruaja me italianin.

Në apartamentin e saj, dritat qenë ndezur, por megjithatë, ndriçimi qe i zbehtë dhe dukej mugëtirë. Përmes perdeve të tylit të dritareve, i shëndoshi, shquajti një cop herë të mirë dy hijet e tyre se si lëviznin nëpër dhomë në kërkim të maces së zezë.

Kur njëra nga hijet u zhduk, ai pa të dilte jashtë e të vinte drejt lokalit zbuluesi Batista, i cili e kaloi rrugën me vrap e i rrënoqethur, pasi qe ftohtë dhe shiu vazhdonte të binte.

Kur hyri në lokal, ende pa zënë vend në karrige, Batista mori pozën e atij njeriut, që nuk ka çfarë të tregojë e tha se nuk e kishte gjetur macen e zezë. Kishte kërkuar gjithandej në apartamentin e saj, por kurrnjëfar kafshe nuk kishte parë.

- Duhet të ketë dalë jashtë nga dritarja gjatë kohës kur gruaja erdhi të na kërkonte ndihmë, - tha sëfundi ai.

Atëherë trashaluaqi, shprehu mendimin, se nuk përjashtohej mundësia, që ajo grua e panjohur, mund të ishte e sëmurë nga trutë.

- Unë, njoh një grua të vetmuar, - nisi të rrëfente ai, - që pretendon se fle çdo natë me Napoleon Bonapartin. Madje, kur Napoleoni, medemek, hynte natën vonë në shtëpinë e saj, kjo grua i merrte shpatën, të cilën, e mbështeste gjithë kujdes për murit pranë derës. Pastaj, e ndihmonte të hiqte mantelin, të zbathte çizmet e kështu me radhë...

Ndërsa ndodheshin në vlog të këtij muhabeti, për çudinë e tyre, në derë u dha sërish rusja e bardhë. U drejtua nga burrat e shumë e tronditur, tha:

- Ajo kafshë e mallkuar është ende aty, më besoni. - Dhe, si u kthye nga Batista, shtoi: - Sa ike ti, doli nga poshtë krevatit dhe u përvodh e u fsheh prapa raftit të rrobave.

E panë me dyshim pa nxjerrë asnjë fjalë nga goja. Pastaj, bullafiqi, gjoja në konfidencë e si me shaka, e pyeti gruan, nëse i pinte rregullisht ilaçet.

Dy të tjerët, ia dhanë të qeshurës me të madhe.

Në vend që të fyhej, ajo u kthye nga piktori e bëri një gjest si të deshte ta pyeste, a kishte në këtë rast ndonjë gjë që nuk shkonte dhe që ajo se kuptonte.

Ky gjest i saj, i bëri ata të tre, që të qeshnin edhe më shumë; sidomos trashaluqi, i cili, ndërsa përpiquej të frenonte gazin, i thoshte gruas, që ata e patën kryer detyrën si duhej. I kishin dhënë me vete një zbulues mjaftë të zotin: Batistën, atë kokërr djali, që kishte qenë edhe në luftë, dhe tani, nuk kishin çfarë t'i bënin tjetër.

Ato çaste, piktori, hodhi nxitueshëm gllënjken e fundit të kafes, nxorri e la dy dollarë mbi tryezë, mori dosjen e tij dhe u ngrit në këmbë.

- I kam pikturuar me qindra herë macet e zeza, - i tha ai gruas. Dhe shtoi, që kishte studjuar, madje, edhe mitin mbi ta.

- Po që kështu, hajdeni me mua, - e ftoi ajo me njëfar kurioziteti.

- Ndoshta, ju mund të më ndihmoni ta nxjerr jashtë, sepse jam e sigurtë, që ndodhet brenda në shtëpi.

Dolën, që të dy, njëri pas tjetrës.

Tre burrat, i ndoqën me sy, ndërsa vazhdonin të pinin konjak, të tymosnin duhan e të kripnin shakatë e tyre me histori grashë të sëmura nga mendtë e kokës.

I panë teksa kaptuan rrugën nëpër shi dhe hynë brenda apartamentit. Vazhduan t'i shikonin sërish përmes perdeve të tyllit si dy hije, teksa biseduan në këmbë për minuta të tëra. Tek e mbramja, ata shquan se si, njëra nga hijet, ajo më e brishta, u afrua dhe uli grilat e dy dritareve. Dhe, kur pas pak, dritat në apartamentin përball u fikën, një mace e zezë doli nga pallati në rrugë, ia dha vrapit me të katra dhe humbi tej, në errësirën e natës.

*New York, verë, 2007*

## Isaku, vëllaçkoja ynë i vogël

Të bëjmë diçka sa për t'u dukur se egzistojmë, se marrim frymë, diçka sa për të trembur vdekjen, - kuturisi e tha Isaku duke rrotulluar nga ne ata sytë e tij të trishtë.

Por ne, as që ia varnim Isakut. As që donim t'ia dinim çfarë thoshte ai. Madje jo vetëm Isakut, vëllait tonë të vogël e buvesh, por nuk ia varnim as kohës, ritmit të jetës, zabullimës së gjallë rreth nesh, stinëve që vinin dhe iknin njëra pas tjetrës në mënyrë të përzishme. Dhe, të gjithë, pra, që të gjithë, qemë zhytur në një lektisje të plogësht fatale si ta kishim bërë nijet për ta pritur në heshtje fundin tonë diskret.

Kishim lindur batalla, vuanim nga mungesa e lëvizjeve të motivuara, dhe, teksa bënim një jetë veleritëse, gëlltisnim pështymën e lëbozës së ditëve tona shterpë.

Isaku u ngrit ngadalë me kockat që i kërkëllinin, dhe si arriti të mbante drejtpeshimin në këmbë, u kthyer e tha:

- Vendosa të dal jashtë, nuk shtyhet më kështu, ndryshe do të kalbemi". Bëri disa çape drejt portës, u ndal, e duke u kthyer

sërisht nga ne shtoi: - Do të ndërtoj një shtëpi për veten, një shtëpi në fushë të hapur”.

E përqeshëm dhe e tallëm si mosmakeq:

- Mos u bëj i marrë Isak”, - ngulmonim ne, - Kërkon të dalësh jashtë në këtë kohë të keqe, të përballësh me gjithë këtë suferinë të marrë!

Por ai as që deshi të na dëgjonte. Përplasi portën dhe u bë fir.

Ne kishim të gjithë një kokë sëbashku dhe e donim njëri-tjetrin ashtu siç e donte secili veten. Mendimet na puqeshin mrekullisht dhe flisnim të njëjtat gjëra njëherësh. Madje ne shikonim të njëjtat ëndërra, dhe, kur ndodhte, që i rrëfenim mëngjeseve, korrigjonim njëri-tjetrin për detaje të vogla, që na shpëtonin pa u treguar. Ne i tregonim ato, edhe pse e dinim, që të gjithë bashkë kishim parë të njëjtën ëndërr. E bënim këtë, thjeshtë sepse ashtu na pëlqente.

Dy ditë më parë, vëllai ynë i madh, na tregoi atë ëndërrën, që kishte të bënte me ca yje, që binin e shuheshin në ujën e ndyrë të brrakës së Gjikollit. Por ai harroi se njëri prej këtyre yjeve, teksa u përplas mbi syprinën e ujit, nuk u fundos ashtu si të tjerët. Ai u fry njëherë nga zjarri i vet, u bë sa një lëmsh i madh, pëlciti, dhe atëherë, qindra shkëndia të ndezura kërcyen e u futën poshtë pullazit të shtëpisë sonë. “Oh, po, po, - pati pranuar asokohe vëllai ynë i madh, - Tani më kujtohet mirë, sepse shtëpia u përfshi nga flakët”.

Siç e thashë, ne shquheshim për lëvizje të pamotivuara, të cilat i demonstrovim dukshëm në mënyrë të përbashkët, kolektive. Vetëm Isaku nuk ngjante me ne, dhe ne, dyshonim se ai pati lindur dobiç; dhe për më tepër, me një instikt kafshe të egër, qoftë për t’iu shmangur rrezikut, qoftë për t’u përballur me të. Ndoshta pse kish lindur i tillë, para disa vitesh, babai e vrau me sakicë nënën tonë dhe iku e u zhduk për t’i shpëtuar burgut.

E quanim buvesh Isakun, vëllain tonë të vogël. Qemë të bindur, që me gjithë atë erë, që tërbohej fushës, ai nuk do të mund të ngulte as edhe një hu gardhi në tokë e jo më të ngrinte në këmbë një shtëpi të tërë.

Dita tjetër gdhriu pa Isakun dhe përpos kujtimit për të, që s'na shqitej nga mendjet tona të topitura, nuk gëlonte brenda nesh asnjë mendim, asnjë destin a dëshirë. U trembeshim zhurmave, zabullimës së jetës dhe kishim rënë në një gjendje aq dërrmuese, sa edhe mundimet e shtriqjeve po na bëheshin të tmerrshme. Të shtrirë në shpinë, me sytë e ngulur në tavan, të pajtuar me fatin dhe të mësuar paq me të drejtën që ne i kishim dhënë vetes, mund t'i ngrysnim për bukuri ditët tona duke bërë kokrrën e pallës; dhe pastaj, të shkonim në botën tjetër me indiferencë e shpërfillje, pa ndjerë asnjë brerje ndërgjegjje, asnjë dhimbje në shpirtërat tanë të patenzonë mveshur me një membranë të trashë, që tashmë kish nisur të koracohej. Sepse në fakt, ne nuk kishim histori, nuk kishim të kaluar të vyrtytëshme dhe as që shpresonim në të ardhmen tonë të zgërlaqur, për të cilën, nuk mendonim ndonjëherë. Kishim vetëm ëndërra, që nuk arrinin të bëheshin kurrë realitet dhe ajo që ishte më e keqja, qemë dënuar të zhgrryeshim në baltën e rrëshintë të një stine të ftohtë, ku nuk mbinte e lulëzonte asnjë lloj ideje apo motivi.

Pas ikjes së Isakut, e vetmja gjë, që na regëtinte në mendje, qe një pyetje e përbashkët: çfarë bënte Isaku atje në fushë të hapur ku të shkulte era? Dhe menjëherë pas kësaj dileme, përmes fishkëllimave dhe ulurimave të tërbuara të erës, ne e përfytyronim vëllain tonë të vogël të shndërruar në një dordolec. Me flokët e kataleshur e sytë e picërruar; me këmbët e pantallonave, që i shkundeshin nga era dhe me kindat e xhakëtës që i valviteshin mu si flamujt e pisët të shejtanit. Sepse vërtet që ishte bidat më vete të luftoje me erën,

me një masë të padukshme e të xhindosur, pa patur asnjë mundësi për t'iu shmangur, dhe ku asnjë lloj dredhie sado e zgjuar të ishte s'të hynte në punë. Ashtu siç qemë, të shtrirë në kokërr të shpinës, binim në shajni. E përfytyronim Isakun se si bënte qerthuj bashkë me shtjellat e erës, si të qe një lëvozhgë e lehtë arre; pastaj e përfytyronim teksa zbythej zgupthi sëprapthi nga forca demonjake e natyrës duke hapur me prapanicë mbi tokën e lagësht një rrë të lëmuar si ato që lënë në pluhur rrëshqanorët; e përfytyronim duke u ngritur lart në ajër, duke u sjellë nëpër qiell mu si një kuti kartoni bosh, si një qese e ndyrë plastmasi, apo si rrobën e grisur dhe të çapëluar të një të vdekuri, derisa e ngecnim dhe e varnim, pastaj, me fantazinë tonë në ndonjë grremç dege të prerë majë ndonjë arre të moçme. Por nuk doli ashtu siç e kishim përfytyruar ne, sepse Isaku, vëllaçkoja ynë i vogël, kish gjetur një mënyrë për t'ia hedhur erës.

Para se të dilte në fushë të hapur, ai qe përvjedhur shpatinës së përroit të Gjetës duke ecur skiç. Kish hyrë në përrua, kish mbërthyer dobiçi mirë me krahë dy gurë të mëdhenj dhe kishte përshtuar plot mundim me këmbë fushën e hapur, derisa kishte mbërritur tek vendina ku do të ngrinte shtëpinë. Aty kishte lënë në tokë vetëm njërin gur, kurse tjetrin e kishte marrë sërish me vete drejt përroit, që t'i shërbente si peshë sigurie për kthimin. Sido që ne e tallnim dhe e përqeshnim, thellë vetes ndjenim keqardhje për Isakun e vogël, sepse po çalltiste e bohorritej shumë në një kohë kiamet dhe as që e dinim, që edhe ai, ndjente të njëjtën keqardhje për ne, për mundimet tona të shtriqjeve, e vuajtjet që na sillte mërzia e thellë, plogështia e gjatë dhe e pafund.

Dhe si të deshte të na jepte një shembull triumfi, Isaku nuk pushoi për asnjë çast së mbarturi gurë që nga përroi për t'ia çuar tek vendina ku do të ngulte shtëpinë. Për çdo herë që Isaku çonte



dy gurë në fushë të hapur, njërin do ta kthente sërish mbrapsht në përrua, sepse kështu ia donte puna, dhe sepse, vetëm kështu ai e ndjente atë peshë sigurie që e bënte të ecte me këmbët në tokë.

Javën e dytë ai erdhi të na shikonte. Gurin e peshës Isaku e la diku pranë murit të oborrit. Ne sa s' u tërbuam prej atyre lëvizjeve të tij të qeta e të motivuara, të shoqëruara gjithmonë nga një mendim i fshehtë e vetiak.

- Mbylle shpejt portën, Isak, - iu hakërryem të gjithë me zë të lartë njëherësh dhe e tërhoqëm brenda si djajtë shpirtin mëkatar.

Dhe ai, pasi i vuri supin portës, e shtyu atë fort derisa arriti t'i vinte llozin. Pastaj u kthye nga ne e mërmëriti si nëpër dhëmbë atë shprehjen e tij të zakonshme:

- Unë e di që ju do të kalbeni.

Mezi e njohëm vëllaqkon tonë të vogël. Dukej i lodhur e i rraskapitur; rrobat i qenë grisur në pjesën e përparme të trupit, pëllëmbët e duarve i qenë zmadhuar gati dyfish dhe lëkura në ta qe trashur e bërë plot kallo e dhoga. Këmbët i kishte të vëngërta e të çapëluara nga pesha e gurëve. Avullonte nga djersa, por në sytë i shndriste një dritëzim prej orrli.

- I hodha themelet, - tha ai triumfalisht dhe qeshi.

E vështruam me habi e dyshim.

- Je në vete?! - pyetëm të gjithë njëherësh në kor me tallandisje.  
- Nuk shikon more vëllaqko ç'hata e ç'llazurë po bëhet përjashtë?!  
Na thuaj drejt, sa je munduar, sepse me ty Isak, ka gallatë!

Ai na vështroi pa folur, ndërdyzash; u duk sikur deshi të thoshte diçka, një fjalë të vetme, që e përtypi gjatë me dhëmbë dhe që e gëlltiti pastaj me shumë mundim.

- Hape gojën e fol që të dëgjojmë, - ngulmonim ne duke thirrur me sa na hante zëri. - Ç'bëhet jashtë? Ka dalë përroi nga shtrati?

Po pemët, a janë rrëzuar? A është përmbytur fusha? A ka ndonjë shtëpi të rrënuar? A pe ndonjë qenie të gjallë mbi faqe të dheut, Isak?

- Pashë një skifter, - tha ai me një sinqeritet prej buveshi, - një skifter, që sillej bashkë me erën nëpër qiell në gjueti të minjve.

- Uuuuuu! - ia bëmë ne me të tallur të gjithë njëherësh si gjithmonë në kor dhe qeshëm me të madhe. Pastaj tek e fundit, kur vala e gazit qe shuar, ngadalë e shtruar, që ta merrte vesh mirë, i thamë:

- Ti je nje buvesh Isak. Na fal pse po ta themi troç e drejt, por ti përnjimend që je një buvesh i shkundur. Ku ka skifter me gjithë këtë hata që bëhet jashtë?!

Isaku, vëllaçoja ynë i vogël, u zemërua keq me ne. U krodh në mendime; pastaj me një vetësiguri të admirueshme, hodhi atë shprehjen e tij të kaherëshme “Unë e di që ju do të kalbeni” dhe doli jashtë i harmatuem mënjije duke e lënë portën hapur. Një shakullimë e madhe ere e mbushi shtëpinë, u rrotullua gjithandej mureve dhe i bëri sendet lesh e li. Ne u turrëm të gjithë së bashku me yrish, i vumë shpatullat derës dhe vetëm pasi i rrasëm llozin, morëm frymë të lehtësuar. Dhe thamë: “Në djall vafsh, Isak! O hajvan samari, që s’ merr vesh hiçfare e nuk do që t’ia dish ç’bëhet jashtë. Ik nga të të çojë era o dobiç dhe kurrë mos u kthefsh më në gjirin tonë! Ne po të tregojmë hatanë, kurse ti, do që të shkoqitësh davanë”!

Ditët që pasuan qenë më të tmerrshme. Ne i shikonim pemët në kopësht teksa përkuleshin me degët gjer në tokë nga stuhia. Era tërbohej gjithandej, athua se qenë shpuar shakujt e qiellit. Madje një ditë, pamë tjegullat e çatisë së shtëpisë kundruall se si u shkëputën e fluturuan me rrapëllimë e llazurë përmes një rrëmeti uluritës. Teksa vrapuam njëri pas tjetrit për të zbritur në bodrum, dëgjuaam nga jashtë zërin e Isakut, i cili piskati t’i hapnim portën.

- Mos u përgjigjini, - i thamë njëri-tjetrit të gjithë njëherësh, -  
Le të rrijë jashtë dobiçi. Mirë t'i bëhet.

Isaku vikati edhe shumë herë të tjera, dhe atëherë, të gjithë sëbashku, ne vendosëm t'ia falnim vëllaçkos tonë buvesh atë që kish bërë. U kapëm fort njëri pas tjetrit, që të mos na ngrinte peshë era dhe vajtëm të hapnim portën e oborrit.

- Futu shpejt brenda Isak, - i thamë me të hapur portën, - Na kërko falje dhe mos e përsërit edhe njëherë atë që bëre.

Isaku hyri në oborr jo me një, por me dy gurë të mëdhenj sigurie në krah. Fytyra e rrahur nga era dhe shiu i qe skuqur. Flokët i qenë kataleshur si të qe përleshur me njëqind djaj. Por dukej i qetë në vetvete dhe në sy i lexohej një besim i verbër. Me të hyrë brenda, u ndal, u kthye nga ne e duke picërruar sytë bërtiti e tha:

- Nuk erdha për të kërkuar falje, por erdha sepse më duhet sharra, sakica dhe sqepari.

Kulmi!

Kaq shumë u inatosëm me Isakun sa mezi pritëm të merrte surdinën me veglat, për t'i përplasur fort portën nga prapa me një vendim, që s'kish për t'u thyer kurrë më.

Isaku u largua me surdinën dhe gurët e tij të sigurisë, kurse ne, ia mbyllëm derën me shul nga brenda gjithë inatë, dhe, ashtu siç qemë të kapur njëri pas tjetrit, vajtëm e u mbyllëm thellë në bodrum.

Qëndruam gjatë aty brenda, të rrasur nguc e nguc pas njëri-tjetrit, duke shfrytëzuar zgjiqet e errët xëc tamam si këlyshët e dheut, a thua se donim t'i shpëtonim një mallkimi të lashtë, ora ndëshkuese e të cilit, dukej se tashmë po trokiste.

Ndërsa ditët kalonin, qielli erdh' e u nxi katran, era u bë ende më e tërbuar. Ulërime e saj e tmerrshme i ngjante asaj të një bishe prehistorike. Rropamat dhe klithmat u shtuan. Tashmë për ne, nuk

kish pikë dyshimi, që vëllaçkoja ynë i vogël, e kish paguar me kokë marrëzinë e tij.

Kur ia behu ora e zezë, që thuhet që s'ka as fill as cak, shtëpia u trus e nisi të lëkundej që nga themelet; pastaj teksa rroposej, shkrepëtiu një vetëtimë, drita verbuese e së cilës, mbërriti gjer thellë në bodrum. Kur u dëgjua gjëmimi, ne kuptuam se vetë Zoti po vrumbulliste me zë rrufeje. Ai tha: “Unë e di që ju do të kalbeni” Atëherë, të gjithë së bashku, ne ndjemë dhe kuptuam se diçka e rëndë po shpërbëhej e shembej brenda nesh; se era shkatërruese na kish hyrë gjerë thellë në deje; lagështira dhe myshku, qenë buisur qyshkur në zemrat tona; madje ato kishin hyrë në të gjitha poret e trupave tanë të malcuar. Një kutërbim plehu e kalbësire të gërbulur kish nisur të nderej eterit rreth nesh. Të shtyrë nga neveria, vendosëm të dilnim. Pështymë mbi trupat tanë të kalbur, dhe, si gjetëm një vrimë përmes rrënojës, u përvodhëm jashtë ku natyra ishte qetësuar dhe një mëngjez i vagëllimtë pranvere, përhapte puhizën e një shpresë të re mbi gjithësinë.

Me të hedhur sytë andej nga fusha e hapur, për habinë tonë, na zunë sytë Isakun, vëllaçkon tonë të vogël: kish hypur majë çatisë së shtëpisë së tij të re dhe po i vendoste asaj tjegullat e fundit me një gazmend në buzë, që buronte mes gurit të sigurisë dhe mendimit të tij vetjak.

*New York, dimër, 2002*

*Posta që sjell era*

## Mendjet e njerëzve

Znj. Kaleme e akuzoi të shoqin, teknikun e ndërzimit Marin Dermeku se ecte me mendjen e bukuroshes Pola Pupsi.

- Ke marrë mendjen e asaj piliherdhës, - i tha ajo, - prandaj më shikon shtrembër me sy.

Tekniku i ndërzimit e kundërshtoi gruan. Ai tha se mendjen e kish krejt të tijën dhe se nuk ia kishte marrë askujt. Madje ai shtoi, se mendjen e tij nuk do ta ndërronte as me mendjen më pjellore që mund të gjendej mbi shpinën e krrusur të tokës. Znj. Kaleme nuk i besoi të shoqit, i tha se gënjente...

Kështu, hidh e prit, thanë dofar fjalësh të hidhura e bënë njëfar shamate.

Që puna të mos shkonte gjer në ndarje, ata vajtën tek kryeplaku Maliq Burnazi dhe iu lutën ta shkoqiste drejt këtë punë.

Kryeplaku Maliq, ishte nga ata pleqtë e sertë e vramuz, të idhët - lëng vërrini, por të mençur e që s'ta bëjnë kurrë fjalën dy. Sapo kish mbushur të nëntëdhjetat dhe kish shpallur se nuk do të vdiste pa i shkoqitur mirë do punë të ngatërruara në Biboll.

Para nja dy muajsh, vajti ta merrte ëngjëlli Azrail, por nuk ia

doli dot mbanë. E reja e tij, znj. Ismete, bënte bè e rrufë se natën, pak para se të këndonte gjeli i parë, e kish dëgjuar të vjehrrin duke rrahur engjellin me shkop mu tek pragu i derës së shtëpisë.

- Unë të thërras vetë kur të jemë gati për të vdekur, o Azrail, - i kish thënë ai.

Pastaj e kishte urdhëruar t'i vinte majat nga kish vënë thembrat. Por Azraili si Azraili! Nuk qe bindur. Madje ai, për t'i mbushur mendjen plakut se duhej ta merrte me vete se s'bën, kish nxjerrë nga xhepi i tij edhe një kartë-vendim, të shkruar e të vulosur nga i lartmadhërishti dhe ia kish treguar.

- Unë zbatoj vendimet që merr i madhi Zot, nuk bëj në kokën time, o Maliq Burnazi, - i kish thënë Azraili duke hapur krahët si të deshte të shfajsohej.

Plaku i moçëm ia kish ngulur vështrimin që poshtë vetullave të trasha e të gjata si fshesë; pastaj, duke tundur shkopin e tij prej dru thane darrunga-darrunga, - athua se Azraili s'qe i dërguari i Zotit, por Xim budallai i mëhallës së poshtme, - i qe hakërryer:

- Ik ore mbushu me gjithë vendim! Të thashë: do të të thërras vetë sapo të shkokloj do punë të vogla.

Por, kur Azraili kish këmbëngulur në të vetën, plakut të urtë i kishin kërcyer rrebet, ia kish veshur me shkop kurrizit dhe ia kish bërë atë më të butë se barkun. Edhe atë vendimin e shkruar në letër nga i lartmadhërishti, ia kish grisur e bërë thërrime-thërrime. Tek e mbramja kish hyrë brenda, kish rrëmbyer kimën, dhe gjithë mllef nga inati, kish nisur të grinte duhan edhe për nja dy vjetë të tjera.

Me të dëgjuar ankesën e znj. Kaleme, kryeplaku Maliq thithi një shtëllungë të madhe tymi nga llulla e ndezur, përdrodhi mustaqet me gishta dhe ra në të thella.

Marin Dermeku nisi të fliste, donte të kundërshtonte ato që tha gruaja gjatë ankesës, por plaku i moçëm ngriti lart trinën e dorës,

e bëri të heshtë e tha:

- Durim...! Kam pasur shumë ankesa të tilla... Më vjen çudi se si arrijnë njerëzit të marrin mendjet e njëri-tjetrit! Vallahi, më duket se Zoti nuk e ka ndarë hiç drejt këtë punë.

Pastaj u tha të shkonin në shtëpi; të vinin sërish të dielën në darkë, sapo muzgu të rrasej në ahuret e bagëtive dhe hutini të lëshonte klithmën e parë.

Kryeplaku Maliq, vendosi t'ua mblidhte mendjet të gjithë njerëzve, t'i fuste në një dollap, që gjendej në murin e odës së tij, dhe pastaj, njerëzit të vinin një nga një, e secili të zgjidhte mendjen që dëshironte.

Të dielën në darkë, me t'u dëgjuar klithma e parë e hutinit, na u mblodhën tek kryeplaku gjithë bibollasit, i madh e i vogël.

Secili, nisi të dorëzonte mendjen e tij, ndërsa shkonin e zinin vendet jashtë, ca të ulur në bar e ca në këmbë, pasi qenë shumë në numër dhe nuk i nxinte dot të gjithë oda e kryeplakut.

Nja tre-katër vetë, dorëzuan vetëm nga një gjysëm mendje. Ato thanë se gjysma tjetër u kish rrjedhur prej halleve të shumta të jetës.

Zavalli Tosum Masllumi, i cili, gjatë gjithë jetës qe hequr si burrë i mençur, i la në dorë kryeplakut vetëm një çerek mendje.

Kjo çerek mendje qe bajagi e trashë, por e lehtë pupël.

Kryeplaku, uli pak kokën siç e kish zakon dhe e pa poshtë vetullave plot mosbesim Tosum Masllumin!

- Kaq kisha, - tha Tosum Masllumi, - nuk kam ku ta gjej më të plotë.

- Po ti sikur... - e preu fjalën në gjysmë kryeplaku dhe priti përgjigje.

- Tre çerekshin e kam shitur, prandaj e lëmë tani këtë muhabet, o kryeplaku ynë...- tha tjetri dhe doli jashtë.

Plaku urtar, i mori të gjitha mendjet e njerëzve bashkë me



gjysmat dhe i futi në dollap.

Pastaj, ia shkrepri t'i numëronte njëherë.

Për çudi, ai zbuloi që një mendje mungonte.

Doli jashtë e briti:

- Cili dinsëz nuk ma ka dhënë mendjen e tij?

- Unë, o kryeplak, - tha djaloshi Kil Tesporoti duke ngritur dorën lart.

Pastaj, lulkuqe nga turpi, ai shpjegoi se e kish humbur mendjen qysh para katër vjetësh duke rendur pas bukuroshes Pola

Pupsi. Pra, kuptohet, nuk kishte çfarë dorëzonte.

Kryeplaku ia tundi çibukun e ndezur mu para syve e tha:

- Turp... Turp i madh të humbë burri mend për dy gisht vend!

Kil Tesporoti bëri mënjanë i turpëruar.

Kel Fisti, - për të cilin pëshpëritej lart e poshtë se kish mendjen e një dhelpre, - e porosiste Xim budallain, që të bënte kujdes, se mos ndoshta, kur të zgjidhte për të marrë mendjen e re, nga pakujdesia, mund të merrte mendjen e Gjon Belaziut në vend të mendjes së Gjon Bolenës.

- Mjaft ndejte budalla, o Ximi, - i thoshte ai, - Gjithmonë laj e thaj një palë mend budallai! Përse të mos bëhesh edhe ti njëherë i zgjuar si Gjon Bolena?! Veç ki kujdes, si të thashë: zgjidh atë më të hollën si petë byreku dhe i ke rënë pikës.

Xim budallai tundëte kokën në shenjë miratimi; ndërsa herë pas here, hidhej në beft për të vrarë miza në hava me pëllëmbët e duarve të palara.

Znj. Kaleme, qe pështetur pas një huri gardhi. Pati krijuar një lidhje të përkohëshme me mendjen e saj tashmë të kyçur në dollapin e kryeplakut dhe kish rënë në një lloj soditje.

Herë kruante vithet pas hurit të gardhit, herë kruante dhëmbët me një fije bari dhe nuk dinte, cilën mendje duhej të zgjidhte.

Tekniku i ndërzimit Marin Dermeku, dukej i hutuar, nuk ishte i sigurtë nëse kish dorëzuar tek kryeplaku mendjen e vet, apo mendjen e bukuroshes Pola Pupsi.

Po çfarë bënin të tjerët?

Disa rrinin të heshtur e disa llafosnin anamendas me zë të vogël; natyrisht rragatje fjalësh, pa mend fare.

Që të mos i ngelej hatri askujt, kryeplaku Maliq, shkruajti një nga një secilin emër në copa të vogla letrash. Pastaj i palosi letrat me nge, i përziu mirë e mirë dhe kapi të parën.

Me ta hapur, ai thirri:

- Të vijë të zgjedhë i pari Xim budallai!

Kel Fisti e shtyu Ximin me teftik përpara e tha:

- Ec shpejt Xim...! Dhe mos harro porosinë: merr atë më të hollën, si petë byreku.

Xim budallai mori të ecte pa ia ndarë sytë një mize të madhe në fluturim.

U dëgjua zhurma e një lëvizje në grumbullin e madh të njerëzve dhe pastaj zëra:

- Shyqyr! Më në fund edhe Ximi nuk do të jetë më Xim.

- Kaq vite i shtyu i shkreti me atë mendje budallai!

- I thashë të marrë mendjen e hollë të Gjon Bolenës, por...

Kur Xim budallai doli jashtë, dukej i kënaqur me zgjedhjen që kish bërë. Ngriti të dy pëllëmbët e duarve lart e nisi të hidhej për të vrarë një murrelë, që gumëzhinte e bënte rrathë sipër kokës së tij. Pastaj, kur pa, që insekti fluturoi në drejtim të gjindjes, e tregoi me gisht e thirri:

- Murrela, murrela...! Vriteni se iku...! Uaaa...!

Dukej ashqare, që Xim budallai kishte marrë mendjen e vet.

I dyti, hyri zavalli Tosum Masllumi, si një cjad varros, i veshur me një xhakëtë xhivezi të mbushur plot dekorata!

Doli jashtë me çerekun e mendjes së tij të trashë e të lehtë pupël!

- Rrëmoja në gjithë atë grumbull, por nuk gjeta mendje më të mirë se timen, - shpalli ai.

Tekniku i ndërzimit Marin Dermeku, kish marrë dy mendje: mendjen e vet dhe atë të bukuroshes Pola Pupsi; ndaj kur doli, u mëdysh, nuk dinte nga t'ia mbante, iu ngatërruan këmbët e gati u rrëzua për të thyer qafën.

Kryeplaku Maliq e kuptoi, iu hakërrye me shkop dhe e detyroi të kthehej në odë e ta linte në dollap mendjen e dytë.

Kësodore, të gjithë hynë një nga një në odën e kryeplakut dhe morën në dollap secili mendjen e vet!

Më të zgjuarit të Bibollit, Gjon Bolenës, i ra shorti të hynte për të marrë i fundit. Ai nuk u çudit fare kur gjeti në dollap mendjen e tij. Askush s'e kishte prekur me dorë.

Teksa dilte, kryeplaku Maliq Burnazi e ndali dhe i tha:

- E shikon, o bir, si janë njerëzit?

*Kastriot, pranverë, 1996*

## Hiçi dhe Diçi

Para do kohësh mu desh të kërkoja një apartament me qera.

Vajta në një zyrë, që merrej me këtë punë dhe, pasi u qava hallin, një femërucekë, që e kish ngjyrosur kaptinën e saj të vogël mu si një vezë pashkësh, duke përtypur çamçakiz tha:

- Tani për tani, e vetmja mundësi që kemi, është të të rregullojmë në një apartament ku banojnë dy vëllezër, Hiçi dhe Diçi. Do të ndash me ta shtëpinë dhe qeranë. Kështu, nuk do të të duhet të paguash shumë para, dhe njëkohësishtë, do të gjendesh në shoqërinë e tyre.

Të them të drejtën, që kur jam ndarë me gruan, (e hëngërt kulçedra atë llaçkë të keqe), nuk kam dëshirë të takoj as të njohur, as të panjohur. Më pëlqen të rri vetëm, sepse, sa herë i takoj, përpiqen të më mëshirojnë. Ndërsa në mendje kanë tjetër gjë, rreken të më japin të drejtë për të më lënë të kuptoj se gruaja ime...

Por le ta lëmë këtë muhabetin e gruas, sepse e kam dorë më një, që po ta zë me gojë atë dhi me një bri, gjithë dita do më shkojë ters. Madje, rrezik të më shkasë prej binarësh edhe rrëfimi.

Që t'i biem shkurt, të nesërmen pasdite, u gjenda në

apartamentin e ri vetë i tretë: unë, Diçi dhe Hiçi.

Hiçi qe një burrë me flokë të rrallë, të zes e si të lëpirë. Mbante mustaqe të holla me majë. Kishte sy të vegjël prej miu, të zhytur në tul. Dukej si një rrondokop i qullët. Ishte ai që më priti i pari. Sapo hyra, më zgjati dorën e djathtë, një dorë të djersitur, të vogël e si pa kocka. Gishtërinjtë i kishte të ngrdyhët e të bardhë si bulbi poroz i kërpuhdës. Me të majtën, Hiçi mbante pantallonat që të mos i binin, pasi nuk qenë të vetat, por qenë pantallonat e të vëllait të tij, Diçit.

Diku pranë dritares, qe ulur në një kanapë, i vëllai i tij Diçi. Diçi qe më i vogël në moshë, por më i madh nga shtati. Rrobat që kishte veshur e bënë të dukej për hagarët të Zotit. Pantallonat i kishte aq të shkurta e të ngushta, sa të krijohej përshtypja sikur qe rritur brenda tyre. Më vonë do të mësoja, që Hiçi vishej me rrobat e Diçit, dhe Diçi, me ato të Hiçit. Nëse sot Diçi blinte një gjë për veten e tij, të nesërmen atë do ia merrte Hiçi. Kështu, gjërat e Hiçit i ngeleshin Diçit.

Shtëpia kishte dy dhoma gjumi. Njëra,- ajo ku do të flija unë,- ishte krejt e boshatisur. Dhoma e tyre kishte dy shtretër, një televizor, (të kthyer nga krevati ku flinte Hiçi) dhe dy rafte rrobash. Dy dritaret e dhomës së tyre shikonin nga jug-perëndimi. Gjithandej në mure, qenë varur korniza me fotografi të Hiçit. Dyshemeja prej dërrase, gjithë lloëmshiti, ngjante me ato llaçet e ndyra ku zhgërryhen gomerët. Rreth mureve, në të katër anët, binin në sy ca vrima minjsh të shtuposura me letra.

Më ftuan të ulesha në një karrige dhe unë zura vend, ngadalë e disi me droje duke u përpjekur të lija një përshtypje të mirë. Hiçi i vogël u kapardis në shtratin e Diçit dhe Diçi i madh u kruspullo në atë të Hiçit. Gjatë bisedës, Hiçi hiqej me të madh, krekosej para Diçit, diç donte të thoshte, por se thoshte dot. Dukej se kishte një shqetësim, të cilin, përpiquej ta fshihte. I rrotullonte sytë nëpër

dhomë, athua sikur nga çasti në çast, do të mbinte si nga toka dikush e do t'i thoshte që gënjente. Në raste të tilla, për ta nxjerrë nga situata, gjithnjë futej në bisedë Diçi. Hiçi e miratonte: “Po, po! Ma more fjalën nga goja, - thoshte me nxitim ai, - Ti the pikërisht atë që doja të thoja unë”.

Sa herë ndodhte që Diçi hapte gojën për të folur, Hiçi e ndërpriste, e pyeste se çfarë donte të thoshte. Kur Diçi i shpjegonte se donte të thoshte këtë e atë, atëherë e merrte fjalën Hiçi: niste të qiste dokrra e të numëronte kakërdhi. Qenë dy tipa, të ndërkallur çuditërisht brenda njëri-tjetrit.

Në fakt, Diçin e kisha më për zemër. Ndonëse që i tutur, kishte më tepër prezencë se Hiçi. Mund të flisje e të kuptoheshe lehtë me të. Por, kur i drejtohesha me ndonjë pyetje Diçit, hidhej Hiçi t'më jepte përgjigje. Ama Hiçi, gjithëherë e linte diçka mangut, që duhej ta plotësonte Diçi.

Hiçin, të them të drejtën, nuk e honepsia hiç. Që në pamje të parë dukej kokëtrashë e llaçkar. Mbante ngaherë një bllok shënimesh me vete si dhe disa lapsa karboni, që ia mprihte rregullisht Diçi. I fuste ata në një çantë meshini, të cilën, para ca vitesh e kish pas blerë Diçi për veten e tij. Ky bllok, i shërbente për të shkruar në faqet e tij disa të vërteta që dilnin nga goja e Diçit. Gjithshka i përkiste Diçit, do ta merrte Hiçi, që nga vlerat morale e deri tek ato materiale.

Diçi, edhe që martuar një herë me një grua dukane e të përhedhur, që në s'gabo, thirrej Lena. Por s'kish qëndruar gjatë me të pasi ia kish marrë Hiçi.

Kjo grua kish lindur edhe një fëmijë me Diçin, por Hiçi e kishte shkruar mbi vete atësinë.

E gjendur mes Diçit dhe Hiçit, Lena kishte rënë në hall të madh, nuk kish pasur ç'të bënte dhe kishte vajtur të ankohej në prokurori.

Prokurori i çështjes, një djalë i ri nga Bibolli, që pati bërë emër

me çështjen e famshme të asaj që u quajt “Kryengritja e Tarrotëve”, e kish dëgjuar me shumë vëmendje gruan hallexheshë. E pati ndihmuar të plotësonte edhe akt-padinë, e cila, rëndonte më tepër mbi Hiçin. Pastaj, ai kishte thirrur për të marrë në pyetje Diçin, por në vend të tij kishte shkuar Hiçi. Kështu, puna qe ngatërruar e qe bërë lëmsh i pazgjidhur. Atëherë Lena, qe larguar prej tyre duke iu lutur shën Ndoit t’i gjente një burrë tjetër.

Diçi gatuate, shtronte tryezën, lante pjatat dhe tenxheret, pastronte shtëpinë. Ai bënte çdo punë që duhej bërë. Madje ai kishte edhe një punë të përditshme në një kompani paketimi, të cilën, e fillonte në shtatë të mëngjesit dhe e linte në katër pasdite. Por, paratë që fitonte me punën që bënte, i fuste në bankë, në numërin e llogarisë së Hiçit.

Hiçi hante mirë. Për çdo darkë, pinte nga një bokale verë të markës Brulë, një verë kjo, që pihej e ngrohtë, me kanellë dhe karafila. Ai nuk harronte të fuste brenda saj edhe ca copëza të vogla pjeshke ose molle. Kurse Diçi pinte ujë nga çezma.

Fjalët që thoshte Diçi, nuk i kishte të vetat, ai i merrte ato nga goja e Hiçit! Këtë ma tha vetë Hiçi, kur po përpiquej të zinte me shtupa letre vrimën e një miu, i cili, dilte shpesh natën për t’i bërë karshillëk!

Ky mi jetonte prej shumë kohësh poshtë dyshemesë dhe ishte qenia që Hiçi e urrente më shumë. Nuk kishte gjë në botë, që Hiçi ta urrente më tepër se këtë kafshë të vogël e të ndyrë vrimash. Kishte vite që ishte torturuar në përpjekjet për ta zënë, por nuk ia kish dalë mbanë. I kishte ngritur kurthe dhe i kish vendosur gjithandej nëpër shtëpi ushqime të helmatisura. Por miu i pati shpërfillur me indiferencë dhe u qe shmangur me zgjuarsi të gjitha kurtheve që ngrinte Hiçi. Sapo Hiçi i mbyllte një vrimë, ai do të hapte një vrimë

tjetër, do të mbinte pranë tij pikërisht kur nuk pritej. Do të merrte pozicion i ngrefrosur në bisht dhe do t'i bënte karshillëk: fillonte të bënte disa veprime, që nuk dihej pse Hiçit i dukeshin si imitime egzakte të personit të tij. Pastaj, si prekte me këmbët e para turirin dhe mustaqet, niste të lëpihej: së pari këmbët, së dyti qimet e barkut, dhe në fund, kurrizin. Gjithësaherë me një shpërfillje e karshillëk që e bënte Hiçin të ziente ngadalë nën vete e të harmatohej mënie. Nëse Hiçi bënte lëvizjen më të vogël për ta goditur, ta zëmë me fshesë, asohere, sa hap e mbyll sytë, ai bëhej fir brenda vrimës. Por nuk vononte dhe shfaqej sërish: nxirrte ngadalë kokën nga vrima dhe e vështronte Hiçin si brac me sytë e vegjël vizëllues. Thjeshtë e vështronte. Por Hiçit i bëhej sikur i thoshte:

“Ah, rrufjan ti rrufian! Të njoh mirë unë ty, të njoh mirë!”

Mbrëmjen e ditës tjetër, unë, Diçi dhe Hiçi, e zgjatëm pak si gjatë bisedën. Andej nga e vona, çuditërisht, ne dolëm të njohur nga dajat e babait tim. Na doli që unë isha, - me nder jush, - stërnipi më i mbramë i Hiçit dhe Diçit. Atëherë si me këtë rast, ne hodhëm nga një gotë. Të bërë në qejf, na e shkrepri ta asgjësonim atë kafshëz të vogël djallëzore, që i binte më qafë dajë Hiçit. Kështu, ne organizuam një si lloj operacioni që e pagëzuam “Kthetrat e maces”. E ruajtëm miun kur doli nga vrima, e rrethuam dhe iu sulëm me yrish të gjithë njëherësh...

Për fat të keq gabuam taktikisht. Jo vetëm që nuk e asgjesuam dot, por patëm shumë humbje nga ana jonë: Diçi e gjuajti miun me këpucë, por pa dashje, ia paraveshi turinjve Hiçit. Hiçit iu errën sytë, u pengua në një karrige, u rrëzua dhe u përdrohd në kërbishte. Kurse unë theva aksidentalisht një poçe të shtrenjtë dekorative me motive nga lashtësia, si dhe rrëzova nga muret në dysheme dy portrete të dajë Hiçit.



Të dërrmuar nga humbja, i futëm nga një të sharë belaziut dhe ramë për të fjetur.

Teksa dëgjoja Diçin të rrotullohej për të gjetur rehat në krevatin e vogël të Hiçit, për herë të parë, ndjeva për të një keqardhje të thellë. U ngrita nga vendi ku isha ulur dhe vajta pranë krevatit të Diçit ku qe shtrirë Hiçi. Kish rënë në një gjendje gjysëm të përgjumur. Balli i ngushtë i qe mbuluar me bulëza të vogëla djerse. Cepi i buzës së poshtëme i qe varur mbi jastëkun e lagur me jargë. Sa herë merrte e nxirrte frymë, Hiçi lëshonte me hundë një fishkëllimë të lehtë si cingëritje miu.

Sapo e tunda, ai hapi sytë disi i tramkosur dhe u përpoq të ftillohej. I thashë me takt, që do të ishte e arsyeshme, të ngrihej, ta lironte atë shtrat që s' ishte i tij dhe të shkonte në shtratin e vet. Por dajë Hiçi, nuk lëvizi. Duke përtypur ngadalë me dhëmbë kushedi çfarë fjale të pa thënë, më shqiri me sytë plot urrejtje. Unë vështrova Diçin me shpresë se do të reagoonte, por ai nuk reagoi fare. Tek e fundit, Diçi u kthye nga unë e si me përtesë dhe duke rrudhur ballin e ngritur supet, psherëtiu e tha:

“Është vëllai im i madh dhe duhet respektuar.”

Të them të drejtën, më kërceu inati në majë të hundës. Thashë me vete: “Djali ta marrë! Ky Diçi qenka më hiç se Hiçi!” Dhe e harrova punën e tyre. Vajta sërish në dhomën time dhe u shtriva me shpresë se do të më merrte gjumi. Por gjumi s'po më merrte që s'po më merrte. Në mendje, herë më fanitej ajo skena me miun, herë ajo thatiçka me flokët e gafruara, gruaja ime torrovole, për shkak të së cilës, u katandisa në këtë far feje. (E piftë bolla në gjumë natën e krishtlindjeve!)

Tevona, kur po më kopsiteshin sytë, që nga dhoma ku flinin Hiçi dhe Diçi, më erdhi në vesh, në fillim një si britmë miturishte,

pastaj një zë disi i sertë e kanosës.

U ngrita ngadalë nga shtrati dhe hapa me kujdes derën. Eca përmes korridorit dhe u avita pahetueshëm pranë derës gjysëm të hapur të dhomës ku flinin Hiçi dhe Diçi.

Vura rë që Diçi gërhiste për shtatë palë qejfe në shtratin e Hiçit. Kurse dajë Hiçi qe ngritur ndenjtur në shtratin e Diçit, ndërsa me lotë në sy thoshte:

- Ti po më shkatërron, ta dish! Unë jam njeri me shkollë, i respektuar...

Përballë tij, diku pranë vrimës, qëndronte në bisht kafsha e vogël. E dëgjonte shpërfillshëm, e shigjetonte me sytë vizëllues, dhe teksa lëpihej, dukej sikur thoshte:

“Ah, rrufjan ti rrufian! Të njoh mirë unë ty, të njoh mirë!”

*New York, verë, 2004*

## Dërgesa e Zotit

Qenë pushimet verore dhe shkolla do të rrinte mbyllur gjer në shtator.

Loja pati filluar qyshkur qerosit Hilë Lukreci, i ra shorti të luante rolin e Zotit.

- Mjaft i je lutur Zotit! - i tha atij Emili. - Provoje edhe ti njëherë sa punë e

vështirë është të jesh Zot!

Unë i lashë në dorë porosinë time Hilë Lukrecit dhe fluturova të thërrisja Elbaroza Delfin.

E gjeta në oborr teksa ujiste lulemëngjeset, të kaltra, të bardha dhe vjollcë.

- Ku do të shkojmë? - pyeti ajo dhe qeshi si gjithmonë.

- Do të shkojmë tek djerrina e Lalë Pogës, të luajmë e t'i lutemi Zotit të na sjellë gjithë të mirat, - i thashë unë.

- Prit pak, sa t'i marr leje nanës, - tha ajo. Dhe si la gjymin në tokë, hyri në shtëpi.

Kur doli, kish veshur një fustan të bukur: i zi, i stërpikur plym me pikëla të vogla, të bardha.

Ne djemtë përpara dhe Elbaroza pas nesh, morëm rrugën përgjatë kanalit, uji i të cilit, vinte që lart prej bjeshkëve, çante mospërmes Bibollit, dhe duke gjarpëruar shpatit të djathtë të Luginës së dragojve, mbërrinte pranë djerrinës së Lalë Pogës; pastaj rrëshqiste mospërmes fushës pafund.

Verës, për shkak të vaditjeve të shumta, s'arrinte të derdhej në lumë.

I lamë prapa ngastrat me misrin e njomë që kundërmonte aromë klorofili, parcelat me jonxhën, ku vende-vende e kish pushtuar mitili i verdhë; kopshtijet me freskinë gjithnjë të pabjerrur plot perime: kastravecet me lozet që pushtonin ledhet, shalqinë e bostanë, domate të kuqe në formën e një zemre kau, me tulin plot xixëllime ari, si dhe luleshtrydhet, kokrrat e mëdha e të pjekura të të cilave, fshatarkat mundimtare, i fshihnin prej syve lakmitarë duke i mbuluar me gjethe të mëdha e të freskëta hardhie.

Këto fryte të begata, të rritura më shumë nga stërmundimi i plakave, qarkoheshin nga rreziqe të panumërta, ku më shkatërruesi, mbetej ai i lojës sonë.

Ne mbërritëm të pestë në djerrinën e largët e të rrafshët, plot kamomil, luleqyqe e tërfil të egër, e ku bulkthet e zinj, nxirrnin kokat vrimave dhe na vështronin ashtu siç vështrohen veç mysafirët e pafuar. Me antenat drejtuar nga ne për të vjelë e nuhatur shkallën e rrezikut që u kanosej, ata hidhnin ndonjë çërritje si të deshnin ta shtonin zabullimën e vapës.

Gjithçka heshtonte paqësisht, një heshtje e ngjashme me heshtjen e mistershme të natës.

Qe njëra nga ditët e djegagurit ku vapullima, njëlloj si nata, i mblidhte në shtëpi njerëzit.

Emil Pupsi, hoqi këmishën, dhe me trupin lakuriq, u ul në gjunjë pranë kanalit të ujit që zhurmonte lehtë. Në emër të të

gjithëve, përmes kukurisjeve tona, ai nisi të thoshte me zë të lartë “Lutjen për rrushin”, e cila, qe më e preferuara në atë orë.

Me vështrimin mbi të vetmen fjollë tymi, që ngrihej qiellit mbi katund, Emil Pupsi tha:

- Ati ynë, që tani duhet të jesh i fshehur në parcelën me misër të Aqif Dermekut, u shenjtëroftë emri yt! U bëftë në këtë djerrinë vullneti yt! Rrushin tonë të përditshëm na jep sot! Na i fal fajet tona, si u falim ne plakave të Bibollit mallkimet që ato lëshojnë mbi ne! Amen!

Pastaj pritëm në heshtje bukur kohë, kur e kur duke hedhur ndonjë fjalë giciluese kundrejt Ernest Misurit, për të cilin, Rritan Meteorit, thoshte se “kish filluar t’i këndonte gjeli”. I pati lyer flokët me brilantinë dhe ngjante si një viç i sapolëpirë nga lopa!

Kushedi për të satën herë i kujtuam njëri-tjetrit subjektet e filmave “Mbërritën titanët”, “Helena e Trojës”, apo “Pjetri dinak”, të cilët, një herë në muaj, na i sillte rregullisht, sipas rradhës, një burrë tullac me një emër paksa të ngatërruar dhe me sytë gëllq të kërcyer nga zgavrat.

Çdo kryemuaj, “tullaci i filmave”, vinte duke ecur rrugës shtrembas, athua se nga çasti në çast matej të gjuante ndonjë penallti; duke e mbajtur kokën menjëanë e duke shpuar me një kunj vitheve dy mushka të zgërlaqura të ngarkuara me valixhet ku kish futur aparaturat.

Me mendimin absurd se çdo katund qe një Trojë e vogël, (në të cilin për çdo brez njerëzor lindej dhe rritej nga një Helenë), filluam ta përqsanim Helenën e Trojës me Elbarozën e Bibollit, me këtë vajzë të hijëshme me bishtaleca e me një gropëz në faqen e majtë, gjithmonë e qeshur.

Ramë në ujdin për ta shtangur mendimin e përbashkët, që në

shikim të parë, Elbaroza ngjante kryekëput me Helenën e Trojës. Por, fakti që Helenën e sillte në katund një burrë i shëmtuar, shtrembaluq e me kokordhokët e syve gëllq të dalë nga zgavrat, tregonte që nuk meritonte t'i jepje aq sa ç'i jepnim ne Elbarozës. Për fatin e saj (dhe tonin bashkë), Rritan Meteori, si më i ditur që ishte, plasi sheshit edhe tre fakte të tjera në favor të Elbarozës: Helena e Trojës, qenkesh lindur nga një grua xhahuze pa burrë të ligjshëm, na kish pas do huje hajnie, dhe për më tepër, ai tha se paskësh qenë edhe rruspi! Dhe më e forta qe, se këto fakte, ai i kish mësuar nga teze Liveta!

Sa për heronjtë meshkuj si ata të filmit, Bibolli nuk na kish pasur vetëmse situatat dhe rrethanat në Biboll, për shkak të kohës, që kish avancuar mijëra vjet përpara, qenë krahasimisht ndryshe me ato të Trojës; porse në një far kuptimi ama, ne ishim të bindur që e kishim brenda shpirtit tonë një tharm heroizmi trojan.

Kushedi sa do të kishin zgjatur këto rropatije mendimesh sikur Elbaroza Delfi, që vigjëlonte e ulur si një hyri pranë kanalit të ujit, të mos lëshonte atë thirrjen e saj gazmore, që do të thoshte se Zoti e kish marrë parasysh lutjen tonë: na i kish sjellë përmes kanalit të ujit vilet e rrushit, të bardhë e të zi, me kokrrat e pjekura.

I kapëm pa ndonjë mundim të madh dhe ashtu të larë për bukuri nga vozitja në ujin e pastër, nisëm t'i vendosnim me kujdes mbi barin e djerrinës, i cili, ende ruante një lloj njomështie prej vesës së mëngjesit.

Për shkak të prurjeve të shumta, u bë një grumbull bajagi i madh, ndaj qemë të detyruar të binim edhe njëherë në gjunjë për t'iu lutur Zotit, që ta ndërpriste këtë dërgatë mirësie, sepse vërtet nuk kishim ç'ta bënim gjithë atë kamare me rrush. Porse Zoti nuk e dëgjoi lutjen tonë; pengesa që kishim ndërtuar me gurë e me degë në kanalin e ujit, nisi të furej e gufovej nga vilet e rrushit gjersa grumbulli erdh' e u rrit aq shumë, sa filluam të dyshonim, që Zoti

ynë qeros, na paskësh qenë edhe si punë zavalli, nuk e paskësh pas fare sensin e masës!

Ne peshkonim e nxirrnim papushim nga uji rrush në lëndinë derisa erdhi çasti i shumëpritur i sosjes, dhe si hodhëm mbi grumbull vilet e fundit, u sulëm të hanim babëzisht.

Përmes fjalësh, që dilnin të mbytura nga gojët e mbushura plot kokërra të ëmbla, Rritan Meteorin, pa i shpëtuar dot një ndjenje bashkëfajësie, bëri ritin e falenderimit ndaj Zotit:

- Të falenderojmë o Zot, për rrushin që e morëm prej dorës sate! Ruaju nga rreziku dhe qofsh shëndoshë e mirë!

Pastaj nisëm një lojë futbollit me top, dy me dy, Ernesti me Rritan Meteorin në një anë dhe unë me Emilin në anën tjetër.

Loja e parë zgjati deri andej nga dymbëdhjeta, ku pala tjetër hëngri dy gola, kurse ne hëngrëm vetëm gjashtë.

Si ndërruam fushë, Elbaroza, hyri në kanal me gjithë fustanin e saj pikëlimtar dhe përgjatë gjithë kohës, mua më mbeti mendja peng tek ajo.

E shikoja vjedhurazi si ngrihej në këmbë me fustanin e lagur ngjit për trupit që kullonte currila uji, dhe për çdoherë, unë zbuloja fakte të reja, që e largonin atë nga ajo rruspia e Trojës dhe e afronin më pranë vetes.

M'u shpif në emtesë që kohët e fundit, harku i butë përgjatë peshkut të kurrizit të saj, që tendosur shtëpërmi duke nxjerrë në pah një kraharor ku sapo që formësuar delta e gijve si dhe një palë mollaqe, të cilat, të para në profil, ngjanin tamam si dy gjysmahëne. Në miset e fytyrës së saj të lagur kishte një lloj shenjtërimi prej ikone. Me ato vetulla si të spërkatura me brymë, xixëllimin plot gjallnim të syve të zinj, lakesa e buzëve të bymuara, të atyre buzëve si tul i freskët luleshtrydheje, që ajo, (o Zot!), dinte t'i mbyllte kaq ëmbëlsisht...

Sapo kishte shkelur në bilik dhe nuk kish pik dyshimi, që e pati për pir bukurinë. Ngado që shkonte, dukej sikur linte pas faksin e saj dhe ta çmendëte një dëshirë pushtimi.

Kjo bjerrje e imja pas saj na kushtoi shtrenjtë: unë dhe Emili hëngrëm sërish pesë gola (nga ata që u qe bërë mendja vetëm top futbollit), porse të fundit s'ua quajtëm, ngulëm këmbë pa të drejtë se qe apsjat.

Gjatë gjithë kohës që u morëm me lojën, Elbaroza u llapashit në kanal me gjithë fustanin e saj pikëlimtar deri kur mbërriti koha e lutjes së orës dymbëdhjetë, që i përkiste Rritan Meteorit.

Atëherë Rritan Meteorit ra në gjuhë dhe nisi t'i lutej Zotit tonë me sytë e picërruar nga një re e bardhë që rrëshqiste nëpër qiell duke u shpupëluar.

Të larë në djersë, qemë ulur të pushonim mbi barin e djerrinës, ndërsa më kot përpiqeshim të shohisnim me zë të lartë, mosmarrëveshjet që kishim pasur gjatë ndeshjes duke i plasur ndërsy çdonjëri-tjetrit, thasë plot me gabime, që binin ndesh me rregullat e lojës.

Pikërisht atëherë, Elbaroza na thirri e tha se duhej të nxirrnim nga uji i kanalit një tjetër dërgesë nga Zoti ynë.

Pamë që kishin mbërritur tek prita katër shalqinjë të mëdhenj e të freskët, të cilët i nxorëm dhe i rrokullisëm djerrinës.

Pas shalqinëve mbërritën varg e vistër dardhat e buta verore, një qese e lidhur tek gryka e mbushur plot luleshtrydhe të pjekura, dhe sërish një lloj tjetër rrushi, kokërrmadh e i kuq, që të shkrihej në gojë.

I hapëm shalqinjët, gjithsekush të vetin, dhe unë i dhashë zemrën me gjithë zemër Albarozës. I zgjata t'i jepja edhe dy dardha të buta verore, por ajo nuk i mori. Tha se pas zemrës së shalqinit, do të hante ca kokrra luleshtrydhe dhe asgjë tjetër.



Tashmë Elbaroza kish filluar të avullonte dhe unë patia një ndjesi sikur dielli atje lart, e ndriçonte atë më shumë nga ne, e lante me një prajshmëri të dyfishtë. Një cullufe e lagur flokësh, i kish vizuar ballin mbi syrin e majtë dhe kish rrëshqitur përgjatë faqes gjithë hijeshi.

Hante ngadalë e në heshtje, rrotullonte sytë herë nga njëri, herë nga tjetri, dhe, për çdoherë që ia këpusnim të forta, qeshte me gjithë shpirt duke zbuluar dhëmbët e rregullt e të bardhë.

- Më vjen çudi, - thoshte ajo me një sinqeritet naiv, - se si Zoti i dëgjon lutjet tuaja dhe j'ua plotëson dëshirat...

Kur dielli u mbërthye në kup të qiellit, vapullimi u shtua dhe nisën të turrnaknin turtujt.

Ne hymë që të katër në kanal ku u pllaquritëm një copë herë në rrymën e kaltër, duke e lënë Albarozën sipër nesh, si të paskeshim bërë një marrëveshje të heshtur, që uji i saj të na lante neve, porse i yni kurrsesi atë.

U freskuam mirë, pastaj dolëm dhe ia nisëm sërish lojës sonë gjersa unë dhe Emili, hëngrëm shtatë gola, kurse Rritani me Ernestin, nuk hëngrën asnjë.

Ndërruam sërish fushat dhe bëmë një pushim të shkurtër, gjatë të cilit, unë vajta buzë ujit, u ula në gjunjë dhe thashë me zë të vogël lutjen time në adresë të Zotit.

Teksa ngrihesha për të nisur sërish lojën, i thashë Elbarozës të bënte kujdes, ta priste dërgesën e fundit, që Zoti do ta sillte mbi syprinën e ujit që rrëshqiste shpengueshëm.

- Mos ki merak, - tha ajo. - Asgjë nuk mund të më kalojë pa e vënë re.

Vazhduam sërish ndeshjen tonë me top, dhe unë, u bëra kaq qesharak në lojë, sa Emili u shkith e gati ia plasi vajit teksa u betua, që nuk do të luante kurrë më në anën time.

- Ti sot po luan si një ngalakaq i qorollepsur! - tha ai dhe nxorri

një gurgull fryme.

Pastaj fshiu me parakrah djersët e ballit dhe shtoi:

- Të paktën paso, se ma plase shpirtin.

Më vinte keq për Emilin, që e merrte kaq seriozisht lojën dhe e vuante kaq shumë humbjen, por atë ditë s'mund të bëja më tepër. Sepse unë e di: kurrësesi nuk mund të luhet si duhet me topin nëpër këmbë e me mendjen e vdjerrur.

Elbaroza lllapashitej, gjithnjë me sytë nga syprina e ujit atje tej, ku valët e lehta vinin drejt saj duke çuçuritur në një gjuhë të pakuptueshme, por që ta kish ënda ta dëgjoje prore. Rrezet e diellit e spërkasnin syprinën e lëvizëshme të ujit me një feks dritëzimesh marramendëse. Kur e kur më të rrallë, ajo kthente kokën nga unë, vetullonte pa të keq e qeshte.

Dhe ja, tekevona, mbërriti çasti i shumëpritur: mbi syprinën e ujit, u nëpërduk të vinte drejt saj buqeta shumëngjyrëshe me lulemine, shebojë e lulezjarri, lidhur e mbështjellë për fundit me një pusullë të vogël prej letre të kaltër punëdoreje.

Kur Elbaroza e nxori nga uji tufën me lule, pata një fërgëllim të beftë, pastaj zemra nisi të më rrihte fort. E pashë si stepi e habitur, se si iu shtua xixëllimi në sy; pastaj sikur u kap gafil para vetes dhe Zotit tonë; të atij zoti qeros, por të mrekullueshëm, që na i pati dëgjuar lutjet e që na solli asaj dite gjithë të mirat, e bashkë me ta, edhe atë tufë lule me një pusullë, ku qe shkruar një fjalë e zbritur nga qielli, një fjalë që i përkiste vetëm asaj, Elbarozës së bukur, me bishtalecat e gjatë e me gropëzën në faqe.

Pusulla qe lagur, shkronjat kishin humbur disi trajtat, dhe Elbaroza, ndonëse e dinte çfarë qe shkruar aty, vendosi të rrinte përgjithmonë me mua, që t'ia zbërthenim mirë kuptimin...

*New York, dimër, 2001*

*Posta që sjell era*

## Ara e pakorrur

Geg Alia trokiti fort në portën e madhe të avllisë së shtëpisë së tij pikërisht në çastet kur po mbuzej nata. Ai shquajti mes plasave të dërrasave të vjetra të portës, rrezimet e dritës se oborrit që u ndez, dëgjoji të hapej dera e brendshme si dhe ndjeu zhurmën e lehtë të hapave të nxituara të së shoqes. Së fundi, llozi kërciti dhe porta u hap me një gërvimë vajtuese.

Margjela u shfaq para tij me duart gjithë brumë. Duke buzëqeshur me një ndjenjë të vockël faji dhe duke picërruar sytë ngase vazhdonte të përtypte të kafshuarën e një ftoi, si të deshte të kërkonte ndjesë për vonesën ajo tha:

- Po rrihja brumin.

Kali i ngarkuar me dru hyri në oborr duke rrahur fort kalldrëmin me patkoin e së djathtës, që mbahej vetëm me një thumb.

- Nuk dua ta gjej edhe njëherë portën mbyllur, - tha prerë ai ndërsa zgjidhte litarët e barrës. - Ti e di që unë në këtë orë vij gjithmonë.

- Ta kam thënë përse e mbyll, - ia pati gruaja teksa përpiqej ta ndihmonte. - Tani ka pllakosur nata. Nuk dua ta humbas qenin.

E hodhën në tokë barrën e druve dhe e lanë kalin të endej oborrit me litarët e gjatë nëpër këmbë.

Ai mori sëpatën, dhe, tekta u nis të hynte në shtëpi, e urdhëroi gruan t'i varte kalit në qafë torbën e tagjisë.

Para dy ditësh, Margjela i kish thënë se në arën e tyre me misër të pakorrur që gjendej prapa shtëpisë, fshihej një ujk.

E kish parë tekta përvidhej ngadalë e gjithë zoritje përgjatë vijës së ujit me bishtin nën shalë. “Mu duk si i cokatun. Ecte mundimshëm athua se kish ndonjë plagë pushke në trup”, - pati deklaruar Margjela.

Geg Alia nuk e kishte besuar. “Qeni i Has Brovinës të është dukur si ujk” i pati thënë ai gruas. Por të nesërmen, Margjela e hasi sërish egërsirën mu në mes të ditës. Kish dashur të korrte, kur befas, vetëm pak metra larg saj, qe shfaqur i njëjti ujk.

Kësaj here i shtrirë barkas, koka e ulur rrafsh me tokën, turiri i zgjatur përpara, dhe nga sytë e kuq si rubini, buronte një xixëllim i ftohtë dhe i frikshëm! E përdatur për vdekje, ajo qe zbrapsur sëprapthi drejt shtëpisë.

Që të dy u ulën ballë për ballë rreth tryezës së shtruar të hanin darkën. Përtypeshin në heshtje, dhe, kur e kur, hidhnin ndonjë fjalë më të rrallë.

- Jam e sigurtë se qe një ujk i sëmurë, - tha gruaja. - Madje herën e dytë, u ndodha kaq pranë tij sa ia pashë edhe mizat rreth syve.

Burri kërkoi një thelb hudhre dhe ajo u ngrit e ia sollti. Ai e griu me thikë sipër pjatës së mbushur me gjellë dhe nisi sërish të hante në heshtje.

- Edhe nesër nuk korr dot, - shpalli më në fund e vendosur ajo. - Jam e bindur, që ndodhet ende aty. E ka bërë arën tonë si shtëpinë e tij!

Tjetri psherëtiu dhe kërkoi një gotë birra.

- U bëmë me një ujk! - tha. - Tashmë kemi një kalë, një lopë,

një qen dhe një ujk! Nuk të duket kjo diçka e veçantë?!

- Gjykoje si të duash, - ia ktheu ajo. - Por mua më duket se e veçanta qëndron tek rreziku në shqimth të derës.

E la lugën mbi tavolinë, fshiu buzët me një mapë, dhe, teksa ngriti shishen për t'i hedhur birrë në gotë shtoi: - Ta dish, që po s'korra këto ditë, do ia behin shirat. Pastaj kush e di sa do të na duhet të presim. Unë them: merr armën dhe dil e gjeje.

- Tani është natë, - tha si me përtesë Geg Alia. - Nesër në mëngjes, nëse do ta gjej në arë, do ta vras.

- Nesër duhet të shkosh në qytet, të bleshë ilaçet! - i kujtoi qortueshëm ajo. Ia vendosi gotën e mbushur përpara, u ngrit në këmbë, iu avit dritares, hapi perden me duar e vijoi: - Jashtë ka hënë të plotë. Shihet edhe kokrra e drithit para pulës. Athua se ka zbardhur mëngjesi! Po të duash vij edhe unë, marrim qenin dhe dalim.

Ai nuk foli. Mori gotën e birrës dhe duke e drejtuar nga gruaja, buzagaz e disi me shpoti tha:

- Për guximin tënd prej burri!

Dhe e piu me fund. U zdërgja njëherë në karrige, ndezi një cigare dhe gogësiu.

- Hëngra shumë, - tha.

Jashtë, herë pas here, qeni angullinte e lëshonte lehje monotone.

I zoti ia njihte lehjet qenit të tij: të zvergura e disi me përtesë karshi kalimtarëve; të rrëmbyera, kur afrohej ndonjë qen i huaj; monotone e si të trembura sa herë ndjente nga larg duhmën e kafshës së egër.

Geg Alia u ngrit ngadalë nga karrigia duke mermëritur nëpër dhëmbë diçka të pakuptueshme. Por ajo e mori me mend, që ai kish këputur ndonjë të sharë në adresë të sëmundjes.

- Do ziej fier guri, t'i pish lëngun, - e ngushëlloi ajo. Dhe u nis

të merrte barin, që kish mbledhur në vendet e mugëta të skutinave të lagështa rrëzë shkëmbinje.

Geg Alia nuk foli. Duke mbajtur njëren dorë mbi ijen e majtë, vajti pranë dollapit të futur në mur nga ku nxorri prej aty një karabinë pesëshe. Pastaj hapi sirtarin e një komoje të vjetër. Ndërsa rrëmonte në kërkim të fishekëve, u dëgjua pingërrima e një filxhani që ra mbi dyshemenë prej çimentoje. Para dy ditësh kish futur në sirtar katër fishekë me saçma derri, por s'po i gjente! Teksa ngriti filxhanin nga dyshemeja, gruaja i kujtoi se arma ishte e mbushur. Ai tërhoqi shulin prapa dhe u sigurua, që fisheku ndodhej në fole.

- Para se të vije ti, desha të dal njëherë vetë, - shpjegoi Margjela, - por e lashë ngase e mendova punë burrash.

- Mirë ke bërë, - ia pat ai disi i mikluar. - Burrave u rëndojnë ca gjëra më shumë.

U nis të dilte, por në çast u kujtua për kalin, që duhej mbathur. Atëherë ndaloi, u kthye nga e shoqja e dha porosi t'i bënte gati veglat.

- Kthehem shpejt, - tha Geg Alia si të deshte ta qetësonte. - Nëse do ta gjej do ta vras. Por nuk besoj të ketë ndonjë ujk të sëmurë në arën tonë.

Dhjetë minuta më pas, Margjela dëgjoi lehjet e tërbuara të qenit dhe priti krismën habertare të armës, por asnjë e shtënë s'u dëgjua. E ndjeu të shoqin që u kthye nga përplasja e portës që u mbyll si dhe nga kërcitja e llozit. Që nga brenda, gruaja i ndezi atij dritën e oborrit. Pastaj iu avit dritares dhe nisi t'i ndiqte lëvizjet. E pa të endej një copë herë si të deshte të kërkonte diçka të humbur. Ndërsa qeni vazhdonte të lihte e angullinte duke ardhur rrotull tij, ai ia hoqi armës fishekun nga goja, e mbështeti pas murit të avllisë dhe filloi të mblidhte litarët për apllagut të samarit. Ndërkohë Margjela u kujtua se i kish bërë gati veglat: një palë darë të mëdha, çekiçin,

një thikë të mprehtë kose si dhe kutinë e kartonit me thumbat. Doli në oborr me veglat në duar. Ia la burrit në dorë dhe pyeti:

- Nuk e gjete?

- Jo, - tha burri pa e vështruar. - Kërkova gjithandej nëpër arë, por nuk pashë kurrfar ujku. Nëse s'të kanë bërë sytë, është larguar. Ujqërit kurrë s'rrinë në një vend.

Ajo ia nguli vështrimin gjithë dyshim. Por ai i ktheu asaj kurrizin, dhe, si një mjeshtër i përngeshëm, u përkul të përthyste këmbën e kalit. Tevona e urdhëroi gruan të hynte në shtëpi.

Margjelës i ngriu në majë të buzës pikëpyetja për qenin, që pak më parë kish lehur me tërbim. Hyri brenda me mendjen top që i shoqi e kishte gënjyer.

Kur u kthye, Geg Alia e kish mbathur kalin. I hodhi veglat në surdinën e hapur dhe e mbylli kapakun me këmbë. Pastaj kyçi armën brenda në dollap, piu ashtu siç që pa u ulur lëngun e barit të egër, dhe së fundi, i kërkoi gruas një copë bukë.

- E dua për qenin, - shpjegoi ai me një zë të pasigurtë duke rrotulluar sytë disi me përhumbje.

- S'ka më, - tha ajo. - Kam zënë brumin dhe nesër me të zbardhur do ta pjek.

- Atëherë më jep pak brumë, - ngulmoi burri.

Ajo vajti dhe ngriti kapakun e një kove të madhe kauçuku, futi dorën, nxori prej aty një dorë të mirë brumë dhe e hodhi në një tas të vjetër bote. Vetëm pas disa minutash, Margjela u kujtua, që e pati ushqyer qenin dy orë para se i shoqi të kthehej nga mali. Deshi t'ia thoshte, por kur doli në oborr, nuk e gjeti të shoqin aty. Ajo vuri re, që qeni flinte i kruspullosur rreth vetes, lidhur me zinxhir në qoshen e tij. Kurse fleta e portës së madhe të avllisë ndodhej gjysëm e hapur!



Të nesërmen, ai u ngrit andej nga ora gjashtë e mëngjesit, duke lënë në shtrat një duhmë kafshe të egër. Tha se lëngu i fierit të gurit i kish bërë mirë. I qe shushatur disi dhimbja në veshka dhe shpalli se kish vendosur të mos shkonte t'i blinte ilaçet.

- Si të duash, - tha gruaja, - Nëse ndjehesh më mirë, mos shko. Mund ta vazhdosh kurën me lëngun e fierit të gurit derisa të shërohesh.

Pastaj shtoi se meqë ishin të dy në shtëpi, do të qe e arsyeshme të nisin nga korra. Por ai ia ktheu se nuk do të korrnim edhe për dy javë të tjera!

- E di çfarë?! - Ia bëri pas pak ai në beft si të kish gjetur çelësin e një enigme. - Kësaj here do ta vjelim misrin në këmbë. Kështu është më mirë: nuk do na duhet as të korrnim, as të lidhim dhe as të ngrehim kashtare.

Ajo e pa shtrembër, athua se i shoqi kish nisur t'i kurdisë një rreng të pabesë.

- Mos më shiko ashtu, - e qortoi ai. - Të ka mbërthyer paniku kot së koti. Unë shkoj në mal gati çdo ditë... E bëj këtë, që prej njëzetë e pesë vjetësh dhe ende s'kam parë ndonjë ujk. Kurse ty të fanitet egërsira në prag të shtëpisë!

- Mirë, - u dorëzua ajo. - Bëj si të duash. Veçse s'më vjen mirë të më hedhin hi syve, ta dish.

Dhjetë ditë rresht, burri qëndroi në shtëpi. Piu lëng fieri të zier dhe u kujdes për arën e tij me misër të pakorrur. Mëngjesin e ditës së njëmbëdhjetë, gruaja doli në oborr dhe konstatoi se qeni nuk ndodhej aty. Porta e madhe e oborrit kish qenë e hapur. Më kot e ndolli, që t'i vinte, më kot priti t'i dëgjonte të lehurën. Atëherë hyri në shtëpi me teftik, dhe, duke u dridhur nga frika e zemërimi, kokërrndërsy iu hakërrye të shoqit:

- Ma gjej qenin, - i tha me një zë, që iu shkith në grykë.

Geg Alia hoqi kapelen, kruajti kokën me strehëzën e saj dhe ra në mendime të thella.

E tërbuar prej zemërimit, ajo vajti me nxitim te dollapi i futur në mur, rrëmbeu armën, i rراسi fishekun në gojë dhe doli në anën e prapme të shtëpisë ku gjendej ara me misrin ende të pakorrur. I ra turravrap mes për mes si një trimëreshë, me shpresën se do ta gjente egërsirën mbi kockat e përgjakura të qenit. Por nuk gjeti asgjë prej gjëje, përveçse një vendine me misër të rrëzuar rrafsh me tokën, ku i zunë sytë atë tasin e vjetër të botës, në të cilin, ditë më parë, ajo pati futur brumin e bukës, që i shoqi të ushqente qenin e shtëpisë.

*Kastriot, vjeshtë, 1994*

## Plagë Lulezonje

Vite më parë, ndërsa bëja një gjumë të rëndë, pashë në ëndërr Mirgjina Didilin: u dha në kopështin tim në një orë të pasdrekës kur ajri dukej sikur avullonte e gjinkalla çmendej mbi drurë. Sapo kisha kositur barin dhe po përpiqesha të ujisja tokën me pantallonat e përveshura gjer në gjunjë e me një këmishë pupline të lehtë në trup.

Duke ngritur me njëren dorë cepin e fustanit të saj të kaltër, Mirgjina kërceu gardhin, shkeli lehtësisht mbi qilimin e blertë dalëboje të barit të kositur përgjatë koridorit me dardhë dhe ndaloi fare pranë meje. Tamam si të qe një flutur e lodhur nga vjeshta e vonë.

Tani, shpesh mallkoj veten: përse nuk i dhashë rëndësi asaj të qeshure hakmarrëse, që ato çaste i pushonte mbi buzën e poshtëme; mbi buzën si disku i hollë i një hëne të vrerosur, që vetëm një vajze fshati si ajo mund t'i shkojë. E pata dashur Mirgjina Didilin qysh në kohën kur qe një fëmijë i rritur pa asnjë mëkat, dhe, asnjëherë nuk pata dyshuar për pastërtinë e mardhënieve tona. Mendimi i ngulitur se isha në ëndërr më çarmatosi totalisht dhe solli kështu, një pasojë katastrofale që do ta rrëfej më poshtë. Si më përshëndeti thjeshtë,

zuri vend mbi një trumbë bari të kositur; ngadalë e gjithë kujdes, e bukur dhe e hirshme athua se kish frikë se mos bjerrej nga kujtesa ime. Lëkura e fytyrës së saj-bronx i çelët, sytë-shpuzë e gjallë, më të bukur nga ata të atëherëshmit; ndërsa flokët e shpupuritur, - në ngjyrën e një gështenje të njomë. Mbi fustan, ajo mbante veshur një triko me pikëla ngjyrë kafe në të errët. Tamam një gjarpërushë që shullehej e qetë me sigurinë që të fal thumbi helmatisës.

Qemë rritur bashkë dhe verimet, para se të shkelnim pragun e adoleshencës, i patëm kaluar majë bjeshkëve të Korabit ku prindërit tanë ngrinin stanet. Aso kohe, unë mblidhja luleshtrydhe, i vendosja mbi llapusha të mëdha dhe ia dhuroja Mirgjinës. Ia dhuroja me një bujari që ajo s'ka për ta gjetur kurrë më. I bëja edhe vargje: i shkoja kokërrat me kujdes në një fije të gjatë bari dhe ia vendosja gjerdan rreth gushës.

Një ditë, - më kujtohet si sot, - Mirgjina erdhi tek unë disi e tjetërsojtë. Mezi e njoha. Kishte bërë tualet duke i lyer buzët me lëngun e luleshtrydheve. Mbi flokë kish vendosur një kurorë lulezonje. Ndërsa më vështronte në mënyrë të çuditëshme, qante para meje si të kishte qenë e detyruar të vendoste për një gjë, që ajo vetë, kurrsesi nuk kish dashur ta bënte. Në vitet që rrodhën, do të kuptoja, që loja mes meje dhe Mirgjina Didilit, kishte ngecur në një pikë mjaft kritike, kuptimin e së cilës, aso kohe s'kisha mundur ta rrokja dot.

Dhe ja, përsëri, gati pas njëzetë vjetësh, ajo erdhi në ëndërrën time me një buzëqeshje hakmarrëse në buzë. Por lotët tashmë i qenë tharë dhe në sytë i buronte një vështrim i rreptë. Qëndroi e ulur aty për një kohë të gjatë pa thënë asnjë fjalë, derisa zbriti brenda meje ai fëmija bredharak i livadheve. Atëherë i thashë:

- Sa mirë bërë që erdhe Mirgjina! Pothuaj të kisha harruar... Hajde lozim si dikur...

- Lozim, - ma ktheu ajo disi me hakërrim. Dhe si nxorri prej dikah një thikë të mprehtë, me lëvizje të shpejta të dorës, më hapi në kraharor një plagë në formë lulezonje. Gjithshka e kreu me shpejtësinë e vetëtimës. Pastaj u largua qetësisht, pa e kthyer asnjëherë kokën prapa, duke më lënë të përpëlitesha përmes dhimbjesh.

E pashë kur mbërriti në rrethinën e fundit të kopështit: kapi me kujdes kindin e fustanit të saj të kaltër, kërceu gardhin dhe humbi prapa shelgjeve, degët e të cilëve, vareshin anës rrugës si krifa kuajsh në radhë.

Kur u zgjova, mendimi se gjithshka pati ndodhur në ëndërr më lehtësoi disi, por dhimbja nuk më kishte shterur. Ndërsa preka me dorë kraharorin, vura re se këmisha vërtet qe prerë me thikë, ndërsa në gjoks kisha plagën në formë lulezonje.

Çdo ditë, duke filluar që nga ajo kohë, e mira ime shoqe, më ndërron rregullisht fashot mbi plagë.

*Tiranë, vjeshtë, 1998*

## Një histori dembelësh

Dembelë të mëdhenj këta djemtë e kovaçit Nesim! Më të mëdhenj se i ati i tyre.

E shkojnë mëngjesin duke u sjellë nëpër shtëpi gjithë plogështi si kërminjtë, hap e mbyll kanatin e raftit të bukës; duke lëvizur radion stacion më stacion e duke kënduar nën zë këngët që dëgjojnë aty.

Kur dielli në lindje ngrihet dy pash mbi majën e malit, njëri pas tjetrit, dalin që të tre në kopësht. Ulen në bar dhe për orë të tëra, ngrohen në diell e luajnë me letra mbi një kuti kartoni të kthyer përmbys. Shajnë qeverinë si dhe nuk lënë fjalë pa thënë kundër nëpunësit të zyrës së asistencës, që nuk dëshiron t'u japë ndihmë në para e ushqime. Së fundi, ngrihen secili duke u ankuar se i ka bërë hile tjetrit gjatë lojës, i bien kopështit qark një shëtitje, sodisin fidanët e pemëve të sapombjellë e duke fërkuar duart gjithë kënaqësi, i thonë njëri - tjetrit:

- Eh...! Kur të na bëhen mollët!

- Eh...! Kur të na rritet qershia!

- Eh...! Kur të vjelim dardhat!

Pastaj që të tre, futen me yrish brenda për të ngrënë bukë, sepse gruaja e babait, njerka torollake, tashmë duhet ta ketë bërë

gati drekën.

Kur hyjnë në shtëpi marrin vesh, që gjella ende nuk është zier. Madje as buka nuk qenka pjekur dhe as enët s' qenkan larë. Atëherë nisin e i shfryjnë njerksës, kësaj gruaje të mjerë, që u martua me një burrë të ve me tre djem si zdapa, dembelë e të pazotë për të kryer ndonjë punë.

Me një shami të lyrosur në kokë, e lodhur tej mase nga rrahjet e përditëshme të të shoqit, kësaj budallaqeje nga trutë e kokës, natyra i ka mveshur edhe një huq të keq: maninë e kundërshtimit në çdo gjë.

Dhe si të duan t' i hedhin benzinë zjarrit, tre vëllezërit dembelë, që mjerimi i ka kapur për sysh, flasin me njëri-tjetrin si t' i ketë gjet belaja: ankohen e bërtasin, ngarkojnë me faj të shkretën, i rrijnë gjithë hundë e buzë pse nuk gjejnë ç' të hanë. Ajo, i dëgjon e heshtur, me një mllef që i grumbullohet ngadalë në grykë. Si të dojë të shfryjë pezmin e saj, jep e merr gjithë rrapëllimë duke gërvishtur me një rrjetë teli të vjetër tiganët dhe tenxheret e nxira. Por djemtë dembelë të burrit vazhdojnë avazin e tyre: pyesin njëri-tjetrin të habitur, si është e mundur vallë, që ato kanë bërë njëzetekatër lojë rradhazi me letra, i kanë rënë kopështit gjith ato herë shëtitje rreth e qark duke soditur pemët dhe gjella ende nuk është zier!

Si të mos e besojnë një fakt të tillë, që të tre, njëri pas tjetrit, shkojnë e ngrejnë kapakun e ftohtë të tenxheres. Sytë u shohin disa lëvore të lehta qepe të grirë, të cilat, qëndrojnë pezull mbi ujin, që ende s' ka marrë valë. Duken si krimba drurësh të kalbur këto lëvore qepe; ndërsa atje poshtë, në fund të tenxheres, kokrrat e paziera të orizit, si vezë të bardha milingonash.

Dalin sërish jashtë duke turfulluar me vete pa ia vënë veshin fjalëve të njerksës që i shan nga prapa, u bërtet e u thotë me një zë të marrur, të mos rrijnë si dembelët, por, nëse duan të hanë, të shkojnë e të gjejnë ndonjë dru të thatë për shporetin e fikur.

Andej nga ora dy ia beh i zoti i shtëpisë. Edhe ky avdall mbi avdallët; me rrobat e vjetra dhe të pista tërë vrima të vogla, të djegura nga shkrepëtimat e qymyrit të ndezur kur ai i fryn me shakull për të skuqur hekurin, që i duhet ta rrahë e punojë me një çekiç të rëndë; me fytyrën e nxirë e duart gjithë dhoga, duar përtaçe me vraga të moçme plagësh të marra nga mungesa e vëmendjes në punë; me vetullat e trasha e të zeza mbi bebëzat xixëlluese, që shkëlqejnë pranë trekëndëshit të vogël, të bardhë, plot damarë të hollë e të kuq. Sy që shprehin një lakmi të fshehtë si dhe një mendim prej pushti.

Ky hamës i madh e mendjeshkurtër, qysh para dy vjetësh, ua shiti lirë katundarëve të tij gjithë tokën që kishte. Që nga ajo kohë, bashkë me djemtë përtaçë si ligavecët, u nginj rreth sofrave të panumërta që mbusheshin çdo ditë plot e përplot me mish të pjekur, të blerë në dyqan nga më i shtrenjti derisa paratë u sosën. Tashmë nuk ka mbetur asnjë qindarkë në kuletë dhe dollapi i ushqimeve pothuaj është zbrazur. Gjithsesi, për çudi, kovaçit Nesim, ende nuk i është bjerrur shpresa. Pasi ulet në një divan të sajuar me rrypa llastiku, të nxjerrë nga komerdaret e prera, të mbuluar përsipër me një copëz damasku të vjetër e të lyrosur, i drejtohet të shoqes e i thotë:

- Gëzohu moj grua: më në fund edhe ne do të bëhemi të pasur.

Gruaja e shkurtër, që ka hypur mbi një shkam dhe zgjatet me zoritje për të vendosur një tenxhere mbi një dollap buke, që mezi mbahet në tre këmbë të kalbura nga lagështira, kthehet nga i shoqi dhe e çuditur pyet:

- Si do të bëhemi të pasur more burrë?! Ne nuk kemi asgjë më për të shitur.

- Do të bëj shumë thumba, - nis të shpjegojë me gjallëri ai. - Thumba për kuajt, mushkat dhe gomerët. Do të bëj pesëdhjetëmijë thumba, kupton ti...? Pastaj thumbat do ti shes.



- Po pastaj?! - pyet gruaja budallaçkë, ndërsa ka zbritur nga shkambi dhe përpiqet të rregullojë mirë shaminë e kokës, që i ka rrëshqitur.

- Pastaj, me lekët që do të marr nga shitja e këtyre thumbave do të blej katër lopë, të cilat, do të pjellin viça. Viçat do të rriten e do të bëhen lopë. Kështu, për pesë vjet, do të kem rreth katërmbëdhjetë lopë si dhe viçat, të cilët, sërish do të bëhen lopë e do të pjellin viça; dhe sërish viçat do të bëhen lopë...

Por budallaqja e shkretë e ndërpret. Kërkon të dijë sa lopë ka ndërmend të mbajë i shoqi, sepse gjithë ato lopë...! Po bëhen pak si shumë dhe duhen njerëz për t'u ardhur rrotull.

- Të paktën tridhjetë, - thotë hekurpunuesi dhe e vështron në mënyrë triumfale me ato bebëzat e tij të zjarrtë si thëngjilli në fytyrën e palarë.

- Mirëpo... - ia bën ajo duke shtrënguar buzët e holla e duke picërryer sytë sepse sapo ka futur në gojë një hoshaf të thartë kumbulle. Dhe duke u përtypur, kërcen përnjëherësh nga shtysa e një mendimi të rrahur mirë në kokë dhe pyet: - Po lopët kush ka për ti mjelë?

- Si fillim, do t'i mjelësh ti, - ia pret shkurt kovaçi Nesim.

- Jo, unë nuk i mjel, - kundërshton menjëherë e vendosur ajo.

- Pse, si mendon ti...? Unë, që do të bëj gjithë atë punë me thumbat, të mjel edhe lopët?!

Dhe sytë e Nesimit nisin të shkrepëtijnë nga reflekset që shkaktojnë rruazat e shkumëzuara të një gjaku të shprishur. Balli i mrrolet, i ngrihet aty një damar si rrënjë shqope, ndërsa herë pas here pështyn majtas e djathtas mbi dyshtemenë prej balte të rrahur.

- Bëhet fjalë për tridhjetë lopë, ej! - nis avazin e shoqja budallaçkë. - Si mund të mjel unë kaq lopë?!

- Kundërshton?! Atëherë po të zhdëp në dru - thotë i nxehur kovaçi Nesim. Dhe si rrëmben mashën, nis t'i bjerë kurrizit.

E shoqja ia jep një britme, që mbërrin gjer në veshët e djemve halabakë e përtacë të burrit, të cilët, vrapojnë për të parë atë skenë, që nuk është e para. Kur futen në shtëpi, e gjejnë të atin në dhomë duke shfryrë si një bishë e egërsuar mbi njerken, që është strukur e bërë si lëmsh i vogël në një qoshe.

- Shkoni thirrni policinë, të vijnë ta marrin lugatin...! Shkoni ju vraftë zoti, ju vraftë! - lutet e urdhëron njëherësh duke u çjerrë me zë të lartë njerka.

- Përse e rrahe baba? - pyet më i madhi duke u zgërdhirë.

- Ke parë ti?! - i drejtohet ai të birit gjithë habi e zemërim. - Kërkon të na bëhet zonjë e madhe, kjo! Nuk do, që të mjelë lopët!

- Çfarë lopësh, baba...?! Ne s'kemi lopët!

- Lopët, që do të blej.

- Me çfarë do t'i blesh?

- Me paratë e thumbave, karabush!

- Ku janë thumbat?

- E shikoj, që edhe ti nuk merrke vesh, prandaj po të zhdëp edhe ty në dru, - thotë i nxehur më tepër kovaçi Nesim. Dhe sulet ta kapë.

Djali avdall, del me vrap jashtë dhe nis të sillet rrotull shtëpisë përdhese, duke kthyer koken prapa gjithë vemëndje; dhe, kur shikon që i ati ka ndaluar, ndalon edhe ai i fshehur tek qoshja e murit. Aty, nxjerr kokën dhe e vështron të atin si brac, ndërsa zgërdhiet si idiot me dy vëllezërit e tij.

Kjo e inatos më shumë kovaçin Nesim, i cili, për t'i kapur e për t'i zhdëpur në dru të bijtë, ndërron taktikë: duke ecur ngadalë drejt tyre, nis t'u flasë me zë të butë, u bën thirrje të tregohen të arsyeshëm, të mos tallen me të, të paktën ata dy të tjerët, sepse në fund të fundit, ai për ata do t'i blinte lopët. Por pjellat e tij ia

njohin rradaken. Ecin mbrapsht për të ruajtur distancën. Dhe, kur sërish dëgjojnë thirrjet vajtuese të njerks budallaçkë, që u lutet të shkojnë të denancojnë në polici, ata e marrin këtë ngjarje si një lojë zbavitëse. Përpiqen të imitojnë britmat e saj dhe shkrihen së qeshuri.

Kur kovaçi Nesim shikon që nuk mund t'i shtjerë në dorë për t'i rrahur paq të bijtë, kthehet tek e shoqja dhe nis ta qetësojë. I thotë:

- Pusho, budallaçkë, mos qaj! Ja, po e lëmë ashtu si do ti. Do të gjejmë një shërbyese, që t'i mjelë lopët.

*Kastriot, verë, 1993*

## Frika

Kur barbarët e huaj u dhanë në portën e madhe të oborrit të Lef Kukës, ky i fundit, doli nga dera e pasme dhe arriti të futej e të fshihej në qilar.

Qilari, qe ndërtuar ngjit me ahurin e bagëtive dhe hyrjen e kishte disi sekret. Kur hapej dera e ahurit, fleta e derës, bllokonte atë të qilarit.

Për të hyrë në qilar, duhej të hyje piksëpari në ahur, pastaj të mbyllje derën. Por, edhe atëherë, për njerëz që nuk e dinin, qe vështirë ta gjenin hyrjen, pasi brenda ishte gjithmonë errësirë e plotë. Për ta mbrojtur ahurin nga hajdutët, dy dritaret qenë zënë me plitharë, dhe, nëse dera ishte e mbyllur, asnjë rreze drite nuk depërtonte aty brenda.

Lef Kuka, u struk i fshehur në qoshen më të errët, prapa një vozi vere. Sipër vozit, gjendej lëkura e tharë e një lepuri të madh, të cilin, ai, e pati vrarë vite të shkuara. Aso kohe, - kishte qenë e premtë si sot, - ai qe kthyer nga kodrinat me gjahun mbi sup, e kishte ulur në tokë mu në sheshin e katundit dhe ua kishte treguar të gjithëve sa u ndodhen aty, duke demonstruar një krenari prej gjuetari me

zotësi të madhe. Dhe kishte hak: askush në katund, nuk pati mundur të vriste një lepur aq të madh sa ai që vrau Lefi.

Tashmë, i fshehur prapa vozit, ia ndjeu asaj lëkure erën e gjakut të tharë dhe i erdhi për të vjellë. Kurse nga jashtë, atij i kapi veshi britmat e çjerra të Danjushës, nuses së vëllait, para së cilës, barbarët shkonin në thikë të shoqin e saj, Gjegjën, - vëllain e vogël të Lefit.

- Jam në vatanin tim..., - u thoshte Gjegja të huajve, - Në shtëpinë time....

Në vend që të dilte, Lefi u rras edhe më tepër në skutën e errët dhe ra në një gabim fatal, për të cilin, jo në këtë jetë, por në atë tjetrën, do të pendohej rëndë: iu lut Zotit, që të mos hapej dera e qilarit.

Pastaj, zëri i të vëllait erdh' e u shua derisa shpirti i tij u ngrit në qiell.

Atë çast, dikush e pështyu në kokë Lefin.

Kur ktheu sytë lart të shikonte kush qëndronte mbi trarët e tavanit, një tjetër pështymë i ra në futurë.

Jashtë binte shi dhe çatia pikonte.

Baptima e hapave të një njeriu, që afrohej drejt ahurit, teksa tërhiqte zhakthi një tjetër, e bëri Lefin, t'i rrihte më fort zemra. Pastaj, kur dera e ahurit u hap duke bllokuar atë të qilarit, ai ndjeu dihatjen e rëndë të një mashkulli, kërcënimet e tij në gjuhë të huaj si dhe të qarën e mbytur të Danjushës, teksa i lutej tjetrit, që për hatër të zotit, ta falte.

Vetëm një metër larg, matanë murit që i ndante, i huaj, shfryu gjer në fund epshin e tij mbi nusen e të vëllait.

Lef Kukës, erdh' e iu rëndua aq fort zemra, sa iu bë si gur i thyer varri. Kurse frika, gjithnjë e më tepër, si një merimangë e madhe skutash të errëta, vazhdonte ta mbështillte me fije të holla e të forta, derisa ai, e pa vehten të mbyllur si krimbi brenda pezhishkës.

Pastaj, barbarët i nxorrën nga ahuri të gjitha bagëtitë: kalin, dy qetë, lopën si dhe tufën e deleve.

Pak nga pak, zërat e tyre urdhërues dhe klithmat e banorëve të pafajshëm erdhën duke u fashitur. Atëherë, atij iu ndez një shpresë, që Zoti, vërtet ia kishte dëgjuar lutjen dhe dera e qilarit nuk do të hapej.

Kur nata iku bashkë me tmerret, ia behu mëngjezi. I paqtë e me një diell të shndritshëm, që i bëri gjallesat të zhurmonin hareshëm. Jeta gëloi natyrshëm si rrjedha e një uji të ëmbël, që del nga nëntoka për t'iu kthyer edhe njëherë bimësisë nga rrënja në gjethe.

Lef Kuka, provoi të lëvizte, por, kurrësesi, nuk mundi. Nuk kishte as këmbë, as dorë, madje as edhe një muskul në trup, që të mund ta vinte në lëvizje.

Sa shumë deshi atë botë Lef Kuka, që të vinin ta gjenin.

Kushedi sa herë, ai dëgjoi hapa dhe zëra njerëzish që i njihte. Madje në një rast, ata hynë edhe në ahur për të parë mos kishte mbetur aty ndonjë kokë bagëti, por, as që e morën mundimin për të hapur derën që të fuste në qilar.

Brenda pezhishkës, i dërrmuar shpirtërisht, atij iu pak aq shumë fryma, sa nuk mundi të nxirrte as edhe një tingull nga goja.

Dhe, kur koha rrodhi e zërat erdhën duke u dëgjuar gjithnjë rrallë e më rrallë, vetëm atëherë, ai u kujtua, që i ishte lutur Zotit, të mos hapej ajo derë.

Dhe mbylli sytë që të vdiste.

*NewYork, vjeshtë, 2007*

## Rrëfimi i bariut

Unë e di, o Bajazit vllau, se nuk do të di ta shkruaj këtë histori, sepse nuk jam asi kalemxhiu me shkollë. Por meqense ti je larg e m'u lute, të ta kallzoja me të shkrueme, po e provoj njiherë. Të dalë ku të dalë! Veç, të lutem, o Bajazit, sikur t' mos ia dal dot mban ta krrell ashtu si duhet, mos m'tall, mos m'qesh e mos ia jep askujt ta lexojë. Po e baj meqë ti tash je larg e t'ka pik malli për at' kohë vigjence; për kooperativën, katundin, për stallat, bokat, zabelet, brrakat e rrafshet ku kullosnim bashkë tufat me berrat e kooperativës. Pra, meqë ta ka qejfi të ta kallzoj me t'shkrue me, unë po e shkruaj, veç siç të thashë, pash Zotin, n'besën tane, vetëm unë e ti e asnji tjetër!

A t' kujtohet Prroi i Xhetës, ku verës, e zinin ujini me gurë e plisa dhe lanim vapës n'hurdhë berrat e kooperativës, që na e binin n'maj t'hunës duke u hequn rrodhet e rriçnat? Bash aty, o Bajazit, e takova at' burrin jabanxhi. Kisha mërthye cjapin varroz për brinash e po i hiqja nji nga nji rriçnat e rrodhet e ngjituna n'lesh, kur pash, që bagëtia ia mathi menjherë e tremun.

Aso kohe, ti e di që neve barinjve, pushteti na sugjeronte të tregoheshim, si i thonë, vigjilentë. Mund t'shkelej kufini, të

dilnin tradhtarë jashtë, të hynin diversantë mrena, t'na përmynsin pushtetin tonë popullor e ku di un çfar tjetër.

Kur e pashë, o Bajazit, at' burrin t'veshun spic, me çantë ushtarake n'shpinë, menja m'shkoi ke ndonji i huej, që mund t'kish ardhë prej anej kah jugu për t'ça ferrën. M'përshneti njerzisht e manej m'pyeti nëse kish dyqan katuni ynë. Un' i thashë se kishim dyqan ku mund t'blije, krip, vaj, sheqer e ç'të të dojë e bardha zemër. U duk se u gzue. Tha se donte t'blinte vetëm një paketë cigare, e noshta, edhe noj gurabi. Bëmë një cop herë muhabet bashkë: m'pyeti sa berra kisha gjithsej, (a thue se qenë t'mijtë), pastaj ec e ec, e duke m'kqyr si dhelbën dinake e nxorri fjalën ke posta e kufinit. Dontë t'dinte sa ushtarë kishte posta, sa kapterra, sa oficera dhe sa larg gjendej ajo prej aty ku ndodheshim ne! E nxorri kokën qafiri! - thashë me vete. T'them t'drejtnë, o Bajazit vllau, m'rrahu zemra n'krahanor si trokëllimë mullini. Menjherë m'shkoi menja se m'kish zanë kadderri, se m'kish ra n'dor një armik i pushtetit tonë popullor ene nuk dija ç'të baj me të. Menova: po t'arrij ta mërthej kët' edëpsëz, pushteti do t'më marrë n'sy t'mirë, do m'japë dekorat t'naltë, ene pse jo, noshta edhe mund t'më dërgojë t'shikoj falas Muzeun Komtar. Por ajo që nuk m'u shqit trushë, qe, se mund t'më banin skuadërkomanant t'brigadës s'arave. Merre me men sa qejf i madh do t'ishte, sikur unë, o Bajazit, prej bari dhishë, t'u jepja urdhën grave t'Bibollit! Ti bija çangës s'katundit n'pik të mëngjesit, t'i vija gratë n'rresht si pula t'fjetuna e t'i urdhnoja. Eh, mor Bajazit vllau! Feja vetë do t'ishte! Vetëm njiherë t'kisha mujt me dhanë urdhna n'jetë e le t'vdisja. Pastaj t'hakmerresha me at' bullicën e Bexhetit, që sa herë m'kqyr, për t'u tallun me mue, qesh e m'pyet: "A i kullote berrat, o berr i allahut?"

Unë e di se ajo m'tall pse zoti m'la gjithëherë me berra, pse nuk pata fat t'martohem, t'marr ndonji nuse si t'gjithë të tjerët; a



noshta m'tall edhe pse sa herë e kam hasun, ia kam shti sytë gjigjë dhe e kam shpu tejpertej. T'kam thanë, o Bajazit, veç po nuk e shtiva n'dorë, t'ia hyp n'ato vithe krekcare, pa do ta mjel për cicash si një lopë qumshtore...

Që ta pata llafin, o Bajazit vllau, ky jabanxhiu, erdh' me mue gjer n'katun. Gjatë gjith' udhës nuk çeli gojë. Vetëm njëherë m'kërkoj një cigare, por ti e di që unë e pi gërgjall t'keq, bile me të dredhun, dhe, ngase nuk dinte ta dridhte vet' edëpsëzi, ia drodha unë një t'shtremt. Manej ene ia neza, dhe, kur e thithi, pshtyu belaziu e tha:

- Ky duhan mbytkë edhe gomarin!

A thua se un', që e pija gjithmon të tillë nga halli e mërzia, isha ma keq se një gomar. Nuk i fola. Thashë me vete: e kërkove? Pije tash, ta zant gurmazin, ta zant! Për mue nuk kish pik dyshimi, bile m'qe mushun menja top se kisha t'baj me një diversant, por kisha frikë, o Bajazit vllau, se për aq kohë sa do t'më duhej mue t'lija berrat n'rrugë e t'hyja n'shpi për t'marrë pushkën, ai do t'kish hy n'dyqan e aty, do ta kish ba zap dyqanxhiu e do ma kish marrë.

Sa lash berrat n'rrugë afër stallës, ia dhashë vrapit me teftik e drejt e n'shpi.

Nana eme, që ishte prej dy javësh zaif n'shtrat, kur m'pa që nxitoja, u trem e gati i ra t'fikt.

- Ç'ka nodhun, bre bir?!- pyeti ajo që nga shtrati.

- E gjeta, - gjegja unë, - por m'duket se do ma marrë ai hunderri i dyqanit, Baloshi.

- Shyqyr bre bir, që ma n'fun e gjete ene ti kismetin tan! - ia bani ajo sepse kujtoi se kisha gjet nuse. Bani me gisht si të deshte t'më qortonte e shtoi: - A e shef, si ta zgidhi fatin ajo nuska, që ta shkrova ke hoxhë Kupa?!

Prej qejfit t'madh, i ranë rrotaqeles trutë n'qafë!

U ngrit e me lot n'sy deshi t'më përqafonte, por nuk e mbajtën

kamët, iu morën mentë e shkoj e u gremis me byth drejt e n'votër t'zjarmit. Fat i madh, o Bajazit vllau, qi zjarrmi nuk qe nezun se do ish djegun krejt e shkreta. E ngrita vrik e i thashë:

- Jo nuse moj nan', gjeta diversant, por m'le rehat tash se do ma marr hunderri! Dhe sa hap e myll syt, rroka gjermanen që e maja t'varun në një kunj t'ngulun n'mur, i rrasa fishekun n'gojë, dhe kur dola jashtë, për bela, sikur ta dija, pashë, që diversantin ma kish vu para me pushkën e vet dyqanxhiu Balosh Losha! Hunderri! T'them t'drejtën, o Bajazit vllau, m' hypën rrebet. Mu errën syt e nuk dija me e da, cili prej tyne qe diversanti, e cili dyqanxhiu.

Vuna pushkën për syni e brita aq fort sa rrezik e nigjun edhe ata shokët e partisë atje nalt n'komitet:

- Naaaaal!

Ngrinë n'ven të dy. E unë, duke i pa përmes një reje amzash e kacabujsh t'vegjël, i bërtita prap dyqanxhiut e i thashë që t'ikte, t'shifte punt e dyqanit me kapistrat e voet e prishme që shiste hunderri, sepse hala nuk kish le n'Biboll ai bir nane, që mun t'merrte diversantin tem. Ti nuk do ta besosh o Bajazit, si u ba beterr Baloshi! Deshti t'thoshte njëherë, se e kish kapun vet diversantin, por i iku goja e u ba memec si gur shtufi. Vu bishtin nër shalë, u përvodh si skile mas qoshit t'murit, theu qafën e iku. At'herë i fola diversantit; i dhashë urdhën t'hidhte menjëherë n'tokë t'gjitha armët: bombat, fishekt, patllaket, thikat, helmet kimike, kutitë me bakterje vdekjepruse, t'gjitha ç'menoja unë se kishte ai nat çantën e tij ushtarake. Eh, mor Bajazit vllau! M'vrafshin shtatë teqe e m'rafshin n'krye rrufetë e qiellit në t'rrefsha një gjysëm fjale! I kishte ngritun diversanti durt nalt e m'vështrote njilloj si ai braci fakirfukara kur e kapin tu kputun nonji kok moll n'kopësht t'huj.

Me urdhnin tem t'rreptë, ai nxorri e hodhi një nga një në tokë t'gjitha senet që kish n'çant. Por, ç'të t'them, o Bajazit vllau?! Nuk

kish pasun me vete asnji lloj arme a municioni, qafiri, përveç një broshure me direktivat e pleniumit të tetë t'partis, një faqore me raki kumlle, një shami t'pist hunsh si dhe një cop byrek t'mshtjell me gazetë, të cilën, kur kjo histori pat sosun, m'duket se e përblau ajo bullica e Bexhetit. At'her menova se do t'kish mshehun nonji sen n'trup e i dhash urdhën t'zhvishej, por ja që ia behu aty kryetari Brahim bashkë me Balosh Loshën e un' e harrova at' punën e zhveshjes.

Skilja! Kish shku me vrap e kish lajmëru kryetarin Brahim! I kish thanë se kishte kap vetë një diversant, por medemek, ia kisha përvetsue unë pa t'drejtë!

- Për pak u vramë, mor shoku Brahim, - thoshte ai, i çuditun e i pezmatuem njisherësh, - Dhe për çfarë?! Për një palo-diversant, që në t'vërtetë e kapa unë!

Thashë me vete: u ba ky hunderr me marrë hazërllup diversantin tem?! Unë e pruna n'Biboll, që nga Përroi i Xhetës, kurse ai na e donte hazërllup! Menoje vet kët punë o Bajazit vllau! Edhe t'na dekorohet nga pushteti popullor, ta çonin t'shifte falas ene Muzeun Komtar e ku di unë çfar tjetër...!

Kulmi!

M'hypën rrebet n'tepe t'kresë, mu çue delli, ia futa dyqanxhiut me një grusht hunve, që Zoti m'faltë, dhe e plandosa me turinj në një hurdh' uji. Kur u ngrit, kishte hum kujtesën, zavalli. Nuk dinte as ku ishte, as çfarë i kish nodhun. N'ven që t'futej n'shpi t'vet, shkoi zavalli e u fut n'stallën ku mante deshtë Mud Mahmuti.

U dha berihaja e u mor vesh në marë Bibollin se kisha zan rob një diversant! U dynën ke sheshi para dyqanit shumë njerëz, mes t'cilëve, siç thashë, nodhej ene bullica e Bexhetit. Ajo pallavozja u shkri s'qeshunit, me cicat, që i hovnin hava. Qeshte, zgjaste kokën si brace kah un' ene tinës t'tjerëve, duke ba shenjë me dy gishtat e

gjilpanës, me t'tallun thoshte:

- Bravo, o berri i Allahut! Na e kape një plesht!

Pse e bante ajo ktë, vetëm një zot e di. Mbase do ta marr vesh kur ta shti n'dor e ta mjel për cicash... Sepse e shof, që ja ka qejfi, nryshe nuk do t'kruhej me mue n'atë far feje. Ta dish, o Bajazit vllau, ja kam ba betë, veç mos ia gjetsha rastin! Ta shikojë ajo bullicë kur ta pupëztoj, ta mrruci e ta baj sa një kakruk...!

Që ta kisha llafin, Latif Kishaveci, (nëse t'kujtohet, e patën kap njihere tu vjedh pula në një kotec anej kah m'halla e Bazallarve) e lidhi diversantin me litar kacatrup, e manej, të dy bashkë, e ngritëm hopa dhe e futëm n'magazinën e plehut kimik. Aty e plandosëm si një thes me pleh mbi një grumull thasësh bosh.

Kryetari Brahim nisi menjherë për ke posta e kufinit Latif Kishavecin, që t'vinin e ta merrnin. Besomë mue, o Bajazit: ta rrahësh me shkop gjithë Bibollin, nuk gjenet njeri ma kamshejtë se ai!

Nuk vonoi shumë dhe ia behu kapterr Meleqi, ai qefliu, qi zbriste nganjherë knej kah Bibolli për t'kullot sytë mbi vashat si pela herxhele t'pashalueme e që binte erë livanto dhjetë litarë kali larg. Rëndë-rëndë, si një pasha, athue se ish veç ai e nuk kish ma kapterra tjer n'faqe t'dheut! Kishte marrë me vete edhe nja katër ushtarë, kopili. At'herë puna mori krejt nryshe. Kapterr Meleqi sa e pa diversantin, uli pak kryet e m'pa shtremt, athue se unë, dija sekretin, që gruja e tij, kish një nishan n'prapanic.

I tha kryetarit Brahim:

- Ma hiq sysh këtë budall t'shkatrruem.

Përse isha unë budall i shkatrruem, këtë nuk e mora vesh! Bile as kryetari Brahim m'u duk se nuk e mori vesh, sepse nuk bzani. Kapterr Meleqi, si ta kishte kurdisun vetë dreqi, m'shau zavalli me rroc e koc e ma futi me shkelm bythëve; e unë për pak u rrzova për t'thye qafën para gjith' atij mileti. Pastaj, u afrue afër diversantit, e

neroi me grushtin nalt e nisi ta zgjidhte!

Po çfar thashë unë, o Bajazit vllau?!

Ai nuk zgidhi diversantin, po zgidhi komanantin e ri t' postës së kufinit, i cili, me ta marrë veten, rreshtoi ushtarët bashkë me katunarët e tha se kët' lojë na e paska pas kurdisun rrengëçorri, sepse kish dashun t'vinte, medemek, n'provë, gadishmërinë e banorëve t'Bibollit!

E marrtë dreqi me gjithë gadishmëri, jarabi!

Mue, sa nuk m'luajti tepeleku i kresë! Kurse ajo bullica e Bexhetit u shkri gazit!

Mileti e pati rrethue komanantin e ri t' postës dhe me shumë vëmenje, nigjonte prej tij do komente, që ai i bante ksaj loje me fjalë e me duar, duke vu n'dukje do dobësi e t'meta t'mdhaja, që medemek, na paskësh pa ke unë gjat gjithë kësaj kohe. As nuk m'falenderuen, e jo ma t'më jepnin dekoratë, t'më nisnin t'shikoja falas Muzeun Komtar, apo t'më banin skuadërkomandant t'brigadës s'arave.

Për Zotin, o Bajazit, kurrnigja nuk m'dhanë, në asnjë ven nuk m'çuen e asnigja nuk m'banë!

Ngela si nji qen, me shpinën e mshtetun mbas murit t'magazinës së plehut kimik, me sytë gjithnji kah bullica e Bexhetit, qi bante me gisht kah unë e shkrihej gazit.

Rruspia!

U afrova pranë saj e gjithë inat i thashë:

- Po t'shtiva n'dor, moj bullicë, do të t'i shkep të dyja tulet që m'ke mes shalve.

At'herë ajo, qeshi prap e tha:

- Ik e kullot berrat, o berr i allahut, se për at'punë je ti!

Edhe sot e asaj dite, mallkoj veten dhe m'vjen inat se si nodhi që m'ra mue për hise kjo histori. Veç t'lutem, po t'porosis edhe

Ramiz Gjini

njiherë, o Bajazit vllau: mos ia jep asnjëri t'i lexojë k'to qi shkrova,  
e pash Zotin, mos ma ban t'madhe.

*Kastriot, verë, 1995*

## Shpirti i shtëpisë së vjetër

Katër burra të panjohur e mbërthyen për krahësh, e nxorrën nga shtëpia e vjetër dhe nisën ta tërhiqnin zharg rrugës tërë pluhur. Po çanin mes një rigate, që lëshonte udhë me britma çjerrëse drejt sheshit të pazarit ku qe ngrehur trekëmbëshi. Donin ta varnin me të njëjtën tërkuzë, që para pesëmbëdhjetë vjetësh, patën varur banditin Dod Marria!

Atëbotë, mes turmës që ulurinte, u nëpërduk një fytyrë e trembur gruaje: flokëshpupuritur e me buzët që hapeshin e flisnin.

Por s'dihej pse zëri i shkithej së brendëshmi me një shpërthiqje thëngjilli të ndezur në ujë.

Ishte e shoqja, Aneta. E kish mbërthyer fort me duar supeve dhe përpiquej ta ndërmendëte. Por atij iu bë sikur po e lidhnin për t'i kënduar për së gjalli ilahitë e fundit. Pastaj kur e ngritën, u mëvetësue disi dhe kuptoi që kish qenë në ëndërr. Atëherë bëri çudi dhe deshi të dinte ç'djall kish ndodhur, që po e zgjonin para orës shtatë të mëngjesit!

- Çfarë të dhemb Martin?! - I briti për të tretën herë gjithë

frikë Aneta, ndërsa e tundëte fort me të dyja duart, - Më thuaj, për atë Zot, çfarë të dhemb?!

- Shpirti i shtëpisë së vjetër, - tha ai.

U plandos në dyshek dhe ndjeu se si rrëmeti i gjakut tashmë po i fashitej ngadalë dejeve bashkë me një frikë të papërcaktuar. Por zemra ende vazhdonte t'i rrihte fort në kraharor dhe trupi i ziente si të kish zhubluar me të qelqe. Në kokërr të shpinës dhe me sytë e hapur të ngulur në tavan, i çliruar disi nga frika e mëparshme, pati përshtypjen sikur dhoma po zbrazej nga një ufëm mbytëse.

Ai vuri re, që e shoqja vazhdonte ta shikonte e çmeritur. A thua se ndodhej në prag të një pasoje të rëndë, shkakun e së cilës, kish frikë ta mësonte. Ia hodhi krahun rreth belit dhe e tërhoqi nga vetja si të deshte t'i kërkonte ndjesë për diçka që në fakt nuk qe fajtor. Ajo u lëshua pranë tij e dërrmuar, dhe, për herë të parë, i shkrepri në kokë mendimi, që në kohën e gjumit, burri i saj Martin Tivari, nuk i përkiste kësaj bote. Mërmëriti diçka si lutje në adresë të Zotit, dhe, ndërsa shtrihej pranë tij, i tha:

- Më ngrive gjakun!

Ai ia mori dorën në të tijën dhe ia shtrëngoi me dashuri si të deshte ta siguronte, që gjithçka tashmë kishte kaluar. Atëherë ajo ia rراسi kokën në gji dhe nisi t'i përkëdhelte flokët me mollëzat e gishtave.

- Fli tani! - i tha, - Është ora dy e natës.

Kishte qenë vetëm një përçapje në jermi dhe asgjë tjetër. Kish parë në ëndërr shtëpinë e vjetër të braktisur natën në errësirë disa vite më parë. Kishte ndjerë dhimbje në parzm. Qe përmalluar dhe kish dashur të qante me lot të valë, të nxirrte jashtë nga barku një të keq verdash si vreri! Pastaj një turmë njerëzish të pashpirt, që s'dihej pse e donin të vdekur!

Tashmë lypsej thjeshtë një harresë për të mbyllur të gjitha



shtigjet e kujtesës dhe për t'u lëshuar ngadalë në krahët e ëmbël të gjumit. Por sado që u përpoq nuk mundi dot të flinte. Kujtimet e shtëpisë së vjetër i qenë ngulitur në kujtesë si një masë e pashqitëshme. Martin Tivari kuptoi se po zhytej në një botë irreale, të cilën, për shkak të vagullisë, që nderej si një avull i ngjeshur në trurin e tij të topitur nuk kish si e përceptonte në detaje. Përpiqej t'i shkulte nga kujtesa ato sekuenca të së shkuarës në shtëpinë e vjetër. Në atë shtëpi ku jeta e tij kish qenë e mbushur dëng me të gjitha mungesat, të cilat, përpos vragave në shpirt, kishin lënë thellë tij edhe një si rribë mallëngjyese.

Për hir të një zakoni të lashtë, që dashur ta braktisnin shtëpinë e vjetër natën në errësirë, kur gjithë bota flinte. Mëngjesi i ditës tjetër duhej t'i gjente në shtëpinë e re. Por atij i qe dukur sikur që detyruar të kryente në errësirë një akt të poshtër pabesie. Qe përpjekur ta fshilte këtë ndjenjë me një shtiratë të bërë kinse, por s'ia pati dalë dot mbanë. Një orë para se të merrnin udhë, kish ndjerë brenda vetes një ndjenjë faj të pashlyeshëm. Atëherë i qe lutur së shoqes të linin aty një palë petka fjetje si dhe pak sende të përdorimit të përditshëm. Por ajo ia kish kthyer se zakoni e donte të mbarteshin me të gjitha.

Tashmë, shtrirë në shpinë, teksa përpiqej më kot të shkëputej nga mendime pirate, dëgjoji një zhurmim rrënoqethje xhamash në dritare si dhe një të trokitur të lehtë me gishta. E shoqja dukej se flinte, por ai vendosi ta zgjonte.

- Dëgjove gjë ti, Aneta? - Theu heshtjen e natës ai, dhe, ndërsa i tundi lehtë llërën e zhveshur, ngadalë shtoi, - M'u bë se dikush trokiti në dritare!

- Jo! - tha ajo gjysëm përgjumësh, pa i hapur sytë, - Nuk dëgjova ndonjë të trokitur. - Dhe pas një pauze të shkurtër, duke folur ngadalë, si të deshte të kursente frymën, shtoi: - Pikat e shiut

përplasen në xham. Fli tani dhe mos mendo asgjë.

Ai nuk bëri si i thanë, por mbajti frymën dhe u përpoq të dëgjonte me vëmendje të madhe. Gjaku i rrihte fort në tëmtha dhe një si ujvarë derdhej e zhurmonte diku thellë unit të tij. Mes atij zhurmimi të largët ujrash të lashtë, ai ndjeu ta shtypte pesha e ajrit, pastaj sytë e bërë agull i panë një shtëllungë errësire të dendur si lesh qeni i zi, që u end nëpër dhomë duke vozitur ngadalë derisa vajti e u fsheh në qoshe, pas raftit të rrobave. Sërish një e trokitur tjetër në dritare, dhe, tek e mbramja, atij i kapi veshi edhe një si vajtim, që t'këpuste shpirtin!

- Dikush po qan jashtë! - tha në baft ai dhe gati sa nuk brofi në këmbë. - Është ulur pranë dritares tonë dhe qan!

- Qan era, - ia pati e sigurtë gruaja, sërish qetë e pa lëvizur, pa i hapur sytë.

- Ndoshta ke të drejtë... - u ndërdysh pas pak ai.

Kurrë se kish dashur erën, këtë masë të padukshme me forcë demoniake, që i bënte degët e zhveshura të pemëve të vajtonin me logori, barin të thahej nga fërgëllimi dhe xhamat e dritareve të dridheshin.

Ai nuk do ia falte kurrë vetes fatalitetin, në të cilin dergjej aktualisht shtëpia e vjetër, ku një mori zvarranikësh, insektesh, kafshësh të vogla dhe barishtesh të egra kishin vërshuar nga të katër anët në një sulm mizor. Shtëpia e vjetër po zhytej çdo ditë e më tepër në llomin e thellë të harresës. Hijet e së shkuarës, hijet e të parëve të tij të vdekur, tashmë përpëliteshin të mbërthyer në rrjeta merimangash skutinave të errëta. Ndjeu t'i dhimbnin gozhdët e ngulura në mure, si t'i qenë ngulur në parzm. E trishtonin tjegullat e thyera në çati, trarët që kratnin e rënkonin ngase krimbat i brenin e i brenin papushim, suvaja e rrëzuar nga muret si dhe pika e shiut në qoshen e djathtë të tavanit si gangrenë vdekjeprurëse. I dhimbte

telisi me dheun e rrahur, kolonat e kalbura, pragu i derës ku kish buthtuar myshku dhe kërpudhat... Dhe cingërima e menteshave të kanatës së hapur të dritares së dhomës lart në pod, kishte qenë si një vajtim malli dërrmues për njerëz të gjallë. Të gjitha këto, i ngjallnin dhimbje si dhe një ndjenjë malli zhuritës për kohën e shkuar. Kushedi për të satën herë, ai ndërmendi vatrën e ndezur të oxhakut, flakët e të cilit, ndriçonin me një dritë të hyjnizuar fytyrat marroke, të dashura, të vëllezërve dhe motrave të ulura rreth tij.

Ku gjendeshin tani ata?

I vëllai i madh Ndini, kish vdekur nga një sëmundje misterioze, që e hëngri nga këmbët, ngadalë e në heshtje. Ende edhe sot gjendej në murin e hajatit të shtëpisë së vjetër një pasazh i shkruar me dorën e tij tetë muaj para se të vdiste: “Ne kemi që të dy të njëjtin fat: do rrëzohemi ngadalë”. Kurse më poshtë qe shënuar: “E diel, 14 maj 1982”. Edhe prindërit, njëri pas tjetrit, patën shkuar me kohë tek të shumtit. I ati vdiq me zemër të plasur vjeshtën e vitit 1986 pasi vuajti katër vjet nga gjendje depresioni me tendencë vetëvrasje. Vetëm tre muaj pas tij, kish mbyllur sytë e ëma. Qe tretur e fikur ngadalë nga malli për të vdekurit e saj. Mëngjesin e hershëm të ditës së shën Ndout, pas shtatë ditësh agjërimi, piu një çaj lulësh kamomili dhe shpalli se pasdite do të vdiste. Kërkoj të thirrej barku i saj dhe la amanet të mos futej në arkivol, por të vendosej në varr me shpinën për dheu. Vëllai i dytë Alkani, qe larguar e qe bërë fir, kish kërcyer oqeanin, dhe qe martuar me një grua të huaj. Shtatë vjet kishte pa e parë. Edhe motrat qenë martuar e bërë me fëmijë. Kurse gjyshi Tanush, iu fanit edhe njëherë i gjallë: i ulur mbi lëkurën e dashit pranë vatrës së ndezur të zjarrit, e vështronte si dikur me sytë e tharë nga lëngu i jetës, por të mbushur plot dashuri të dyfishtë prindërore. Kruante kokën me strehën e hirnosur të kapeles, qeshte e thoshte: “Këtë djalë nuk do ta lëmë të rritet. Do ta mbajmë të vogël”.

Martin Tivari u kthye në anën tjetër me një nxitim zemërak prej fëmije të sertë si të deshte t'i kthente shpinën së shkuarës. Çeli për një çast sytë dhe pa që ora mbi komo shënonte katër.

\*  
\*      \*

E kotë të përpiqesh të flesh. Ti ndërrove vend, u shkule prej meje dhe u ngule diku tjetër, në një tokë të re. E harrove bukën e vjetër, strofullën ku linde dhe u rrite, dhe natën u përvodhe si cub shtegut të arratisë që e hape vetë. Rende pas shkëlqimit të shtëpisë së re, pas mobiljeve e sendeve, që do të duhet kohë për t'u mveshur një histori, një sens mbresëlënës, një kuptim që të ketë të bëjë me të shkuarën, tharmi i së cilës, të ka mbrujtur shpirtin. Dhe sendet e vjetra, i pagëzove si rrangullina e rrokotele, i flake në plehëra pa e vrarë mendjen për shpirtin dhe historinë e tyre. Histori sendesh shkruar në heshtje nga dora misterioze e kalesës. Por ta dishë, që nuk është mirë, të mohosh sendet efemere edhe në paçin dashur një minut të vetëm për t'u krijuar. Nuk ta fal që më bëre t'i ngjaj një gufalle të zbrazur kërmilli, ndaj dhe e kam qitë cekën mos me t'lanë rehat.

Të kujtohet ai bakeqi, Sima i Zef Keltit? Sigurisht, që t'kujtohet. Një mëngjes maji, para shtatë e kusur vjetësh, u fut me buldozerin e tij mes rrënojave të Amandisë ku shkuli atje ca rrasa të mëdha guri. Pastaj këto rrasa, ai i ngarkoi në një rimorkiator për t'i çuar në shtëpi, por, para se të hynte në katund, ra prë e një mallkimi të madh: humbi sensin e orientimit dhe nuk mundi të gjente dot shtëpinë e tij. Plot dy ditë e netë u end papushim rrugëve të botës derisa e këputi gjumi, u vithis dhe ra në Abisin e jehonave të lashta.

Asokohe, ti sapo kishe nisur punë si mësues letërsie në shkollën e mesme. Kur të thanë çë kish gjetur Simën e Zef Keltit, ti zhvillove në klasë një orë të veçantë mësimi. U shpjegove nxënësve, që jo vetëm rrënojat e lashta, por duhej parë me kujdes të madh çdo vend ku shkelle thembra; se hapi në ecje lypsej lëshuar ngadalë, lehtë dhe butë, ngase toka qenkesh e mbushur me plagë të vjetra, dhimbjet e të cilave, kurrsesi nuk duhen shpërfillur.

Tani mëngjesi ka çelur si shegë dhe zogjtë bëjnë poterë kashtareve në kopësht. Ti ende nuk je zgjuar për shkak të një nate të vështirë ku je përpëlitur një kohe të gjatë mes ëndërrës dhe zhgjëndrrës. Shiu ka reshtur, dhe unë jam larguar bashkë me natën dhe të ftohtin e saj gazez. Nuk trokas më në xham, nuk ulem nga jashtë galuc pranë dritares së shtëpisë tënde të re dhe të vajtoj me dhimbje të thellë braktisjen prej njerëzve. Edhe në lëngo, i struktur diku mes pluhurit, dheut të përhitur, myshkut dhe merimangave, ti nuk e dëgjon më lëngesën time për shkak të vrumbullimit të mëngjesit, baptimeës së njerëzve, që rendin pas punëve të tyre të përditshme, zabullimës së jetës së gjallë. Por ti duhet të mësohesh t'i nderosh demonët e nëndheshëm dhe të përpiqesh të kuptosh fshehtësinat.

Dhe mos kujto se kjo qe nata e fundit. Aspak, o i mjerë! Të tjera netë si kjo do të vijnë prore, sepse është e pandërprerë gurra e jetës. Dhe unë do të vazhdoj të lëngo me vaj e ofshë, ashtu si një i sëmurë i përzishëm në shtratin e vdekjes. Lëngesa ime do të jetë e gjatë deri në ditën e moskurrit. Sepse është lëngesë guri e dheu të rëndë, e cila, nuk do të pushojë edhe në u shkultë guri i fundit i themelit.

*New York, dimër, 2003*



## Hapat e të tjerëve mbi trotuar

Dola nga shtëpia dhe teksa endesha i vetmuar pashë në një bli dy korba të mëdhenj e të zinj.

Nuk di çfarë mendova atë çast, por qielli mu duk tepër i errët, kurse udha në të cilën shkelja, krejt e panjohur dhe e frikëshme. Sikur kisha vdekur, por jo plotësisht. Sikur isha ndarë nga shumë gjëra, për të cilat, po më kaplonte një mall torturonjës.

Tek dyqani i qelqurinave ktheva nga e majta. Në kokë kisha vetëm një mendim: t'i çoja lule në varrezë një të afërmit tim, tashmë i vdekur.

U ndala para një gruaje trashaluqe dhe miope. Shiste karafilë shumëngjyrësh: të kuq, rozë, të bardhë dhe të verdhë. Gjithë ajo shportë e madhe plotë karafilë! Bleva dy, njërin të verdhë për ta dërguar në varrezë, kurse tjetrin e mora ngjyrë rozë për të marrën time, Elin. Dhe, tamam në çastet kur unë po mendoja për të, në rrugë, para meje, u shfaq Eli! Gjithë mërzia m'u davarit. Ajo buzëqeshi dhe mua mu duk sikur shkrepëtiu dielli me rrezet e tij të arta. "Gëzohem shumë që të gjeta", tha ajo, por në çastin e mbramë m'u duk si e zënë në faj.

Zbritëm ca shkallë duke u mbajtur tek njëri-tjetri me aq marifet

sa të huajtë të mos e kuptonin kurrësesi lidhjen tonë. Teksa më ndiqte pas me të prekur, hymë në një lokal ku zumë një tryezë.

Aty brenda, muret qenë me lagështirë dhe bënte nxehtë; dhe përpos kësaj, binte edhe një si erë zjarri i fikur me ujë. Nga e djathta ime dy të rinj, vajzë dhe djalë, kishin zënë një tryezë; flisnin ngadalë me njëri-tjetrin dhe qeshnin. Qeshnin dhe putheshin. Nuk di pse kjo na bënte ta ndjenim veten më pak fajtor.

Erdhi pronarja e lokalit që bënte të gjitha punët. Na përshëndeti e tha se aty ishte qetësi; se askush nuk trazonte dhe se po të ndizte radion, nuk dëgjohej zhurma e hapave të të tjerëve sipër nesh në trotuar.

Eli buzëqeshi për mirësjellje, kurse unë u hoqa sikur hapat e të tjerëve mbi trotuar, nuk kishte pse të na shqetësonin. Pastaj pronarja u largua dhe ne nisëm të fjaloseshim.

Folëm gjerë e gjatë për hallet e përditëshme të jetës, për ditën kur u njohëm bashkë, para dhjetë vjetësh, si dhe për ca të fshehta, për të cilat, pandehnim se vetëm ne të dy i dinim. I tregova pastaj për dy korbat e mëdhenj që kisha parë dhe ajo ma ktheu se nuk kishte gjë, se korba gjendeshin kudo, dhe se kjo, nuk kishte lidhje me atë, që unë dëshiroja të tregoja, pavarësisht pse nuk mundja. Sëfundit, ajo qeshi dhe më pyeti, nëse i kisha pirë rregullisht ilaçet për qetësimin e nervave. Dhe kur unë i thashë “po”, e ndjeva veten krejt si një fëmijë përpara saj.

Si erdhi pronarja e na solli dy gota me vodkë, ne nisëm të pinim në heshtje.

Nga e djathta ime djali dhe vajza qeshnin. Qeshnin dhe putheshin.

Unë i thashë Elit të mos i vështronte, por ajo tha se ishte e domosdoshme. Ndoshta për inat të asaj drej zhurmë që bënin hapat e të tjerëve në trotuarin sipër nesh. Pastaj, tek e mbramja, çpështolla



karafilët dhe i dhashë asaj më të bukurin, atë ngjyrë rozë.

Ajo tha se kishte dhjetë vjet që merrte lule prej meje dhe se lulet e mia po e plaknin.

Unë i thashë Elit se lulet nuk të plakin. Pastaj i shpjegova, që lulja tjetër ishte për në varrezë, për një të njohurin tim tashmë i vdekur, dhe se karafilët që blihen për të vdekurit, nuk kanë asgjë të përbashkët me ato që bliheshin për të gjallët. Por ajo u trishtua. Më pyeti nëse isha i sigurtë që nuk i kisha ngatërruar, sepse nuk do të donte, që krejt gabimisht, nga një pakujdesi e imja, të merrte prej meje një lule të blerë për një të vdekur. “Kam dhjetë vjetë që të dua, shtoi ajo, dhe kurrë ti, nuk ke blerë dy karafilë për dy kuptime kaq të largët nga njëri-tjetri”. Pas kësaj, ne qëndruam pa folur derisa zhurma e hapave të të tjerëve në trotuarin sipër nesh, erdhi e u bë e padurueshme. “Sikur shkelin mbi kokën time”, tha Eli dhe u mundua të qeshë. “Ç’dreqin kanë që i përplasnin kaq shumë këmbët?!”

U mundova ta qetësoja duke i thënë se ata ecnin. Ecnin, thjeshtë për të arritur diku, dhe se kjo, nuk duhej të na bezdiste. Vajza dhe djali që putheshin u ngritën, paguan dhe dolën.

Tani Eli më vështronte vetëm mua dhe në sytë e saj, dallova një shkrepëtimë të marrë drite, që kërkonte të depërtonte brenda meje gjer në gjak.

I thashë Elit se mund të putheshim, pavarsisht nga zhurma e hapave të të tjerëve sipër nesh në trotuar, dhe se pronarja e lokalit, tashmë nuk do të befasohej pas puthjeve që shkëmbyen dy të rinjtë. Veç kësaj, aty ndodheshim vetëm ne të dy dhe mund t’ia ngrinin zërin radios gjer në fund.

Pikërisht atëherë kur unë nuk e prisja, Eli u ngrit. Tha se nuk ndjehej mirë dhe se e kishte të pamundur të rrinte më. Pastaj shtoi se i duhej të nxitonte, të bashkohej edhe ajo me turmën që ecte sipër nesh në trotuar; se kishte dëgjuar e njohur për një çast hapat

e të shoqit, kishte dëgjuar e njohur hapat e fëmijëve, të të njohurve të saj, dhe bashkë me ta, edhe hapat e atyre që më kot e urrenin. Pastaj më tha se prap do të takoheshim diku, kështu si sot, që të çmalleshim për pak kohë e të bisedonim për gjëra që duken sikur i përkasin një tjetër bote, por që në të vërtetë ne nuk bëjmë dot pa ta.

Eli doli dhe unë ndjeva zhurmën e njohur të hapave të saj se si u përzie me zhaurimën e madhe të hapave të të tjerëve mbi trotuarin sipër meje.

Mbi tavolinë kish mbetur karafili ngjyrë rozë.

Eli gabimisht kishte marrë të verdhin, atë që unë pata blerë për të vdekurin.

*Kastriot, pranverë, 1989*

## Treguesi i lëndës

Mërzia e thellë e vetmitarit Luis Medina	5
Koka e gruas	11
Belaja e së shtunës	19
Gruaja e huaj	28
“Qeveritarët”	33
Atdheu prej bore	41
Një djallushkë e bekuar prej Zotit	49
Turmë	56
Posta që sjell era	63
Macja e zezë	73
Isaku, vëllaçkoja ynë i vogël	79
Mendjet e njerëzve	88
Hiçi dhe Diçi	94

Dërgesa e Zotit	101
Ara e pakorrur	110
Plagë lulezonje	117
Një histori dembelësh	120
Frika	126
Rrëfimi i bariut	129
Shpirti i shtëpisë së vjetër	137
Hapat e të tjerëve mbi trotuar	145